

Aneksi I - Programi Trajnues 2021-2022

Programi Trajnues

Programi Trajnues Kornizë do të zbatohet përmes Programit Trajnues dhe dokumenteve tjera përcjellëse siç janë: kalendari trajnues, formularët për aplikime në trajnim si dhe materiale tjera relevante për realizimin e këtij programi që do të jenë pjesë e këtij dokumenti.

Plani Trajnues mbulon periudhë 2 vjeçare, me përjashtim të Programit të Trajnimit Fillestar i cili për shkak të specifikave hartohet për të gjithë periudhën sa zgjat programi trajnues.

Programi Trajnues Kornizë është fleksibil dhe lehtë i adaptueshem në rast të ndryshimeve dhe zhvillimeve eventuale. Në rast të ndryshimeve, Këshilli Drejtues i AD-së mund të rishikon, plotëson dhe ndryshon këtë program.

Drejtësia Penale

1. Provat në procedurë penale dhe ligjshmëria e tyre

Nuk ka dyshim se procesi i të provuarit në procedurë penale gjyqësore, i cili gjithnjë rezulton me vendim gjyqësor, zë vend qendror në procedurë penale, andaj KPPK, ka rregulluar procesin e të provuarit-argumentimin në përgjithësi, si dhe marrjen e provave konkrete. Në procedurën penale që kryesit përgjegjës të veprës penale t'i shqiptohet sanksioni penal sipas kushteve që i parasheh KPK, është e domosdoshme të vërtetohen fakte që janë të rëndësishme për marrjen e një vendimi gjyqësor. Rrethanat e kryerjes së veprës penale dhe fajësia e të pandehurit mund të përcaktohen vetëm me anë të provave. Në sistemet që janë akuzatore mundësia për të kundërshtuar provat është diç më e madhe për palët në procedurën penale. Gjatë hetimit të kriminit prokurori që e heton krimin ka për obligim të gjejë prova që kanë lidhje me krimin e kryer, por edhe provat që dëshmojnë se ka pasur viktimë të lënduara, prova që mbështesin konfiskimin e pronës apo të ndonjë aseti, pastaj prova që bindin gjykatën për shqiptimin e paraburgimit ndaj të pandehurit apo prova që garantojnë rrethana rënduese për një dënim më të lartë. Për tu shqiptuar një vendim i drejtë dhe ligjor në procedurë penale procesi i të provuarit (argumentimit) në drejtim të vërtetimit të fakteve relevante juridike në një çështje penale është shumë i rëndësishëm.

Me kryerjen e veprës penale përveç, të mirës juridike të mbrojtur, cenohet edhe rregullimi juridik, të cilin shoqëria është e thirrur ta mbrojë. Shteti për të mbrojtur të mirat juridike duhet të reagojë kundër kryerësve të veprave penale për ta rivendosur rendin e prishur. Ky reagim realizohet në procedurë penale, duke shqiptuar sanksion penal përkatës, kryerësit të veprës penale. Para se ti shqiptohet sanksioni penal kryerësit të veprës penale, organet proceduese, duhet të sigurojnë vërtetimin e plotë të fakteve relevante juridike nga të cilat varet zbatimi i të drejtës penale materiale. Një tjetër dimension i provave është te mendohet se çka po provon ajo provë; a është provë e drejtpërdrejte që tregon se një person është lënduar nga ai veprim kundërligjor apo disa prova që sugjerojnë se dikush mund të jetë fajtor. Në shumicën e vendeve, përfshirë edhe vendin tonë, barra e provës bie mbi prokurorin, i cili duhet të mbledh prova që përmbysin prezumimin se i pandehuri është i pafajshëm. Vërtetimi i fakteve në procedurë penale, në krahasim me procedurat e tjera është shumë më i vështirë ngase në procedurën penale i pandehuri fajtor ka interes që ta vështirësojë të provuarit e fakteve, ta shtrembërojë të vërteten dhe ta vë gjykatën në lajthim.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zbatojnë drejtë bazën ligjore për sigurimin dhe përdorimin e provave;
- Identifikojnë subjektet e autorizuara për mbledhjen e provave;
- Shqyrtojnë llojet e provave të cilat mund të sigurohen gjatë fazës së hetimeve;
- Vlerësojnë drejtë ligjshmërinë e provave.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Faktet dhe vërtetimi i tyre në procedurë penale;
- ✓ Sigurimi i provave në veprimet fillestare të policisë;
- ✓ Sigurimi i provave me anë të masave të fshehta të vëzhgimit dhe hetimit;
- ✓ Provat në fazën e hetimeve;
- ✓ Ligjshmëria e provave dhe kundërshtimi i tyre.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë trajnimit do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, përfshirë shpjegime teorike dhe praktike të përcjellura me shembuj nga praktika gjyqësore, dhe do të ofrohen raste nga praktika gjyqësore.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Përfitues nga ky trajnim janë gjyqtarët dhe prokurorët e nivelit themelor mirëpo, sipas nevojës mund të jenë edhe mbrojtës të viktimave, zyrtarë policore dhe zbatues të tjerë të ligjit. Trajnimi do të zgjas një (1) ditë.

2. Zhvillimi i hetimeve, hartimi dhe ngritja e aktakuzës

Fillimi i hetimit është veprim me rëndësi në procedurën penale. Për çdo veprim të kundërligjshëm pasi që të mblidhen provat e mjaftueshme nga organet kompetente dhe pranohet kallëzimi penal, është obligim i prokurorisë që të fillon ndjekjen penale. Andaj, zhvillimi i hetimeve në çdo fazë duhet të bëhet në përputhje me parimet, rregullat dhe standardet e përcaktuara në KPPK jo vetëm që garantojnë për një ndjekje penale ligjore dhe të suksesshme por gjithashtu të gjitha ato veprime hetimore të jenë në pajtim me respektimin e lirive dhe të drejtave të garantuara. Rolë me rëndësi në këtë fazë të procedurës penale është hartimi i aktakuzës që paraqet aktin përfundimtar të një procesi hetimor. Aktakuza prezanton procesin e hetimit dhe rezultatet e arritura nga ky hetim. Aktakuza duhet të jetë e hartuar mirë, qartë dhe përmbajtëse në mënyrë që ti mundësoj gjykatës procedimin e çështjes.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Identifikojnë burimin e informacioneve dhe të ndërtojnë standardin e dyshimit të arsyeshëm;
- Njohin metodat dhe tekniken e hetimit penal;
- Vlerësojnë se kur dhe si informacionet shndërrohen në prova të pranueshme në procedurë penale;
- Avanci mi i njohurive lidhur me hartimit të aktakuzës.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Roli i prokurorit dhe policisë në hetimet proaktive;
- ✓ Mënyra e sigurimit të provave;
- ✓ Teknikat e marrjes së deklaratave;
- ✓ Paraqitja e kërkesave në gjykatë;
- ✓ Mbrojtja e dëshmitarëve/dëmtuarve dhe dëshmitarët bashkëpunues;
- ✓ Mundësia hetuese e veçantë.
- ✓ Hartimi i aktakuzave.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij trajnimit do të përdoret një metodologji e kombinuar, ku përveç prezantimeve përmes PowerPoint, do të aplikohen metodat interaktive me pjesëmarrësit. Gjithashtu pjesëmarrëseve do t'iu ofrohen për të diskutuar edhe rastet praktike dhe hipotetike të cilat në vete përmbajnë dilemat dhe sfidat nga praktika gjyqësore.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët dhe prokurorët nivelit themelor. Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

3. Veprat penale kundër martesës dhe familjes

Në Kapitullin XXI të Kodit Penal të Kosovës janë sanksionuar këto vepra penale. Duke marrë për bazë natyrën dhe peshën tyre, mënyrën e kryerjes së këtyre veprave penale, pasojat e kryerjes së këtyre veprave penale, kush mund të jenë kryesit dhe kush janë viktimat apo të dëmtuarit e këtyre veprave penale, vendin e kryerjes dhe karakteristikat e tjera që përfshijnë këto vepra penale. Këto vepra penale duhet të trajtohen me prioritet si dhe veprimet ndërmerren në kohë sa më të shkurt për shkak të pasojave që mund të ketë zvarritja e këtyre procedurave, duke vepruar me një kujdes dhe ndjeshmëri të lartë, duke përfshirë në këtë procedurë edhe ekspert të lëmive tjera e që kanë të bëjnë me moshën, gjininë, edukimin dhe ambientin në të cilin jetojnë kryesit dhe viktimat e këtyre veprave penale pa lënë anash asnjëherë zhvillimin shpirtëror dhe emocional të këtyre kategorive.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të;

- Zgjerojnë njohuritë për veprat penale kundër martesës dhe familjes;
- Analizojnë mënyrën dhe arsyet e kryerjes së këtyre veprave penale;
- Interpretojnë drejtë dispozitat ligjore që rregullojnë këtë materie;
- Zgjerojnë njohuritë lidhur me dispozitat e reja e të cilat parashihen në Kodin Penal;

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Veprat penale, objekti mbrojtës dhe karakteristikat e këtyre veprave penale;
- ✓ Veprat penale të kryera ndaj fëmijëve;
- ✓ Disa karakteristika të procedurës për vepra penale të kryera ndaj bashkëshortëve;
- ✓ Zbatimi i procedurës sipas KPP-së;
- ✓ Marrja në pyetje të viktimave në cilësi të dëshmitarit.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij trajnimi do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, të përcjellura me shembuj nga praktika gjyqësore dhe akademike. Pjesa përfundimtare e trajnimit do të jetë e rezervuar që pjesëmarrësit përmes pyetjeve dhe debatit të paraqesin pikëpamjet nga këndvështrimi i tyre rreth temës së shtjelluar dhe implementimin në praktikë të njohurive të përfituara nga ky trajnim.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarë dhe prokurorët. Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

4. Uzurpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave

Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme është vepër penale kundër pasurisë. Në vendin tonë edhe pse kjo çështje mbrohet me dispozitat e Ligjit të Procedurës Kontestimore, ngase pronari për çfarë do shqetësimi në shfrytëzimin e pronës së tij, ka të drejtë të kërkojë mbrojtje ligjore me padi. Si rezultat i rritjes së numrit të uzurpimeve të pronave të huaja është paraqitur nevoja që pronarëve të këtyre pronave të paluajtshme, të ju ofrohet edhe mbrojtje nëpërmjet së drejtës penale, me qëllim që të parandalohet abuzimi i këtillë me pronë të huaja. Përmes këtij trajnimi synohet që të definohen kushtet ligjore që duhet të përmbushen për tu konsideruar ekzistimi i kësaj vepre penale, si dhe përmes procedurës penale jo vetëm që kryesi të shpallet fajtor, por edhe të realizohet kthimi i pronës tek pronari, si dhe kompensimi i dëmit të shkaktuar nga kjo vepër penale.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zbatojnë në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me këtë vepër penale;
- Avancojnë njohuritë rreth kushteve ligjore që duhet të përmbushen për ekzistimin e kësaj vepre;
- Identifikojnë dallimet se në cilat raste kemi të bëjmë me raporte civilo-juridike, e jo me vepër penal.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Vepra penale e uzurpimit të paligjshëm sipas KPRK -së;
- ✓ Kushtet ligjore që kërkohet të përmbushen për ekzistimin e kësaj vepre penale;
- ✓ Sanksionet penale që mund të ju shqiptohen kryesve të kësaj vepre penale si dhe dënimet plotësuese.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë trajnimit do të përdoret një metodologji e kombinuar, ku përveç prezantimit, do të aplikohet edhe diskutime interaktive me pjesëmarrësit, si dhe studimi i rasteve nga praktika gjyqësore.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtaret dhe prokuroret e nivelit themelor. Trajnimi do të zgjas një (1) ditë.

5. Krimet e Luftës

Vendi ynë është një nga vendet e dalura nga lufta dhe se gjatë kësaj lufte kanë ndodhur raste të ndryshme të cilat dyshohen se bëjnë pjesë në sfondin e krimeve të luftës. Gjyqtarët dhe prokurorët vendor kanë nevojë për ngritjen e kapaciteteve në këtë fushë pasi që nuk ka pasur ndonjë praktikë të gjatë vendore gjyqësore në këtë drejtim. Pjesëmarrësit do të njoftohen me veprat penale të cilat parashihen në KPK, të cilat parashohin dhe sanksionojnë veprimet e kryerësve të veprave penale të krimeve të luftës e të cilat do të prezantohen të ndërlidhura me konventat ndërkombëtare si tërësi dhe Konventat e Gjenevës të cilat mbulojnë krimet e luftës dhe gjenocidin në veçanti.

Theksi i veçantë në këtë trajnim do të jetë kategorizimi i përgjegjësisë së krimeve të luftës gjithnjë duke pas për bazë natyrën e formave të bashkëpunimit, ndihmës, nxitjes, bashkëkryerjes, ndërmarrjes së përbashkët kriminale dhe përgjegjësisë komanduese, duke synuar që të analizohen rastet praktike vendore dhe ndërkombëtare të tribunaleve për të vlerësuar edhe ndëshkueshmërinë karshi natyrës se përgjegjësisë së krimeve të luftës.

Rëndësi do të kenë edhe format e inkriminimit të krimeve të luftës e me theks të veçantë dhunimet seksuale si vepër e kategorizuar në shkelje të drejtës ndërkombëtare. Ky trajnim synon që tërësisht të ndërtohet mbi rastet praktike vendore dhe ndërkombëtare për krimet e luftës, për të evidentuar të metat në praktikën gjyqësore, qoftë të rasteve që kanë marrë epilog apo të rasteve që janë konsideruara se zgjidhjet sipas vendimeve gjyqësore nuk janë në përputhje me dispozitat ligjore, kjo me qëllim që të ndërtohet një praktikë e qëndrueshme dhe duke synuar që të mos përsëriten gabimet e evidentuara tashme në praktikën gjyqësore.

Objektivat e modulit të trajnimit

- Përvetësojnë njohuritë për tu marrë me rastet e krimeve të luftës;
- Njohin format e zbatueshme të përgjegjësisë penale për krimet e luftës;
- Njohin përgjegjësinë komanduese.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Format e zbatueshme të përgjegjësisë penale për krimet e luftës;
- ✓ Vendimet e Gjykatës Supreme dhe të Apelit në zbatimin e të drejtës penale ndërkombëtare në juridiksionin e Kosovës;
- ✓ Ndërmarrja e përbashkët kriminale dhe format tjera të bashkëpunimit;
- ✓ Përgjegjësia komanduese.

Metodologjia e trajnimit

Trajnimi do të përqendrohet në studimet e rasteve praktike e sidomos të rasteve e tribunaleve ndërkombëtare, aplikimin e kategorive ligjore në skenarët faktik. Shtjellimin dhe konsolidimin e praktikës për gjyqtarë dhe prokurorë që merren me procedimin e çështjeve të kësaj natyre.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët nga Departamenti Special i të dy niveleve, gjyqtarë nga DKR, gjyqtarë nga niveli i Supremes, Apelit dhe atij themelore si dhe Prokurorët e PSRK-së. Trajnimi do të zgjatë dy (2) dite.

6. Procedura penale e kryerësve me çrregullime mendore

Kjo procedurë e veçantë penale, zbatohet në rastet kur kryerësi në kohën e kryerjes së veprës penale ka vuajtur nga çrregullimet mendore të karakterit të përhershëm apo të përkohshëm, që ka rezultuar me zvogëlimin esencial të aftësisë së tij mendore, apo të paaftësisë së plotë mendore (papërgjegjësisë). Gjithashtu kjo procedurë e veçantë zbatohet edhe në rastet kur te kryerësi i veprës penale, çrregullimet, sëmundjet mendore të përkohshme ose të përhershme janë paraqitur gjatë zhvillimit të procedurës penale apo gjatë gjykimit. Është me rëndësi të ceket se sikur te procedura e rregullt penale edhe te kjo procedurë e veçantë, patjetër që duhet të aplikohen parimet e përgjithshme të drejtësisë të cilat janë të garantuara edhe me KPPK. Me një fjalë, kjo procedurë penale dallon prej procedurës së rregullt nga përmbajtja e saj, mënyra e inicimit të procedurës penale, zhvillimi i procedurës, përfundimi i saj si dhe vendimet përfundimtare gjyqësore.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të të:

- Zgjerojnë njohurit lidhur me veçoritë e procedurës penale ku përfshihen kryerësit me çrregullime mendore;
- Vlerësojnë kushtet dhe kriteret ligjore lidhur me caktimin e paraburgimit për kryesit me çrregullime mendore;
- Njihen me llojet e masave të trajtimit të detyruara psikiatrik në liri dhe me ndalim në institucionet e kujdesit shëndetësor.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Ekzaminimi psikiatrik;
- ✓ Paaftësia mendore dhe aftësia e zvogëluar;
- ✓ Aktvendimi për paaftësinë për t'iu nënshtruar gjykimit;
- ✓ Paraburgimi për personat me çrregullime mendore;
- ✓ Lloji i masave të trajtimit të detyruar psikiatrik;
- ✓ Procedura penale dhe shqiptimi i masave të trajtimit të detyruara;
- ✓ Monitorimi i zbatimit të masave të trajtimit të detyruar psikiatrik.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë trajnimit do të përdoren metodat e kombinuara të trajnimit, prezantimi i materialeve të ndryshme mbi temën dhe përmbajtjes e saj, diskutimet interaktiv me pjesëmarrësit, puna në grupe, rastet praktike si dhe shqyrtimi dhe diskutimi i dilemave që paraqiten në praktikë.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Përfitues nga ky trajnim do të jenë gjyqtarë dhe prokurorë. Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

7. Paraburgimi dhe masat tjera për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë

Si masë më e rëndë në kuadër të këtyre masave është paraburgimi. Sipas instrumenteve ndërkombëtare por edhe legjislacioni ynë sugjeron që paraburgimi të aplikohet vetëm kur shterren të gjitha mundësitë tjera për ta arritur qëllimin. Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë janë paraparë në KPPK si instrumente me të cilat bëhet kufizimi i lirisë së lëvizjes, dhe përcaktohen kushtet ligjore me qëllim të zhvillimit me sukses të procedurës penale. Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë, shpeshherë nuk janë zbatuar sipas mënyrës dhe kushteve të parapara me ligj, andaj në praktikën gjyqësore ende ka vështirësi në identifikimin, vlerësimin dhe analizimin e rrethanave lidhur me vendosjen për secilën bazë për këto masa.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Vlerësojnë drejtë elementet për përcaktimin e masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedure;
- Zbatojnë parimet bazë lidhur me këto masa;
- Hartojnë dhe arsyetojnë mjaftueshëm vendimet për shqiptimin e këtyre masave.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Kushtet ligjore-bazat për caktimin e masave për sigurinë e pranisë së të pandehurit në procedurë;
- ✓ Paraburgimi dhe arsyetimi i aktvendimit për caktimin për paraburgim;
- ✓ Paraburgimi dhe masat tjera në raport me të drejtat dhe liritë e njeriut.

Metodologjia e trajnimit

Metodologjia e trajnimit do të jetë e kombinuara duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, diskutim instruktiv dhe trajtim i rasteve nga praktika.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët e gjykatave themelore dhe të Apelit, prokurorët e prokurorive themelore, të Apelit dhe të Prokurorisë Speciale të Republikës së ne Kosovës. Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

8. Shqyrtimi gjyqësor dhe gjykimi në mungesë

KPP, përveç tjerash, ka pësuar ndryshime të mëdha edhe në dispozitat që e rregullojnë procedurën pas ngritjes së aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, duke parashikuar, shqyrtimin fillestar dhe shqyrtimin e dytë. Në anën tjetër, pas hyrjes në fuqi të KPP-së, në praktikën gjyqësore, janë paraqitur mjaft vështirësi dhe konfuzione me rastin e aplikimit të dispozitave ligjore që i referohen shqyrtimit fillestar, shqyrtimit të dytë dhe shqyrtimit gjyqësor. Përveç tjerash, gjykimi i të pandehurve në mungesë, që është parapare me plotësimin e kodit, duke respektuar standardet e së drejtës në gjykim të drejtë dhe parimeve tjera të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Një gjë e tillë përbën përjashtim nga rregullat e përgjithshme të procedurës penale, dhe duhet të jetë e lidhur me qëllimin e luftës ndaj pandëshkueshmërisë së krimeve kundër të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare dhe të Drejtës Ndërkombëtare Penale, të kryera në territorin e Republikës së Kosovës.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Organizojnë në mënyrë të drejtë zhvillimin e procedurës në shqyrtimin fillestar dhe në shqyrtimin e dytë;
- Vlerësojnë rolin e gjyqtarit dhe prokurorit të shtetit gjatë shqyrtimit fillestar, të dytë dhe gjyqësor;
- Zbatojnë drejt dispozitat ligjore që rregullojnë gjykimin në mungesë.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Zhvillimi dhe rrjedha e procedurës në shqyrtimin fillestar dhe në shqyrtimin e dytë;
- ✓ Roli i gjyqtarit dhe prokurorit të shtetit gjatë shqyrtimit të dytë;
- ✓ Seanca për vërtetimin e fakteve relevante lidhur me dënimin;
- ✓ Shqyrtimi gjyqësor;
- ✓ Gjykimi në mungesë.

Metodologjia e trajnimit

Përmes prezantimit të rasteve nga praktika gjyqësore dhe diskutimit në grupe, do të analizohen situata të ndryshme në të cilat do të mund të gjendeshin gjyqtarët gjatë shqyrtimit fillestar, shqyrtimit të dytë apo të shqyrtimit gjyqësor.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët dhe prokurorët e nivelit themelor dhe të apelit. Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

9. Trafikimi i qenieve njerëzore

Trafikimi me njerëz paraqet një ndër format më të rënda të shfrytëzimit të njerëzve dhe me të drejtë konsiderohet si skllavëri moderne e kohës së sotme. Kjo formë e shfrytëzimit të qenieve njerëzore paraqet një biznes në lulëzim dhe është një nga krimet që është përhapur me shpejtësi në të gjithë botën dhe ka arritur tashmë ato dimensione që ka arritur trafikimi i drogës dhe i armëve. Sot në botë trafikimi me njerëz konsiderohet si njërin ndër krimet me komplekse, andaj ky trajnim ka për qëllim që pjesëmarrësve të programit për përgatitjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve tu mundësojnë që të fitojnë njohuri lidhur me trafikimin me njerëz, në veçanti për ngjashmëritë dhe dallimet e veprës penale të trafikimit me veprat tjera, që kanë elemente të kësaj vepre penale por që në esencë dallojnë nga trafikimi me njerëz si dhe me pozitën e viktimës së trafikimit, mënyrën më të mirë të hetimit penal e financiar, trajtimin e të drejtave të viktimave dhe kompensimin e dëmit për to.

Gjithashtu përmes këtyre moduleve synohet që pjesëmarrësit të mësojnë për Procedurat Standarde të Veprimit, për Strategjinë dhe Planin e Veprimit lidhur me luftën kundër trafikimit me njerëz si dhe për Mekanizmat vendor dhe ndërkombëtar që merren me luftimin e trafikimit me njerëz e sidomos me Mekanizmat Transnacional të Referimit, ku edhe Kosova është pjesëmarrëse aktive së bashku më të gjitha shtetet e Evropës Jug-Lindore dhe disa shtete anëtare të Bashkimit Evropian.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Identifikojnë dhe dallojnë elementet e veprës penale trafikimi me njerëz;
- Zbatojnë Strategjinë dhe Planin e Veprimit për të luftuar trafikimin;
- Zbatojnë Mekanizmat Transnacional të Referimit;
- Hartojnë planin për identifikimin dhe mbështetje të trafikimit me njerëz;
- Zbatojnë të drejtat e viktimave të trafikimit në procedurën penale duke përfshirë edhe kompensimin e dëmit.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Infrastruktura ligjore lidhur me Trafikimin me njerëz;
- ✓ Identifikimi dhe dallimi i elementeve të veprës penale Trafikimi me njerëz;
- ✓ Strategjia dhe Plani i Veprimit për të luftuar Trafikimin;
- ✓ Mekanizmat Transnacional të Referimit;
- ✓ Hartimi i planit për hetim dhe identifikimin e viktimave të Trafikimit me njerëz;
- ✓ Të drejtat e viktimave të trafikimit në procedurën penale si dhe procedura për kompensimin e dëmit për viktimat e trafikuar.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë trajnimit, do të përdoren metodat interaktive, simulim i rasteve, punë në grupe, pyetje dhe diskutime nga pjesëmarrësit.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Prokurorët dhe gjyqtarët e shkallës së parë dhe shkallës së dytë. Trajnimi do të zgjatë dy (2) ditë.

10. Kompensimi i viktimave të krimit në kuadër të sistemit juridik të Republikës së Kosovës

Trajnimi për kompensimin e viktimave të krimit në kuadër të sistemit juridik të Republikës së Kosovës është në funksion të ngritjes dhe avancimit të njohurive tek Gjyqtarët dhe Prokurorët për fushën e kompensimit të viktimave të krimit në kuadër të Sistemit Juridik të vendit. Për më shumë qëllimi i trajnimit është i fokusuar që Gjyqtarët dhe Prokurorët të kenë mundësinë që të njoftohen me ndryshimet dhe avancimin e legjislacionit për kompensimin e viktimave të krimit, kjo për faktin se janë Gjyqtarët dhe Prokurorët ata që do të zbatojnë këtë legjislacion që viktima të kenë qasje në drejtësi dhe të realizojnë këtë të drejtë Kushtetuese dhe Ligjore.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Avancojnë njohuritë rreth kompensimit të viktimave të krimit në kuadër të sistemit juridik të vendit;
- Kuptojnë obligimet e institucioneve relevante që janë kategori Ligjore për trajtimin, njoftimin dhe vendosjen për rastet e kompensimit të viktimave të krimit;
- Zgjerojnë njohuritë për trajtimin dhe vendosjen e rasteve duke pasur për bazë edhe kompensimin e viktimave të krimit dhe atë në harmoni me legjislacionin përkatës në fuqi.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Kompensimi i viktimave të krimit një e drejtë që duhet të jenë të njoftuara viktimat;
- ✓ Kompensimi i viktimave të krimit në kuadër të sistemit juridik të Republikës së Kosovës;
- ✓ Mekanizmat institucional për trajtimin, njoftimin dhe vendosjen lidhur me kompensimin e viktimave të krimit
- ✓ Sfidat në realizimin e të drejtës së kompensimit nga ana e viktimave të krimit, si një e drejtë ligjore;
- ✓ Bashkëpunimi ndërinstitutional në zbatim të legjislacionit përkatës me qëllim të realizimit të së drejtës nga viktimat për kompensim.
- ✓ Obligimet ligjore për kontribut financiar në fondin për kompensimin e viktimave të krimit.

Metodologjia e trajnimit

Trajnimi do të përfshijë punë në grup, diskutime, simulime, prezantime të shkurtra nga Gjyqtarët dhe Prokurorët, me qëllim të vlerësimit të gjendjes, pasqyrimin e problemeve në praktikë dhe atë që e përcakton legjislacioni përkatës në fuqi për kompensimin e viktimave të krimit.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët dhe Prokurorët si dhe bashkëpunëtorët profesional. Trajnimi do të zgjas dy (2) ditë.

11. Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet penale, mundësitë dhe sfidat

Në praktikën tonë të përditshme nëpër gjykata dhe prokurori çdo ditë e më tepër na paraqiten rastet nga më të ndryshme duke filluar nga dhënia e ndihmës minimale juridike-akt lutjet e ndryshme për marrjen e deklaratës së dëshmitarëve apo dorëzimin e dokumenteve/ftesave apo aktvendimeve të ndryshme e deri tek ekstradimi i të kërkuarve sipas akt lutjes së shtetit kërkuar. Andaj për ti evituar sfidat e paraqitura në praktikë, ky trajnim do të shtjellojë konceptin e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet penale në përgjithësi dhe institutet përkatëse sipas Ligjit Nr. 04/L-213, për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale në veçanti, si mjete të rëndësishme dhe të pazëvendësueshme për zbatimin e drejtësisë. Si rezultat i këtij trajnimi, pjesëmarrësit do t'i zhvillojnë më tutje njohuritë dhe shkathtësitë e tyre në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet penale, përmes analizimit në detaje të instituteve dhe mundësive që ofrohen brenda kësaj fushe.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Avancojnë njohuritë rreth instituteve të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar;
- Analizojnë kërkesat e paraqitura nga shteti kërkuar;
- Avancojnë njohuritë në fushën e ndihmës juridike ndërkombëtare për të rritur efikasitetin në ekzekutimin e kërkesave për ndihmë juridike.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar si mjet për zbatimin e drejtësisë;
- ✓ Ligji për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale dhe marrëveshjet dypalëshe;
- ✓ Korniza institucionale: Rolet dhe përgjegjësitë e DBJN, autoriteteve gjyqësore, ILECU dhe Zyrës së UNMIK-ut.
- ✓ Ekstradimi nga Republika e Kosovës tek një shtet tjetër dhe Ekstradimi nga një shtet tjetër në Republikën e Kosovës;
- ✓ Letërreshtimet ndërkombëtare;
- ✓ Transferimi i personave të dënuar dhe transferimi i procedurës penale;
- ✓ Njohja dhe ekzekutimi i aktgjykimeve të huaja në Republikën e Kosovës;
- ✓ Ndihma juridike e ndërsjellë.

Metodologjia e trajnimit

Trajnimi do të ndjek një qasje pro-aktive dhe praktike, me fokus në çështjet 'operacionale'. Trajnimi do të përfshijë detyra grupore dhe përmes rasteve studimore të bazuara në raste reale, do të përvijohen çështjet e cekura më sipër, tek përmbajtja e modulit të trajnimit. Përmes analizimit të 'skenarëve' të ndryshme, pjesëmarrësit do të zbatojnë institutet nga fusha e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet penale, me qëllim të identifikimit të mundësive dhe sfidave në zbatim dhe arritjes së zgjidhjeve konkrete.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarë dhe prokurorë. Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

12. Mbrojtja e dëshmitarëve dhe të dëmtuarve (viktimave), si dhe dëshmitarët bashkëpunues

Një ndër provat e rëndësishme në një çështje penale që shërben për të vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë një gjendje faktike është edhe dëshmia e dëshmitarit dhe të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit. Dëshmitar si rregull mund të jetë çdo person i cili mund të jep njoftime për veprën penale, për kryesin e veprës penale dhe për rrethanat e rëndësishme për procedurën penale, mirëpo këta persona në disa çështje penale, mund të kenë nevojë për mbrojtje, për shkak të kanosjes së rrezikut serioz për atë person apo familjen e tij, andaj në këto raste paraqitet nevoja e ndërmarrjes së veprimeve nga të gjitha institucionet e implikuara në procedurën penale, siç janë polica, prokuroria dhe gjykata. Masat procedurale për mbrojtjen e dëshmitarëve klasifikohen si masa për të fshehur identitetin e dëshmitarit – duke përfshirë të dhënat personale të dëshmitarit, pamjen e tij dhe zërin e tij nga publiku i përgjithshëm e në raste të jashtëzakonshme identiteti nuk është i njohur edhe për të pandehurin dhe mbrojtësin e tij, si dhe në masa që pengojnë takimin fizik të dëshmitarit apo të dëmtuarit me të pandehurin. Këto masa llogariten për të ruajtur jo vetëm integritetin fizik të dëshmitarit por edhe për ruajtjen e integritetit psikik apo edhe nga ri-viktimizimi. Përveç personave që u përmendën më sipër në procedurë penale si dëshmitarë bashkëpunues mund të paraqiten edhe personat që janë të dyshuar apo të pandehur për kryerjen e veprave penale, për të cilin ende nuk është lexuar aktakuza në shqyrtimin gjyqësor dhe që pritet të dëshmojnë në gjykatë dhe kur ka gjasa që më deklaraten e tillë mund: të parandalojë vepra të tjera penale nga personi tjetër; të shpie drejt zbardhjes së të vërtetës në procedurën penale; kur bashkëpunimi është bërë vullnetarisht dhe me marrëveshje të plotë për të dëshmuar të vërtetën në gjykatë; kur dëshmia është vlerësuar nga gjykata si e vërtetë dhe e plotë ose kur dëshmia mund të shpie drejt ndjekjes së suksesshme të kryerësve të tjerë të veprës penale.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Hartojnë kërkesën për masë mbrojtëse apo anonimitet dhe urdhrin mbrojtës;
- Zhvillojnë drejtë seancën për shpalljen e personit dëshmitar apo të dëmtuar të mbrojtur;
- Hartojnë urdhëratë mbrojtës;
- Zbatojnë drejtë intervistimin e personave të mbrojtur;
- Interpretojnë drejtë përfitimet e dëshmitarit të mbrojtur sipas ligjit;
- Hartojnë kërkesë dhe urdhër për dëshmitar bashkëpunues;

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Kërkesa për masë mbrojtëse apo anonimitet dhe lëshimi i urdhrin mbrojtës nga gjyqtari;
- ✓ Procedura për shpalljen e personit dëshmitar të mbrojtur;
- ✓ Urdhri për anonimitet si dhe format e tij;
- ✓ Zbatimi i intervistimit të personave të mbrojtur
- ✓ Përfitimet e dëshmitarit të mbrojtur sipas ligjit.
- ✓ Hartimi i kërkesës dhe seanca dëgjimore për dëshmitar bashkëpunues
- ✓ Urdhri për dëshmitar bashkëpunues

Metodologjia e trajnimit

Gjatë trajnimit, do të përdoren metodat interaktive, simulim i rasteve, punë në grupe, pyetje dhe diskutime nga pjesëmarrësit, simulim i marrjes së deklaratës së dëshmitarit të mbrojtur, hartim i urdhrin mbrojtës

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Prokurorët dhe gjyqtarët e shkallës së parë dhe shkallës së dytë, duke përfshirë edhe prokurorët special dhe gjyqtarët e departamentit special në të dy nivelet. Trajnimi do të zgjatë dy (2) ditë.

13. Veprat penale kundër narkotikëve – më theks të veçantë kur kryhen në formë të organizuar

“Shitësit e drogave jetojnë duke shitur vdekjen, ndërsa narkomanët prej tyre e blejnë vdekjen”. Të rijnë, shumë prej tyre adoleshentë, janë viktime të drogës, organizatat e mëdha kriminale ose ndryshe struktura të krimit të organizuar që merren me trafikun e drogës, gjithnjë e më shumë po i konkurrojnë çdo lloj biznesi vendor e ndërkombëtar, duke imponuar edhe zhvillimet politike dhe ekonomike që shkojnë në favor të interesave të tyre. Në kushtet e një sistemi të shpërqendruar politik dhe të sigurisë, në të cilin gjendet shoqëria dhe shteti i Kosovës në këto vitet e fundit, një përdorues i drogës, për të siguruar paratë e nevojshme për drogën e përditshme ose do të hyj në rrugën e krimit ose do të bëhet viktimë e narkotikëve. Sipas të dhënave nga QKUK pacientët që pranohen për trajtim, përdorin llojet e drogave si: heroinë, kokainë, metadon, marihuanë, hashash, duke u kombinuar edhe me alkool. Strategjia shtetërore e Republikës së Kosovës kundër drogave, si dhe Plani i veprimit, obligon Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Arsimit, atë të Punëve të Brendshme, të Ekonomisë dhe Financave dhe Agjencinë e Inteligjencës, që në kuadër të objektivave të përgjithshme dhe atyre specifike, të ndërtojnë një shoqëri të shëndetshme në Kosovë, pa kërcënime nga keqpërdorimi i drogave, andaj kjo strategji dhe ky plan i veprimit duhet të jenë pjesë e punës edhe të prokurorëve dhe gjyqtarëve.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Identifikojnë elementet e veprave penale lidhur me narkotikë të rrezikshëm dhe substanca psikotrope;
- Kryejnë hetime proaktive penale dhe financiare, në rastet që lidhen më trafikimin e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope;
- Identifikojnë llojet e narkotikëve dhe pasojat e përdorimit të narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Elementet e veprave penale lidhur me narkotikë të rrezikshëm dhe substanca psikotrope;
- ✓ Hetimet proaktive penale dhe financiare, në rastet që lidhen më trafikimin e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope;
- ✓ Identifikimi i llojeve të narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope
Kompetencat dhe bashkëpunimi më Njësinë për inteligjencë financiare;
- ✓ Pasojat e përdorimit të narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope;
- ✓ Rast studimi.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë trajnimit, do të përdoren metodat interaktive, simulim i rasteve, punë në grupe, pyetje dhe diskutime nga pjesëmarrësit.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Prokurorët dhe gjyqtarët e shkallës së parë dhe shkallës së dytë. Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

14. Veprat penale kundër detyrës zyrtare

Veprat penale kundër detyrës zyrtare përbëjnë sjellje të kundërligjshme të drejtuara kundër funksionimit të rregullt të shërbimeve publike, të cilat i kryejnë personat e autorizuar apo personat zyrtarë gjatë ushtrimit të detyrës së tyre zyrtare, ose lidhur me kryerjen e detyrës zyrtare. Kjo formë e kryerjes së veprës penale sot bie në kategorinë e kriminalitetit me shkallë të lartë rreziku për shoqërinë. Kjo gjë manifestohet jo vetëm në pasojat materiale që rezultojnë nga kryerja e këtyre veprave penale, por sidomos në rrënimin dhe çrregullimin e rrjedhave themelore të jetës shoqërore, duke atakuar vlerat morale të shoqërisë. Parandalimi i korrupsionit të veprat penale kundër detyrës zyrtare është elementi thelbësor i çdo strategjie gjithëpërfshirëse anti-korrupsion. Keqpërdorimi i detyrës zyrtare përveç që është një fenomen i pranishëm kudo në botë, është edhe sfidë e vazhdueshme si për shtetin dhe të drejtën, ashtu edhe për shtetin e së drejtës në veçanti, e deri të ballafaqimi me kufijtë e etikës njerëzore, si për zyrtarët publik ashtu edhe për qytetarët e një vendi. Kjo nuk është një dukuri e pranishme e re dhe siç do të shihet gjatë shtjellimit të këtij studimi, është e dëshmuar prania e saj në kohëra të ndryshme, pavarësisht stadi të zhvillimit të qytetërimit dhe jo vetëm thjeshtë e përcaktuar nën ndikimin e aspekteve politike dhe ekonomike që kanë mbretëruar. Bazuar në këtë që u përmend më lart, nevojitet një qasje me ndryshe, krejt kjo që të kemi rezultate të mira në luftën kundër korrupsionit vepër kjo që në shumicën e rasteve kryhet duke e keqpërdorur detyrën apo autoritetin zyrtar. Dihet mirë se sfidë e madhe për institucionet e ndjekjes është sigurimi i provave duke e marrë për bazë faktin se këto vepra penale kryhen nga një kategori e personave (personat zyrtar) të cilët janë një hap para organeve të ndjekjes dhe në mënyrë profesionale mbulohen me prova.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pjesëmarrësit pas përfundimit të këtij trajnimi do të jenë në gjendje që të:

- Zbatojnë drejtë dispozitat ligjore lidhur me kualifikimin juridik të veprave penale kundër detyrës zyrtare;
- Kryejnë hetime proaktive dhe të sigurojnë prova të pranueshme që mbështesin aktakuzat e ngritura, me të cilat fuqishëm do të bindet gjykata;
- Shqiptojnë sanksione adekuate penale ndaj kryerësve të këtyre veprave penale;
- Sekuestrojnë dhe konfiskojnë pasurinë e fituar me këto vepra penale;
- Aplikojnë praktikën më të mira të shteteve të ndryshme të botës në luftën kundër korrupsionit.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Kualifikimin juridik të veprave penale kundër detyrës zyrtare;
- ✓ Hetime proaktive dhe provat e pranueshme që mbështesin aktakuzat e ngritura;
- ✓ Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurinë e fituar me këto vepra penale.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij trajnimi do të përdoren metodat të kombinuara të shpjegimit teorik, ushtrime, diskutime dhe shembuj praktik.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Përfitues nga ky trajnim do të jenë gjyqtarë dhe prokurorë. Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

15. Nxitja e urrejtjes, e përçarjes ose e mos durimit kombëtar, racor, fetar ose etnik

Kusht për ndërtimin dhe funksionimin e një sistemi juridik demokratik dhe të qëndrueshëm është njohja dhe respektimi i diversiteteve të grupeve kombëtare, racore, fetare apo etnike. Ky postulat nënkupton njohjen dhe respektimin e të gjitha dallimeve lidhur me gjuhën, zakonet, veçoritë historike, përkatësisë fetare etj. Njohja dhe respektimi i këtyre veçorive, sipas konventave ndërkombëtare dhe të të drejtave nacionale, bën pjesë në liritë dhe të drejtat themelore individuale dhe kolektive. Për këtë arsye nxitja e urrejtjes, e përçarjes ose e mos durimit në baza të veçorive kombëtare, racore, fetare ose etnike është vlerësuar se duhet të konsiderohet vepër penale. Këtë koncept e ka pranuar edhe e drejta penale e Kosovës. Në linjë të dhënies precize të mekanizmave mbrojtës nëpërmjet të drejtës dhe standardeve ndërkombëtare është e nevojshme të përmendet se nuk ekziston një përkufizim i vetëm dhe përfundimtar për atë se çfarë është gjuha e urrejtjes dhe gjuha e urrejtjes si institut i veçantë, shpesh, vendoset në një hapësirë vakumi midis të drejtave të ndryshme dhe interpretimit të tyre (për shembull: e drejta e mbrojtjes nga diskriminimi dhe liria e fjalës), kështu që në pjesën e mbrojtjes është sidomos i rëndësishëm roli i gjykatave. Bazuar në këtë, është e nevojshme ngritja e mëtejme e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve në zbatim të drejtë të legjislacionit në fuqi dhe përforsimi i bashkëpunimit me institucionet tjera relevante për luftimin e suksesshëm të kësaj dukurie. Gjatë trajnimit pjesëmarrësit do të kenë mundësinë e qasjes në raste nga praktika, ku mund të shihen sfidat dhe problemet e zbatimit të drejtë të legjislacionit për parandalimin dhe luftimin e rasteve të nxitjes së urrejtjes, si dhe mënyrat se si mund të tejkalohen apo zgjidhen këto sfida dhe probleme.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zbatojnë drejtë legjislacionin lidhur me krimet e urrejtjes;
- Identifikojnë elementet e veprës penale të krimeve të urrejtjes;
- Zbatojnë dhe respektojnë të drejtat e viktimave të krimeve të urrejtjes në procedurën penale.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Kuptimi dhe elementet e veprës penale Nxitja e urrejtjes, e përçarjes ose e mos durimit kombëtar, racor, fetar ose etnik;
- ✓ Veprat penale të ndërlidhura më krimet e urrejtjes;
- ✓ Të drejtat e viktimave të krimeve të urrejtjes gjatë procedurës penale;
- ✓ Mbrojtja, asistimi dhe kompensimi i viktimave të krimeve të urrejtjes;
- ✓ Përforsimi i bashkëpunimit dhe koordinimit mes akterëve kyç;

Metodologjia e trajnimit

Gjatë trajnimit do të përdoren metoda interaktive, simulime të rasteve, punë në grupe për raste nga praktika si dhe pyetje e diskutime për temat e përfshira në këtë trajnim.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët dhe prokurorët e nivelit të Apelit dhe nivelit themelor. Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

16. Mjetet juridike në procedurën penale

Qëllimi i përdorimit të mjeteve juridike është evitimi i të metave juridike dhe faktike që pretendohet se janë bërë nga gjykata përkatëse. Kodi i Procedurës Penale parasheh që palët e pakënaqura me vendimet gjyqësore në procedurë penale, kanë të drejtë nën kushtet e caktuara që të përdorin mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zbatojnë drejtë rregullat e përgjithshme lidhur me mjetet juridike;
- Identifikoj bazat për të cilat mund të paraqitet mjetet juridike;
- Evitojnë disa nga dilemat e mundshme që janë paraqitur në praktikën gjyqësore.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Ankesa kundër aktgjykimit;
- ✓ Ankesat kundër aktvendimeve të gjykatave;
- ✓ Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë;
- ✓ Kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit;
- ✓ Rishikimi i procedurës penale.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij trajnimi do të përdoren bashkëbisedim aktiv me pjesëmarrësit lidhur me çështje dhe dilema nga praktika gjyqësore, duke mos e lënë anash diskutimin e situatave të ndryshme para të cilave do të gjendeshin gjyqtarët dhe prokurorët në vendosjen e rasteve lidhur me mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët dhe Prokurorët e të gjitha niveleve. Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

17. Veprat penale kundër jetës dhe trupit me fokus vepra penale të vrasjes dhe vrasjeve të rënda

Veprat penale kundër jetës dhe trupit dhe veçanërisht kundër jetës janë veprat penale të cilat në praktikën gjyqësore në vazhdimësi paraqesin probleme në kualifikimin e saktë dhe të mirëfilltë. Për më tepër, e drejta e njeriut për jetë është e drejta më e rëndësishme në grupin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe kjo e drejtë është absolute. Për këtë arsye, kjo e drejtë është e garantuar me aktet më të rëndësishme ndërkombëtare, por garantohet edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Mbrojtja e të jetës është e sanksionuar edhe me dispozitat e KPRK, duke përcaktuar formën themelore të saj dhe disa forma të kualifikuara dhe të privileguara të kësaj vepre penale. Do të flitet hollësisht për përkufizimin dhe elementet esenciale të veprës penale të vrasjes, rrethanat, mënyrat dhe format e kryerjes së vrasjes dhe problemet praktike me rastin e kualifikimit të vrasjeve të rënda. Këto dhe çështje tjera do të adresohen përmes këtij trajnimi duke zbërthyer dispozitat ligjore dhe duke analizuar rastet praktike.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Avancojnë njohurit për veprat penale të vrasjes dhe format e kualifikuara dhe të privileguara të saj;
- Identifikojnë format, rrethanat dhe aspekte tjera të veprat penale të vrasjeve të rënda;
- Analizojnë rastet praktike të këtyre veprave penale.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Veprat penale kundër jetës;
- ✓ Vrasja dhe llojet e vrasjeve;
- ✓ Vrasjet e kualifikuara dhe privileguara.

Metodologjia e trajnimit

Metodologjia e trajnimit do të fokusohet te diskutimi interaktiv me pjesëmarrësit, gjithashtu pjesëmarrësve, do t'ju ofrohen për të diskutuar në grupe edhe rastet nga praktika gjyqësore me qëllim të kualifikimit të drejtë juridik të veprave penale të këtij kapitulli.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët dhe prokurorët e nivelit themelor. Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

18. Masat e fshehta të hetimit dhe vëzhgimit

Masat e fshehta të hetimit dhe vëzhgimit janë ndër veprimet më të ndjeshme hetimore. Ndërmarrja e këtyre masave padyshim se prek privatësinë e jetës së individit, si një nga të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Në praktikën gjyqësore vendosja lidhur me këto masa ka hapësira për përmirësim, qoftë në respektimin e parimeve me rastin e dhënies së urdhrave për këto masa por edhe në mbikëqyrjen e zbatimit të tyre në aspektin praktikë. Me këtë veprime hetimor synohet sigurimi i provave të cilat do të shërbejnë si bazë për ngritjen e aktit akuzues dhe argumentimin e tij para gjykatës.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Vlerësojnë kushtet për lëshimin e këtyre masave;
- Sigurojnë prova të mjaftueshme dhe të pranueshme nga zbatimi i këtyre masave;
- Kompetenca, procedura dhe arsyetimi në urdhërimin e këtyre masave.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Masat e vëzhgimit dhe hetimit (të gjitha masat);
- ✓ Simulim të ndonjë vepre të korrupsionit;
- ✓ Pranueshmëria e provave të siguruara me anë të urdhrit për masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit dhe Paneli për Shqyrtimin e Vëzhgimit dhe Hetimit;
- ✓ Të drejtat e personave ndaj të cilëve zbatohen urdhëresa për masa të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë trajnimit, do të përdoren metodat interaktive, raste praktike, punë në grupe, pyetje dhe diskutime nga pjesëmarrësit.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët dhe prokurorët, mirëpo sipas nevojës dhe mundësisë realizuese edhe avokatët mbrojtës, mbrojtës të viktimave dhe zyrtarët policor. Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

19. Përgjegjësia penale e personave juridik

Personat juridik mund të përgjigjen për vepra penale nga pjesa e veçantë e Kodit Penal të Republikës së Kosovës edhe për vepra tjera penale, nëse janë plotësuar kushtet për përgjegjësinë e personit juridik të parapara me Ligjin për Përgjegjësinë e Personave Juridik për vepra penale. Sipas këtij ligji, personi juridik është përgjegjës për vepër penale të personit përgjegjës i cili duke vepruar në emër të personit juridik në kuadër të autorizimeve ka kryer vepër penale me qëllim që për atë, personi juridik të realizoj ndonjë dobi ose ka shkaktuar dëme. Përgjegjësia e personit juridik ekziston edhe atëherë kur veprimi i atij personi juridik ka qenë në kundërshtim me politikën afariste apo urdhrat e personit juridik. Mirëpo, edhe përkundër këtyre dispozitave ligjore, në praktikën gjyqësore paraqiten probleme të shpeshta në përcaktimin e përgjegjësisë penale të personave juridik.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zbatojnë drejtë institutin e përgjegjësisë penale të personave juridik sipas ligjit;
- Analizojnë njohuritë se kur mund të ndiqet penalisht një pëson juridik;
- Interpretojnë drejtë normat ligjore përgjegjësinë penale të personave juridik.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Korniza ligjore për ndjekjen penale të personave juridik;
- ✓ Llojet e shoqërive tregtare të cilat mund të ndiqen penalisht;
- ✓ Përgjegjësia penale e personit juridik për veprën penale dhe përgjegjësia penale e personit përgjegjës për veprën e kryer në emër të dhe për personin juridik;
- ✓ Llojet e dënimeve që mund ti shqiptohen personit juridik;
- ✓ Praktika e gjykatave vendore dhe e gjykatave nga EU dhe USA lidhur me përgjegjësinë penale të personave juridik.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë trajnimit do të përdoren metodat interaktive, simulim i rasteve, punë në grupe, pyetje dhe diskutime nga pjesëmarrësit të ndarë në grupe, simulime të rasteve me pjesëmarrësit në trajnim, diskutimi i vendimeve të gjykatave vendore dhe ndërkombëtare.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët, Prokurorët e Shtetit, Bashkëpunëtorët profesional. Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

20. Dhuna në familje

Dhuna në familje, paraqet një fenomen negativ të përhapur që sfidon jo vetëm shoqërinë kosovare në përgjithësi por edhe sistemin e drejtësisë në veçanti. Për këtë çështje *Raporti për Kosovën 2020* i Komisionit Evropian, lidhur me këtë çështje thekson se, citoj: "... dhuna në familje vazhdon të jetë forma më e përhapur e dhunës me bazë gjinore në Kosovë. Korniza ligjore dhe ajo institucionale në këtë fushë është kryesisht në përputhje me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare. Ligji për Dhunën në Familje duhet të harmonizohet me kodin e ri penal...". *Kodi Nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës* (tutje "KPRK"), në nenin 248 e ka përcaktuar dhunën në familje si vepër e posaçme duke i përcaktuar tiparet e figurës së kësaj veprë dhe duke përcaktuar sanksionet penale. Tutje, në këtë drejtim ka pasur zhvillime pozitive sa i përket kornizës ligjore. Sipas raportit për Kosovën 2020, në shtator të vitit 2020, Kuvendi miratoi një ndryshim në Kushtetutën e Kosovës, ndryshim ky që i jep efekt të drejtpërdrejtë Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit). Ky është një hap pozitiv në garantimin e të drejtave themelore, mbrojtjen e të drejtave të grave dhe në luftën kundër dhunës në familje. Megjithatë, sfida paraqet implementimi i dispozitave të nenit 248 të KPRK-së, në punën e përditshme të sistemit prokurorial dhe gjyqësore. Implementimi i kësaj dispozite hasi në vështirësi sa i përket rasteve kur në kuadër të dhunës në familje kryhej edhe vepër e veçantë penale, si Kanosja, Sulmi, lëndim i lehtë trupor etj., përkitazi me cilësimin juridik të veprës penale. Për këtë qëllim, u zhvilluan diskutime të vazhdueshme në mes të akterve vendor dhe ndërkombëtar që mbështesin sistemin gjyqësor në Kosovës përmes tryezave dhe forumeve të ndryshme të cilat dhanë rezultatin e pritur. Me 12 qershor 2020, Gjykata Supreme e Kosovës, miratoi *Udhëzimin me numër Gj.A.Su. 113/2020 lidhur me cilësimin juridik dhe trajtimin e rasteve të Dhunës në familje sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës*. Ky udhëzim paraqet një zhvillim të madh në avancimin e mekanizmave ekzistues institucional në adresimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje duke lehtësuar punën e prokurorëve dhe gjyqtarëve, përkitazi me cilësimin juridik të kësaj veprë penale.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Avancojnë njohuritë lidhur me legjislacionin për këtë fushë;
- Zgjerojnë njohuritë me praktikat unike në zbatim të legjislacionit;
- Analizojnë dispozitat te cilat i referohen rasteve te shkeljes se urdhrin mbrojtës.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Dhunës në familje sipas legjislacionit aktual;
- ✓ Elementet e përgjithshëm dhe ato të veçanta që e përbëjnë figurën e veprës penale të Dhunës në familje, sipas nenit 248 të KPRK-së;
- ✓ Dhuna psikologjike, Dhuna ekonomike; Trauma si rezultat i dhunës në familje;
- ✓ Cilësimi juridik në rastet kur në kuadër të Dhunës në familje është kryer edhe një veprë tjetër penale;
- ✓ Shkelja e urdhrin mbrojtës dhe dispozitat ligjore që aplikohet me rastin e për cilësim juridik;
- ✓ Implementime i udhëzimet të Gjykatës Supreme, (Udhëzuesi me numër *Gj.A.Su. 113/2020*);
- ✓ Dhuna në familje nga kryesit me çrregullime mendore.

Metodologjia e trajnimit

Trajnimet do të organizohen në formë të prezantimeve nga ana e trajnues me përvojë në rastet e Dhunës në Familje të cilët do të ofrojnë materiale teorike dhe shembuj praktike. Kjo metodologji aplikon format e ushtrimeve me raste praktike, diskutim në grup të madh apo të ndarë në nën-grupe, simulime të rasteve me pjesëmarrësit në trajnim, diskutimi i arsytimeve të vendimeve të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme. Materialet e parashikuara për këtë modul do të jenë, dispozitat respektive të legjislacionit në fuqi, udhëzimi i gjykatës supreme dhe aktvendimi të gjykatës.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Përfitues të këtij trajnimi do të jenë Gjyqtarët, Prokurorët e Shtetit, Bashkëpunëtorët profesional. Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Programet e Specializuara

21. Krimi Kibernetik

Me mbështetjen e shoqërive në të gjithë botën në teknologjitë e informacionit dhe komunikimit, gjyqtarët dhe prokurorët duhet të jenë të përgatitur për të gjykuar krimin kibernetik dhe shqyrtuar provat elektronike. Megjithëse në shumë vende, autoritetet e zbatimit të ligjit i kanë forcuar kapacitetet e tyre për hetimin e krimit kibernetik dhe sigurimin e provave elektronike, kjo gjë nuk ndodh me gjyqtarët dhe prokurorët. Përvoja të sugjeron se në shumicën e rasteve, gjyqtarët dhe prokurorët hasin vështirësi në përballje me realitetet e reja të botës kibernetike. Për këtë arsye, kërkohen përpjekje të posaçme për të aftësuar gjyqtarët dhe prokurorët që të mund të ndjekin ligjërisht dhe gjykojnë krimin kibernetik dhe të shfrytëzojnë provat elektronike nëpërmjet trajnimit, lidhjes në rrjet dhe specializimit. Krimi Kibernetik sot është një nga sfidat me të mëdha ligjore. Që nga viti 2000 e deri me tani interneti është zgjeruar me një norme mesatare mjaft të lartë në nivel global dhe aktualisht me miliarda njerëz janë online. Hapësira kibernetike sot është një nga sfidat më të mëdha ligjore e cila ka nxitur një formë tjetër të krimit, duke krijuar një mjedis për metodat e reja të krimit, tani pothuajse të gjitha krimet mund të kryhen me përdorimin e kompjuterëve.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Identifikojnë fushën e krimit kibernetik – tendencat dhe instrumentet;
- Avancojnë njohuritë rreth teknologjisë e përfshirë në krimin kibernetik;
- Zgjerojnë njohuritë për Krimin kibernetik si vepër penale në legjislacionin e brendshëm;
- Zbatojnë drejtë legjislacionin, procedurat dhe praktika në lidhje me provat elektronike;
- Ligji procedural/masat hetimore në legjislacionin e brendshëm;
- Njohin Legjislacionin ndërkombëtar dhe Bashkëpunimin ndërkombëtar.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

Sesioni I

- ✓ Krimi kibernetik – tendencat dhe instrumentet;
- ✓ Teknologjia e përfshirë në krimin kibernetik.

Sesioni II

- ✓ Krimi kibernetik si vepër penale në legjislacionin e brendshëm;
- ✓ Legjislacioni, procedura dhe praktika në lidhje me provat elektronike.

Sesioni III

- ✓ Ligji procedural/masat hetimore në legjislacionin e brendshëm;
- ✓ Legjislacioni ndërkombëtar/Konventa Budapestit;
- ✓ Bashkëpunimi ndërkombëtar.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë trajnimit, do të përdoren metodat interaktive, simulim i rasteve, punë në grupe, pyetje dhe diskutime nga pjesëmarrësit, përdorimi i teknologjisë dhe i paisjeve (provave) elektronike gjatë trajnimit.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët dhe prokurorët e nivelit të apelit dhe niveli themelor. Trajnimi do të zgjate tri sesione nga dy (2) ditë.

22. Shpëlarja e parave dhe hetimi financiar

Pastrimi i parave paraqet një rëndësi të veçantë në veprat penale më komplekse për shkak të mënyrës së kryerjes dhe personave të përfshirë si kryerës. Në vitet e fundit Kosova gjithnjë e më tepër po zgjeron bashkëpunimin me vendet tjera të Bashkimit Evropian dhe po bënë përpjekje të vazhdueshme për të qenë pjesë e të gjitha strukturave euro atlantike. Në vazhdim të këtyre përpjekjeve Kosova ka marr përgjegjësinë që të hartoj legjislacionin në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian dhe të zbatoj në praktikë të gjitha këto standarde, në mënyrë që të parandaloj dhe luftoj të gjitha veprimet jo formale që i sjellin vendit humbje apo dëme të mëdha financiare, që mund të ndikojnë drejtpërsëdrejti në zhvillimin ekonomik. Ndër dilemat e ngritura në praktikën gjyqësore është identifikimi i elementeve të veprave penale që ndërlikohen më pastrimin e parave, kualifikimin e saktë juridik të kësaj vepre penale dhe hetimit efektiv financiar. Gjithashtu dilema më thelbësore në praktikë është paraqitja e rasteve kur ekziston mundësia e shpalljes fajtorë për pastrim të parave, të personave të cilët për ndonjë arsye, nuk mund të shpallën fajtorë për veprën penale bazë, si dhe sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë së fituar përmes pastrimit të parave. Një sfidë tjetër paraqitet edhe tek rastet e bashkëpunimit ndërkombëtar në mes organeve të ndjekjes së Republikës së Kosovës dhe organeve të ndjekjes së vendeve tjera e në veçanti më ato të Bashkimit Evropian. Bazuar në praktikën gjyqësore dhe prokuroriale mund të nxjerrët nevoja për një qasje ndryshe nga ajo që është parë deri më tani, sepse qasja e prokurorëve dhe gjyqtarëve duhet të bazohet jo vetëm në dispozitat e KPK dhe KPPK por edhe në dispozitat e ligjit të veçantë që trajton pastrimin e parave si vepër penale, si dhe ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë, andaj trajnimi do të fokusohet shumë në pyetje dhe përgjigje si dhe në nxitjen e diskutimeve për dilemat dhe sfidat e paraqitura gjatë punës praktike në prokurori dhe gjykatë.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zbatojnë drejtë, dispozitat ligjore lidhur me kualifikimin juridik të pastrimit të parave;
- Avancojnë njohurit lidhur me hetime proaktive penale dhe financiare dhe të sigurojnë prova të pranueshme që mbështesin aktakuzat e ngritura;
- shqiptojnë sanksione adekuate penale ndaj kryerësve të këtyre veprave penale;
- sekuestrojnë dhe konfiskojnë pasurinë e fituar me këto vepra penale;
- krahasojnë legjislacionin vendor me atë të BE-së;
- zbatojnë format e ndryshme të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

Sesioni I

- ✓ Baza ligjore, vendore dhe ndërkombëtare për luftimin e pastrimit të parave dhe hetimet financiare;
- ✓ Identifikimi i elementeve të veprës penale pastrimi i parave;
- ✓ Fazat e pastrimit të parave;
- ✓ Kompetencat dhe bashkëpunimi me Njësinë për inteligjencë financiare;
- ✓ Subjektet raportuese sipas Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave;
- ✓ Rast studimi.

Sesioni II

- ✓ Hetimi dhe sigurimi i provave në rastet e pastrimit të parave;
- ✓ Teknikat e ekzaminimit të mashtrimeve tek pastrimi i parave;
- ✓ Mbledhja e informatave;
- ✓ Përgatitja e profilit personal;
- ✓ Gjurmimi i fondeve nga ana e marrësit;
- ✓ Gjurmimi i fondeve nga ana e paguesit;
- ✓ Rikthimi i pasurive të fshehura;
- ✓ Rast studimi.

Sesioni III

- ✓ Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë së fituar më veprën penale – pastrimi i parave;
- ✓ Bashkëpunimi ndërkufitar dhe ndërkombëtar për luftimin e pastrimit të parave;
- ✓ Zgjidhjet e mundshme alternative;
- ✓ Përgatitja e rastit për gjykatë;
- ✓ Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë së fituar më veprën penale – pastrimi i parave;
- ✓ Sanksionet penale ndaj kryerësve të veprës penale të pastrimit të parave;
- ✓ Rastet kur personat shpallën fajtor për pastrim të parave pa u shpallur fajtor për veprën penale bazë;
- ✓ Rast studimi.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë trajnimit, do të përdoren metodat interaktive, simulim i rasteve, punë në grupe, pyetje dhe diskutime nga pjesëmarrësit

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Prokurorët dhe gjyqtarët e shkallës së parë dhe shkallës së dytë, duke përfshirë në veçanti edhe prokurorët special dhe gjyqtarët e departamentit special në të dy nivelet. Trajnimi do të zgjate tri sesione nga dy (2) ditë.

23. Krimi i organizuar dhe korrupsioni

Krimi i organizuar është një nga sfidat më të mëdha bashkëkohore. Konventa e OKB-së kundër krimit të organizuar ndërkombëtar dhe dy protokollet shtesë të saj, paraqesin instrumentet me të rëndësishme ndërkombëtare që krijojnë bazë juridike solide për parandalimin dhe ndjekjen penale efektive të krimit të organizuar transnacional, gjë për të cilën edhe Republika e Kosovës ka përvetësuar pothuajse të gjitha dispozitat e këtij instrumenti duke i transpozuar në një mori aktesh nacionale. Pasojat e veprimtarisë kriminale të grupeve të organizuara janë evidente, ku krimi i organizuar përbën një kërcënim serioz për sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare dhe paraqet pasoja të dëmshme për shëndetin dhe sigurinë publike, institucionet demokratike, stabilitetin makro-financiar dhe ekonomik. Grupet e organizuara kriminale në Kosovë karakterizohen me disa karakteristika si në vijim: struktura hierarkike, besnikëria, bashkëpunimi në mes grupeve kriminale, diversiteti i krimit, ashpërsia dhe agresiviteti, korruptimi i zyrtarëve dhe disa karakteristika tjera.

Situata aktuale në raport me aktivitetet e grupeve kriminale në Republikën e Kosovës përfshinë këto forma të krimit të organizuar: trafikimin me narkotikë, trafikimin me njerëz, kontrabanda me mallra, kontrabandimi me emigrantë, trafikimi me armë, krimet kompjuterike, korrupsioni dhe shpëlarja e parave. Ekzistenca e grupeve kriminale të organizuara është e ndërlidhur ngushtësisht me moszbatimin e ligjit nga autoritetet publike, e që kjo reflektohet me infiltrimin e grupeve kriminale brenda autoriteteve publike duke përdorur instrumentin e korrupsionit për mbijetesë dhe vazhdimësi, duke shfrytëzuar zyrtarët publikë për ta mbajtur në jetë veprimtarinë kriminale. Korrupsioni si instrument komprometues mund të përdoret në dy forma, në rastin e parë vet korrupsioni mund të kryhet në formë të organizuara nga një grup i strukturuar, dhe në rastin e dytë korrupsioni përdoret si instrument për neutralizimin e zbatuesve të ligjit karshi veprimtarisë kriminale ilegale, duke i krijuar ambient të përshtatshëm për ushtrimin e papenguar të veprimtarisë kriminale.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të trajnimit, pjesëmarrësi do të jenë në gjendje që të:

- Përkufizojë krimin e organizuar dhe ndërlidhjen e tij me korrupsionin;
- Shpjegojë dhe të dallojë format e krimit të organizuar;
- Demonstrojë përvetësimin e teknikave të veçanta hetimore, përkatësisht strategjive hetimore, sekuestrimin e produkteve të krimit dhe bashkëpunimin ndërkombëtar;
- Zbatojë ligjin lidhur me konfiskimin dhe sanksionet penale ndaj kryerësit të veprave penale të krimit të organizuar.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

Sesioni I

- ✓ Korniza ligjore ndaj krimit të organizuar dhe tregjet e krimit të organizuar;
- ✓ Shkaqet dhe faktorët lehtësues të krimit të organizuar;
- ✓ Infiltrimi i krimit të organizuar në biznese dhe në institucione publike;
- ✓ Ndërlidhja ndërmjet krimit të organizuar dhe korrupsionit;
- ✓ Format e krimit të organizuar.

Sesioni II

- ✓ Teknika të veçanta hetimore të krimit të organizuar;
- ✓ Mbrojtja e dëshmitarëve dhe të drejtat e viktimave tek krimi i organizuar;
- ✓ Strategjitë e Prokurorisë për hetimin e grupeve kriminale;
- ✓ Sekuestrimi i corpora delictit tek krimi i organizuar;
- ✓ Korniza strategjike dhe institucionale në fushën e bashkëpunimit në çështjet penale.

Sesioni III

- ✓ Konfiskimi i pasurisë së fituar me anë të veprës penale;
- ✓ Sanksionet penale kundër kryerësve të veprave penale të krimit të organizuar;
- ✓ Lidhjet ndërmjet krimit të organizuar dhe terrorizmit.
- ✓ Strategjia kombëtare kundër krimit të organizuar në Kosovë.

Metodologjia e trajnimit

Tema e këtij trajnimi do të ligjërohet me ligjërata interaktive, përkatësisht do të kombinohet me raste studimore, duke u përcaktuar në zgjidhjen e detyrave individuale dhe atyre grupore brenda vijuesve.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatave Themelore si dhe bashkëpunëtor profesional nga Departamenti Special. Trajnimi do të zgjatë tri sesione nga dy (2) ditë.

24. Program i Specializuar “Mashtrimi dhe Korrupsioni në Prokurim Publik

Bazuar në raportet e institucioneve dhe organizatave që monitorojnë prokurimin publik dhe raportet e Auditorit të Përgjithshëm, vlerësohet se prokurimi publik është një prej fushave ku ka korrupsion dhe se ka nevojë për zhvillim të njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve për këtë fushë. Po ashtu, është kërkesë e vazhdueshme e gjyqtarëve dhe prokurorëve që të diskutojnë me të gjithë akterët relevant në vend rreth procedurave të prokurimit publik dhe problemeve të zbatimit të tyre në praktikë. Ky program adreson kërkesat e lartpërmendura duke u fokusuar në elaborimin praktik të të gjitha fazave të prokurimit publik. Në këtë kuadër do të analizohen rastet nga praktika rreth mënyrës së vlerësimit të nevojave dhe përcaktimit të kërkesave, dosja e tenderit dhe procesi i vlerësimit të një tenderi. Në fokus të këtij programi do të jenë edhe faza e implementimit të kontratës dhe po ashtu hetimi dhe gjykimi i veprave penale të kësaj natyre.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Kuptojnë dhe zbërthejnë parimet kryesore dhe procedurat e prokurimit dhe dosjen e tenderit;
- Identifikojnë funksionet kryesore të institucioneve në fushën e prokurimit;
- Kuptojnë përkufizimin e mashtrimit dhe korrupsionit në prokurim;
- Identifikojnë skemat mashtruese dhe të korrupsionit në fazat e prokurimit;
- Analizojnë procesin e planifikimit të prokurimit;
- Kuptojnë përgjegjësitë e komisionit vlerësues, zgjedhjen e kontraktorit dhe dhënies së çmimit;
- Analizimin e procesit të ankesave dhe përgjegjësi në menaxhimin e kontratës;
- Identifikojnë indikatorët e korrupsionit dhe mashtrimit që lidhen me prokurimin publik;
- Hartojnë një plan për hetimin e veprave penale të korrupsionit në prokurimin publik;
- Zbulimin e konfliktit të interesit.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

Sesioni I

Parime e përgjithshme

- ✓ Parimi i efektivitetit në kosto dhe efikasitetit
- ✓ Parimi i konkurrencës
- ✓ Barazia e trajtimit/mos-diskriminimi;
- ✓ Transparenca;
- ✓ Procedurat e hapura dhe të kufizuara;
- ✓ Procedurat e negociuara pas dhe pa publikimit të njoftimit të kontratës;
- ✓ Procedurat për kuotimin e çmimeve dhe procedurat për kontratat me vlerë minimale dhe kontratat e pronës së paluajtshme;
- ✓ Kontratat Publike Kornizë.

Korniza institucionale në fushën e prokurimit publik

- ✓ Komisioni rregullator i prokurimit publik
- ✓ Organi shqyrtues i prokurimit
- ✓ Agjencia qendrore e prokurimit
- ✓ Rolet dhe përgjegjësitë në procesin e vendimmarrjes në ciklin e prokurimit brenda autoritetit kontraktues

- ✓ Zyrtari kryesor administrativ (ZKA), Zyrtari kryesor financiar (ZKF), Zyrtari autorizues (ZA) dhe Zyrtari certifikues (ZC)
- ✓ Zyrtar përgjegjës i prokurimit (ZPP)
- ✓ Departamenti i prokurimit
- ✓ Njësia kërkuese
- ✓ Menaxheri i projektit

Përkufizimi i korrupsionit dhe mashtrimit

- ✓ Shkaqet e korrupsionit;
- ✓ Psikologjia prapa mashtrimit dhe elementeve të mashtrimit;
- ✓ Arsyet prapa mashtrimin në prokurim;
- ✓ Korrupsioni dhe veprat mashtruese sipas KPK- së.

Korrupsioni dhe mashtrimi në procesin e prokurimit

- ✓ Mashtrimi dhe korrupsioni në fazën para tenderimit- skemat tipike të mashtrimit në prokurim gjatë fazës para tenderimit;
- ✓ Mashtrimi dhe korrupsioni në fazën e tenderimit- skemat tipike të mashtrimit në prokurim gjatë fazës së tenderimit;
- ✓ Mashtrimi dhe korrupsioni në fazën pas dhënies së kontratës-skemat tipike të mashtrimit në prokurim gjatë fazës pas dhënies së kontratës.

Sesioni II

Procesi i planifikimit dhe fillimit të procedurës

- ✓ Planifikimi i prokurimit;
- ✓ Inicimi i prokurimit;
- ✓ Dosja e tenderit;
- ✓ Specifikimet teknike;
- ✓ Kriteret e përzgjedhjes.

Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

- ✓ Komisioni i vlerësimit;
- ✓ Dhënia e kontratës.

Ankesat dhe Menaxhimi i Kontratës

- ✓ Korrupsioni - ryshfeti dhe haraçi;
- ✓ Pagesat dhe ndikimi korruptiv;
- ✓ Ofertat me marrëveshje mashtruese
- ✓ Ofertimi “formal”

Specifikime të manipuluar/përshtatja enkas e ofertave

- ✓ Manipulimi i ofertave;
- ✓ Metodat jo-konkurruese të prokurimit ose procedurat njëburimore të paarsyeshme;
- ✓ Prokurimet e ndara.

Mashtrime me fatura

- ✓ Bashkëdyzimi i punëve në kontrata;
- ✓ Faturimi i rrejshëm i kostove;
- ✓ Faturimi i rremë në raportet kontabël;
- ✓ Faturimi i rremë material;
- ✓ Faturimet e rreme të fuqisë punëtore;
- ✓ Skemat e çmimeve të mangëta në kontrata me negociim;

- ✓ Dështimi në përmbushje të specifikimeve të kontratës;
- ✓ Faturat e rreme, të fryra ose të dyfishuara;
- ✓ Ofruesit fiktiv të shërbimeve ;
- ✓ Zëvendësimi i produktit.

Hetimi dhe zbulimi i korrupsionit dhe mashtrimit

- ✓ Identifikimi i burimeve të informacionit;
- ✓ Planifikimi dhe zhvillimi i hetimeve;
- ✓ Përdorimi i teknikave dhe metodave speciale të hetimit.

Identifikimi i konfliktit të interesave në prokurim publik

- ✓ Përkufizime të konfliktit të interesit;
- ✓ Konflikti i interesit sipas kodit etik të prokurimit të KRPP-së;
- ✓ Deklarata lidhur me mungesën e konfliktit të interesit.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë trajnimit, do të përdoren metodat interaktive, simulim i rasteve, punë në grupe, pyetje dhe diskutime nga pjesëmarrësit.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët e Gjykatave Themelore, duke përfshirë edhe gjyqtarët e Departamentit Special, prokurorët e Prokurorive Themelore si dhe ata të Prokurorisë Speciale dhe zyrtarët hetues policor. Trajnimi do të zgjatë dy sesione nga dy (2) ditë.

25. Ekstremizmi, radikalizmi dhe terrorizmi

Terrorizmi vazhdon të mbetet një nga kërcënimet kryesore të sigurisë, si në nivel nacional njashu edhe në nivel ndërkombëtar, duke kërcënuar jo vetëm jetën dhe pronën e individit, por edhe vlerat demokratike dhe vetë mënyrën e funksionimit të shoqërisë. Trendi global i terrorizmit dhe shtrirja e tij, sidomos gjatë dy dekadave të fundit, ka kërcënuar edhe Republikën e Kosovës, si dhe gjithë rajonin, Evropën dhe më gjerë. Parandalimi dhe luftimi i terrorizmit vazhdon të mbetet një ndër prioritetet kryesore strategjike të Republikës së Kosovës. Strategjia kundër terrorizmit si dhe masat tjera legjislative dhe politike në kuadër të kësaj fushe, janë të ndërlidhura me prioritet strategjike për “Qeverisja të Mirë dhe Sundimit të Ligjit.” Gjithashtu ndërlidhet me procesin e integritimit evropian dhe si e tillë është pjesë e Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit 2017-2021 dhe të konkluzioneve të takimit të parë të nën-komitetit për Drejtësi, Liri dhe Siguri në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Për shkak të pranisë së elementëve të ekstremizmit dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm, janë hartuar një mori instrumentesh të rëndësishëm ligjor, ku fokus ka qenë lufta efektive ndaj këtyre dukurive të kundërligjshme, gjithnjë nga perspektiva e instrumenteve të sistemit të drejtësisë, përkatësisht ndjekjes dhe gjyqimit. Marrë në konsideratë nevojën e ngritjes së kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve shihet e domosdoshme që ky komunitet i ligj-zbatuesve të përfitojnë nga këto cikle trajnimesh me synim të ngritjes së njohurive, shkathtësive dhe kompetencave në funksion të hetimit dhe gjyqimit efektiv, të pavarur dhe profesional.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të trajnimit, pjesëmarrësi do të jenë në gjendje që të:

- Avancojnë njohuritë rreth kornizës ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare kundër terrorizmit;
- Kuptojë ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin që favorizojnë terrorizmin;
- Demonstrtojë teknikën e hetimit dhe të provuarit të terrorizmit, me theks të veçantë për liritë dhe të drejtat e njeriut, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe mbrojtjen e viktimave;
- Krahasojë lidhjet ndërmjet terrorizmit dhe krimit të organizuar;
- Zbatojë drejtë ligjin lidhur me sanksionet penale ndaj kryerësit të veprave penale të terrorizmit.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

Sesioni I

- ✓ Vështrimi i kornizës ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare kundër terrorizmit;
- ✓ Parandalimi i terrorizmit, si fokus strategjik i përpjekjeve antiterroriste;
- ✓ Të kuptuarit dhe përballja me ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin që favorizojnë terrorizmin.

Sesioni II

- ✓ Teknikat e hetimit dhe të provuarit të terrorizmit;
- ✓ Liritë dhe të drejtat themelore të njeriut të rrezikuara nga masat represive kundër terrorizmit;

- ✓ Korniza strategjike dhe institucionale në fushën e bashkëpunimit në çështjet penale kundër terrorizmit;
- ✓ Viktimat e terrorizmit dhe qasja në drejtësi nga perspektiva e viktimave.

Sesioni III

- ✓ Sanksionet penale kundër kryerësve të veprave penale të terrorizmit;
- ✓ Lidhjet ndërmjet krimit të organizuar dhe terrorizmit.
- ✓ Strategjia kombëtare kundër terrorizmit në Kosovë.

Metodologjia e trajnimit

Tema e këtij trajnimi do të ligjërohet me ligjërata interaktive, përkatësisht do të kombinohet me raste studimore, duke u përcaktuar në zgjidhjen e detyrave individuale dhe atyre grupore brenda vijuesve.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatave Themelore. Trajnimi do të zgjatë tri sesione nga dy (2) ditë.

Punëtori dhe tryeza nga lëmia penale

26. Politika ndëshkimore dhe zbatimi i udhëzuesit

Politika ndëshkimore paraqet sfidë të vazhdueshme për gjyqtarët me rastin e caktimit të rrethanave lehtësuese dhe rënduese me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit. Si rezultat i kësaj janë identifikuar probleme të shumta në trajtimin e pabarabartë të kryerësve të veprave penale dhe mos konsistencë në shqiptimin e dënimeve dhe kjo ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në uljen e transparencës dhe besimin e publikut. Me qëllim të evitimit të këtyre të metave dhe ndihmës për gjyqtarë dhe veçanërisht unifikimit të politikës ndëshkimore, Gjykata Supreme e Kosovës ka nxjerr udhëzuesin për politikën ndëshkimore dhe tabelën për caktimin e dënimit për kryerësin e veprës penale dhe veprën penale të kryer. Duke marrë parasysh dobësitë dhe mangësitë e evidentuara në politikën ndëshkimore është formuar Komisionit Konsultativ për Politikë Ndëshkimore i cili në vazhdimësi përcjellë dukuritë dhe sfidat që gjyqtarët përballen me rastin e zbatimit të udhëzuesit për politikën ndëshkimore dhe gjatë punës së tij në vazhdimësi nxjerr udhëzime specifike përkitazi me harmonizimin e politikës ndëshkimore dhe të cilat do të prezantohen dhe diskutohen gjatë këtyre tryezave që planifikohen të organizohen.

Objektivat e tryezës

Pas përfundimit të kësaj tryeze, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Analizojnë rëndësinë e përcaktimit të drejtë dhe të saktë të rrethanave lehtësuese dhe rënduese;
- Zbatojnë rrethanat relevante me rastin e caktimit të dënimit;
- Analizojnë zbatimin e udhëzuesit dhe aktivitetin e Komisionit Konsultativ për Politikë Ndëshkimore.

Përmbajtja e tryezës

- ✓ Rrethanat lehtësuese dhe rënduese me rastin e caktimit të dënimit;
- ✓ Zbatimi i udhëzuesit për politikën ndëshkimore;
- ✓ Aktiviteti i Komisionit Konsultativ për Politikë Ndëshkimore.

Metodologjia e tryezës

Metodologjia e punës në tryezë do të fokusohet te diskutimi interaktiv me pjesëmarrësit, përkitazi me problemet praktike të aplikimit të rrethanave rënduese dhe lehtësuese me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, përmirësimit dhe harmonizimit të politikës ndëshkimore. Do të diskutohet posaçërisht për zbatimin e udhëzuesit për politikën ndëshkimore, si dhe do të prezantohet aktiviteti i Komisionit Konsultativ për Politikë Ndëshkimore.

Përfutjesit dhe kohëzgjatja e tryezës

Gjyqtarët dhe prokurorët e nivelit themelor. Tryeza do të zgjatë dy (2) ditë.

27. Sekuestrimi dhe konfiskimi

Tryeza për çështje të sekuestrimit dhe konfiskimit ka si qëllim trajtimin e sfidave të praktikës gjyqësore lidhur me zbatimin e dispozitave të Kodit penal dhe procedural si dhe të ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë. Sekuestrimi dhe konfiskimi rregullohet nga prizmi procedural nga dy ligje paralele që gërshetohen ndërmjet tyre në kuptimin e zbatimit praktik, si dhe nga dispozitat e kodit penal që lidhen me konfiskimin. Përkundër se dispozitat ligjore posaçërisht me ligjin për kompetencat e zgjeruara kanë synuar avancimet e legjislacionit nga ana tjetër praktika gjyqësore gjerë më tani nuk reflekton se ka avancuar në kuptimin e sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë dhe unifikimit praktik të zbatimit ligjor. Aktualisht sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale parashohin një mori dispozitash ligjore që rregullojnë aspektet e sekuestrimit por edhe të konfiskimit, gjë që reflekton se më tepër ka dispozita që rregullojnë sekuestrimin, se sa në thelb konfiskimin. Andaj kjo tryezë synon edhe trajtimin në kuptimin praktik dhe ligjor të dispozitave të sekuestrimit dhe konfiskimit gjithnjë në gërshetim edhe me dispozitat e ligjit të veçantë për konfiskimin e pasurisë.

Tryeza në thelb do të shërbente për dy qëllimet për gjyqtarët dhe prokurorët dhe atë:

- Të reflektohet praktika e ndërtuar gjyqësore;
- Të shfaqen rastet praktike si të gabuara nga instancat e larta gjyqësore për të parandaluar gabimet e njëjta apo të ngjashme në të ardhmen në praktikën gjyqësore.

Për tu arritur këto dy qëllime, duhet të kihet parasysh disa faktorë themelor, që do ta reflektonin tryezën me rezultate pozitive, e që faktorët e tillë do të ishin:

- ✓ Hulumtimet dhe zgjedhja e rasteve praktike të bëhet me kujdes;
- ✓ Specifikat e problemeve praktike në kuadër të sekuestrimit dhe konfiskimit;
- ✓ Zgjedhja e rasteve praktike të reflektoj zgjedhjet e niveleve të ndryshme të gjykatave;
- ✓ Zgjedhjet e rasteve praktike si të gabuara të trajtohen vetëm në kufizimet e gabimeve me theks të mos përsëritjeve në praktik, gjithnjë duke pasur kujdes nëse rasti u konstatua si gabim por ende nuk ka marr epilog të zgjidhjes përfundimtare;
- ✓ Refleksionet për veprimet në të ardhmen bazuar në situatën praktike.

Për ta zbatuar me efektivitet dhe rezultat tryezën, duhet të jenë të gatshëm dhe të përgatitur mjaftueshëm moderatorët e tryezës e që do të konsistonte në mundësin e dhënies se komenteve mbështetur në praktikën gjyqësore bazuar në legjislacionin në fuqi për çdo çështje që mund të trajtohet, qoftë të sekuestrimit qoftë të konfiskimit. Korniza e agjendës që do të përfshinte temat si të tilla duhet të zgjidhen me shumë kujdes, e që do të bazohet mbi aspektet e problematikave aktuale procedurale dhe materiale në kontekstin e praktikës së ndërtuar. Si të tilla temat do të reflektonin problemet nga praktika për sekuestrimin, si rezultat i përfitimit nga vepra penale, si mjete që kanë mundësuar kryerjen e veprës penale, dhe sekuestrimi për shkak të natyrës së sendit/pasurisë, sekuestrimi që mund të konsiderohet provë dhe procedura e ndjekur. Bazat e konfiskimit dhe aspektet praktike të konsoliduara të konfiskimit dhe tema tjera specifike. Praktika gjyqësore e përzgjedhur për tryezën do të ndihmonte që të reflektonte zbatimin i drejt i dispozitave nga gjyqtarët dhe prokurorët për të reflektuar standardet e ndërtuara praktike të pranueshme brenda instancave gjyqësore.

Kjo tryezë ka synim interaktivitetin dhe përfshirjen e të gjithë pjesëmarrësve si dhe ushtrime të rasteve. Çdo temë që do të prezantohet do të ketë synim paraqitjen e disa rrethanave praktike të ndërlidhura me temën që trajtohet, duke vë në shpërfaqje dilemat që ngërthen në vete ajo temë. Moderator-i/ët duhet të jenë të gatshëm dhe të diskutojnë rrethanat e paraqitura të

rastit/rasteve në raport me temën duke nxitur analizën dhe shterimin e dilemave të rrethanave të rastit, gjithnjë duke synuar në dhënien e shpjegimeve bazuar në praktikën e konsoliduar dhe në dispozitat ligjore me interpretimin e drejt.

Në përfundim të punimeve të tryezës moderatorët hartojnë raportin e tryezës me rezultate i cili do të mund të shërbente për të adresuar ndonjë çështje në kuadër të Akademisë apo që do të reflektonte në domosdoshmërinë e qëndrimeve parimore të gjykatës Supreme për të unifikuar zbatimin e ligjeve nga gjyqtarët, e që do të reflektonte edhe tek prokurorët.

Objektivat e tryezës

- Identifikimin e problemeve ligjore për sekuestrimin dhe konfiskimin;
- Identifikimi i praktikave jo të përputhshme në gjykatat themelore;
- Identifikimin e praktikave jo të përputhshme të gjykatës së Apelit me praktikën e konsoliduar të gjykatës Supreme;
- Adresimi i problemeve përmes praktikës së njësuar gjyqësore si përfundim.

Përmbajtja e tryezës

- ✓ Sekuestrimi i sendeve/pasurisë: si prova, si dobi, si mjet, për shkak të natyrës.
- ✓ Rregullimi procedural, për sekuestrimin, masat për sigurimin e pasurisë, ngrirja e përkohshme dhe urdhrat ndalues, urdhri për ndalim afatgjatë.
- ✓ Rregullimi procedural sipas ligjit të veçantë për sekuestrimin dhe konfiskimin.
- ✓ Konfiskimi i pasurisë, shqyrtimi për konfiskimin e pasurisë dhe urdhri për konfiskim.

Metodologjia e tryezës

Prezantimi i rasteve praktike, diskutimi mbi rastet praktike në kontekst të zgjidhjeve ligjore, përmbledhja e përfundimeve të nxjerra.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e tryezës

Përfituesit dhe fokus grupet ndahen në dy nivele. Në nivelin e parë përfituesit janë gjyqtarët e gjykatës së Apelit dhe Prokurorët e shtetit dhe të Apelit. Në nivelin e dytë përfituesit janë gjyqtarët e Gjykatave Themelore dhe prokurorët e prokurorive Themelore dhe Speciale. Tryeza duhet të zgjat tri ditë për tu ndërtuar në dy nivele. Niveli i parë në kohëzgjatje një ditore, që do të përfshinte gjykatën Supreme dhe Gjykatën e Apelit, Prokurorët e Shtetit dhe të Apelit. Niveli i dytë në kohëzgjatje dy ditore, që do të përfshinte gjykatën Supreme dhe të Apelit, gjykatat Themelore dhe Prokurorët Special, të Apelit dhe Prokurorët në Prokurorit Themelore.

Drejtësia Civile

28. Kompensimi i dëmit dhe bazat e përgjegjësisë

Numri i madh i kontesteve gjyqësore për shpërblimin e dëmit, qoftë të dëmit material apo jo material, praktika gjyqësore jo e harmonizuar sa i përket vendosjes dhe kriterëve për përcaktimin e lartësisë së dëmit jo material, janë indikator që tregojnë se kjo temë është shumë me rëndësi të trajtohet me gjyqtar. Është parim se kush shkakton dëmin me fajin e vetë, përgjigjet për dëmin e shkaktuar (përgjegjësia subjektive). Përgjegjësia objektive ose baza e përgjegjësisë pa faj është përgjegjësi për sendet e rrezikshme dhe veprimtari të rrezikshme. Për të ekzistuar përgjegjësia për dëmin e shkaktuar duhet të plotësohen kushtet e caktuara, e që këto kushte dallohen kur dëmin shkaktohet sipas bazës së përgjegjësisë subjektive dhe kur dëmi shkaktohet sipas përgjegjësisë objektive, e që për këto kushte do të shtjellohen në këtë trajnim. Në raste se subjekti i dëmtuar vërteton ekzistimin e kushteve të përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, krijohet detyrimi që dëmin e tillë të shpërblejë. Në rastet kur personi i dëmtuar, me sjelljet e veta, ka kontribuar të shkaktohet dëmi ose të jetë më i madh se sa do të ishte, sikur ai të mos merrte pjesë në shkaktimin e dëmit, në këtë rast i dëmtuari ka të drejtën e shpërblimit të plotë të dëmit të zvogëluar për aq sa ka qenë kontributi i tij në këtë dëm, në këto raste kemi përgjegjësinë e ndarë për dëmin e shkaktuar. Për shpërblimin e dëmit e të njëjtit dëm mund të jenë përgjegjës një apo ma shumë persona, këto raste kemi të bëjmë me përgjegjësinë solidare, ku të gjithë pjesëmarrësit përgjigjen në mënyrë solidare. Debitori solidar i cili paguan më tepër se shumica e pjesës së tij në dëmin e shkaktuar, mund të kërkoj prej secilit nga debitorët e tjerë që t'ia shpërblejë atë që ka paguar për te (të regresoj).

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Përcaktojnë kriteret për shpërblimin e dëmit;
- Dallojnë format e dëmit jo material dhe llogarisin kamatën për dëmin jo material;
- Njohin bazat e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar dhe kushtet e përgjegjësisë së ndarë dhe solidare.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Kriteret për shpërblimin e dëmit;
- ✓ Bazat e përgjegjësisë së dëmit, përgjegjësia subjektive dhe objektive;
- ✓ Përgjegjësia e ndarë dhe përgjegjësia solidare;
- ✓ Regresimi i kërkesave.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij trajnimi do të përdoren metodat interaktive të diskutimit dhe shtjellimit të rasteve, do të ketë ilustrime dhe përmbledhje të përmbajtjes në PowerPoint, do të punohet në grupe dhe do të zërthehen disa rastet praktike.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, gjykatave themelore, si dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Financave që merren me procedurat e kompensimit pranë organit shpronësues dhe bashkëpunëtorët profesional. Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

29. Parashkrimi i kërkesave sipas dispozitave të LMD-së

Parashkrimi i kërkesave ndodh me qëllim të garantimit të sigurisë juridike, që kreditorët kërkesat e tyre ti mbrojnë në afat të caktuar sepse mund të ndodh që të bëhet e pa mundur mbrojtja e të drejtave përmes rrugës gjyqësore për shkak të kalimit të kohës së përcaktuar me ligj. Parashkrimi, mund të thuhet se konsiderohet njëri ndër institutet më të rëndësishme të së drejtës detyimore, sepse ai siguron marrëdhëniet juridike detyimore të jenë më të qëndrueshme. Kreditorët duhet të jenë shumë të kujdesshëm që kërkesat e tyre të realizohen dhe të mos lejohet që parashkrimi të ketë ndikim në marrëdhëniet e tyre detyimore. Andaj, parashkrimi paraqet një nga mënyrat e shuarjes së detyrimit deri te i cili vjen me sjellje pasive të kreditorit dhe sjellje aktive të debitorit.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zgjerojnë njohuritë mbi parashkrimin;
- Llogarisin afatet e parashkrimit;
- Përcaktojnë kohën e rrjedhjes së parashkrimit.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Rregullat e përgjithshme të parashkrimit;
- ✓ Llogaritja e fillimit, ndërprerjes së parashkrimit dhe rrjedha e parashkrimit;
- ✓ Heqja dorë nga parashkrimi;
- ✓ Afatet e parashkrimit për kërkesat e caktuara;
- ✓ Ndalja e parashkrimit.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij trajnimi do të përdoren metodat e kombinuara të shpjegimit, të përcjella me shembuj praktik dhe diskutime interaktive.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, gjykatave themelore, si dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Financave që merren me procedurat e kompensimit pranë organit shpronësues dhe bashkëpunëtorët profesional. Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

30. Pjesa e domosdoshme dhe cenimi i saj

Liria e lënies me testament sot është pranuar në të gjitha drejtat. Mirëpo ashtu siç është kufizuar në të drejtën reale disponimi me pronësi, ashtu siç është kufizuar në të drejtën detyrimeve liria e kontraktimit, ashtu edhe liria e lënies me testament është kufizuar në të gjitha sistemet juridike. E drejta e trashëgimisë e njeh mekanizmat mbi kufizimin e disponimit me testament, mënyra më njohur dhe më efikase është pjesa e domosdoshme. Kjo nënkupton që me normat imperative është përcaktuar që një pjesë e trashëgimisë së trashëgimlënësi, kundër dëshirës të trashëgimlënësit duhet u takoj personave të caktuar. Personat të cilëve u garantohet pjesa e trashëgimisë quhen trashëgimtar të domosdoshëm dhe se këtyre trashëgimtarëve janë lënë në disponimi mjetet e përshtatshme për të realizuar të drejtën në pjesën e domosdoshme. Trajnimi do të adresoj problemet në praktiken lidhur me pjesën e domosdoshme: si thirrja, dëmtimi dhe kërkesa për pjesë të domosdoshme, gjithashtu do të diskutohet për mënyrën e caktimit dhe llogaritjen e pjesës së domosdoshme.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Njohin pjesë e domosdoshme të trashëgimisë;
- Identifikojnë kur cenohet pjesa e domosdoshme e trashëgimisë;
- Llogarisin pjesën e domosdoshme të trashëgimisë;
- Identifikojnë kush janë trashëgimtarë të domosdoshme si caktohet pjesa e domosdoshme e trashëgimisë.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Kuptimi i pjesës së domosdoshme;
- ✓ Thirrja në trashëgimi të domosdoshme;
- ✓ Dëmtimi i pjesës së domosdoshme dhe kërkesa për pjesë të domosdoshme;
- ✓ Rrethi i trashëgimtarëve të domosdoshëm;
- ✓ Mënyra e caktimit të pjesës së domosdoshme;
- ✓ Llogaritja e pjesës së domosdoshme, zvogëlimi i pjesës së domosdoshme me testament dhe kthimi i dhuratave.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij trajnimit do të përdoren metodat interaktive të diskutimit dhe shtjellimit të rasteve, do të ketë ilustrime dhe përmbledhje të përmbajtjes në PowerPoint, do të punohet në grupe dhe do të zërthehen disa rastet praktike.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, gjykatave themelore, si dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Financave që merren me procedurat e kompensimit pranë organit shpronësues dhe bashkëpunëtorët profesional. Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

31. Procedurat gjyqësore në rastet e shpronësimit

Siç dihet instituti juridik i shpronësimit lejon mundësinë që pronari të mund të zhvishet nga e drejta e pronësisë vetëm nën kushtet e parapara me ligj me kusht që shpronësimi të bëhet për qëllim të interesit të përgjithshëm. Meqenëse shpronësimi në praktikë paraqitet shumë shpesh zbatimi i rregullt i dispozitave ligjore të Ligjit për shpronësim garanton të drejtën e nevojshme që zbatuesit e këtij ligji të përfitojnë njohuri më të thella në lidhje me këtë institut juridik, në mënyrë që këto njohuri të kontribuojnë me një unifikimin e praktikës gjyqësore në gjykatat e Kosovës.

Ky trajnim është dizajnuar dhe strukturuar në mënyrë që të analizojë dhe zbërthejë procedurën e shpronësimit, të identifikoj kushtet paraprake për shpronësim dhe kriteret të cilat zbatohen për shpronësim.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Vlerësojnë kushtet ligjore të cilat duhet të plotësohen për shpronësim;
- Zbatojnë drejt dispozitat e Ligjit për shpronësim;
- Identifikojnë mënyrën dhe kriteret për caktimin e kompensimit në rastet e shpronësimit.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Kushtet ligjore për shpronësim;
- ✓ Procedura e shpronësimit në rastet kur organi shpronësuese është Qeveria apo Komuna;
- ✓ Vendimi preliminar dhe përfundimtar për shpronësim si dhe mjetet juridike;
- ✓ Mënyra dhe kriteret për caktimin e kompensimit në rastet e shpronësimit.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij trajnimi do të përdoren metodat e kombinuara të shpjegimit, të përcjella me shembuj praktik dhe diskutime interaktive

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, gjykatave themelore, si dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Financave që merren me procedurat e kompensimit pranë organit shpronësues dhe bashkëpunëtorët profesional. Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

32. Kontratat nule dhe të rrëzueshme

Kontrata paraqesin një nga burimet më të rëndësishme të së drejtës së detyrimeve dhe njëkohësisht institucionin qendror juridik të marrëdhënieve juridike në mes palëve kontraktuese, me anë të së cilës mund të krijohet, ndryshohet apo shuhet një raport kontraktual i karakterit detyrimor. Që një kontratë të jetë e vlefshme me rastin e lidhjes së saj duhet të plotësohen kushtet të cilat parashihen me ligj, ngase në rastet kur kontrata është në kundërshtim me rendin juridik, dispozitat imperative urdhëruese apo moralin e shoqërisë atëherë kemi të bëjmë me nulitet të kontratës, apo kontratë absolutisht nule, ndërsa në rastet kur kontrata është lidhë nga personi me aftësi të kufizuar të veprimit, ka të meta në pikëpamje të vullnetit të palëve apo mungesa tjera të cilat parashihen me ligj apo ndonjë dispozitë të veçantë, kemi të bëjmë me kontratë të rrëzueshme apo kontratë relativisht nule.

Praktika gjyqësore ka treguar se ka shumë raste kur palët kontraktuese me rastin e lidhjes së kontratës nuk respektojnë kushtet e parapara me ligj të cilat atë kontratë e bëjnë të vlefshme, me çka trajtimi i kësaj teme do të ndihmonte në analizimin dhe shtjellimin e shkaqeve në bazë të së cilave mund të vije gjerë tek nuliteti dhe rrëzueshmeria e një kontrate.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Dallojnë kushtet ligjore të cilat duhet plotësuar për t'u konsideruar një kontratë nule dhe e rrëzueshme;
- Njohin rrethin e subjekteve të cilët mund të thirren në pavlefshmërinë relative të kontratave;
- Avancojnë njohuritë rreth pasojave të nulitetit relativ të kontratave;
- Zbatojnë drejtë dispozitat e LMD-së lidhur me pavlefshmërinë e kontratave të rrëzueshme.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Kontrata e rrëzueshme, shkaqet ligjore të cilat e bëjnë një kontratë të rrëzueshme;
- ✓ Rrethi i subjekteve të cilët mund të kërkojnë anulimin e kontratave të rrëzueshme;
- ✓ Karakteri i vendimit gjyqësor në rast të anulimit të këtyre kontratave;
- ✓ Pasojat juridike të anulimit të kontratës relativisht të pavlefshme;
- ✓ Pozita e palëve kontraktuese dhe personit të tretë pas anulimit të kontratës relativisht të pavlefshme;
- ✓ Afatet kohore ligjore brenda të cilave mund të kërkohet anulimi i kontratave të rrëzueshme.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij trajnimi do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, të përcjella me biseda interaktive dhe shembuj praktikë, në mënyrë që secili prej pjesëmarrësve të jetë aktiv gjatë kohës së mbajtjes së trajnimit, që të arrihen në tërësi objektivat e këtij trajnimi.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatave Themelore, bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor. Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

33. Mjete për sigurimin e ekzekutimit të kontratave

Në kuadër të shkencës juridike rrjedhimisht edhe në kuadër të legjislacioneve për rregullimin e marrëdhënieve civile, rëndësi e veçantë u kushtohet edhe mjeteve për sigurimin e ekzekutimit të kontratave. Ka raste kur kreditori nuk ka besimin e duhur ndaj palës tjetër kontraktuese, atëherë kreditori ka në dispozicion mjete të caktuara që në mënyrë të drejtpërdrejtë të siguroj se kontrata do të përmbushet. Kryesisht mjetet e sigurimit të ekzekutimit të kontratës kërkohen në ato kontrata që përmbushja e tyre do të zgjas për një kohë me të gjatë. Ligji i Marrëdhënieve të Detyrimeve, si mjete për sigurimin e ekzekutimit të kontratave ka parapa grupin e mjeteve personale të sigurimit dhe grupin e mjeteve reale të sigurimit, duke përcaktuar në mënyrë specifike secilin mjet personal dhe secilin mjet real të sigurimit duke përjashtuar këtu pengun dhe hipotekën të cilat nuk rregullohen me këtë ligj. Është me rëndësi të veçantë që gjyqtaret e të gjitha niveleve të avancojnë njohuritë e tyre në lidhje me mjetet e sigurimit të ekzekutimit të kontratave, që do u shërbejnë në punë më cilësore në kuptimin e vendosjes profesionale në çështjet që kanë të bëjnë kontestet e kësaj natyre.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Avancojnë njohurit për mjetet e sigurimit të ekzekutimit të kontratave;
- Zbatojnë në mënyrë efikase dispozitat lidhur me krijimin dhe specifikat e mjeteve reale dhe personale të ekzekutimit të kontratave;
- Zgjerojnë njohurit rreth procedurave dhe mënyrës se vendosje në konteste gjyqësore që kanë të bëjnë me realizimin e mjeteve të sigurimit të kontratave.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Kuptimi i mjeteve të sigurimit të ekzekutimit të kontratave;
- ✓ Mjetet e sigurimit real të ekzekutimit të kontratave;
- ✓ Mjetet e sigurimit personal të ekzekutimit të kontratave;
- ✓ Karakteristikat kryesore të këtyre mjeteve;
- ✓ Kontraktimi i mjeteve të sigurimit dhe mënyra e realizimit të tyre
- ✓ Procedura gjyqësore për vendosje në konteste të tilla.

Metodologjia e trajnimit

Ky trajnim do të aplikojë një metodologji interaktive të të mësuarit e cila përbëhet prej ushtrimeve dhe diskutimeve, prezantim i rasteve konkrete nga praktika gjyqësore dhe diskutime për mënyrën e vendosjes meritore për rastet konkrete.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe gjykatave themelore (divizioni civil) dhe bashkëpunëtorët profesional. Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

34. Procedura gjyqësore në rastet e mbrojtës nga dhuna në familje

Gjykatat në vazhdimësi përballesh me rastet e dhunës në familje e cila mund të shfaqet në të gjitha kategoritë e shoqërisë pavarësisht moshës, arsimit, gjendjes ekonomike sociale, etnisë, fesë etj. Dhuna në familje përveç që shkel të drejtat e njeriut, njëherit rrezikon edhe mirëqenien fizike, psikologjike dhe socio-ekonomike të viktimës. Mekanizmat kompetent për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, konkretisht gjykatat, duhet të jenë të përgatitura që brenda afateve të caktuara ligjore t'iu përgjigjen nevojave të viktimave dhe të caktojnë masat e duhura ligjore për mbrojtje dhe parandalim të rasteve të dhunës në familje. Në kuadër të këtij moduli do të trajtohen: faktorët që ndikojnë në shfaqjen e dhunës në familje, llojet e dhunës në familje si dhe pasojat. Gjithashtu do të shtjellohet se kush mund të kërkojë urdhër mbrojtjeje, të dhënat që duhet të përfshijë kërkesa për urdhër mbrojtjeje si dhe roli dhe rëndësia e mekanizmave që inkuadrohen në këto raste e që i ofrojnë mbrojtje dhe ndihmë viktimave të dhunës në familje. Përveç kësaj, rëndësi e veçantë do ti kushtohet Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit). Kjo konventë e njej dhunën ndaj grave si shkelje të të drejtave të njeriut dhe si formë diskriminimi dhe është traktati i parë ndërkombëtar që përmban një përkufizim të gjinisë. Konventa bën thirrje për përfshirjen e të gjitha institucioneve dhe shërbimeve përkatëse shtetërore, në një qasje të koordinuar të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Kjo do të thotë që institucionet dhe organizatat jo-qeveritare nuk duhet të veprojnë vetëm, por të punojnë së bashku për të përpiluar protokolle bashkëpunimi.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zbatojnë drejtë procedurat standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje;
- Zbatojnë në mënyrë efikase dispozitat lidhur me procedurën dhe afatet për vendosje sipas kërkesave për urdhër mbrojtjeje;
- Avancojnë njohurit rreth Konventës të Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje;
- Krahasojnë specifikat e dhunës në familje në procedurë civile dhe penale.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Dhuna në familje dhe llojet e saj;
- ✓ Urdhri për mbrojtje, kërkesa për urdhër mbrojtjeje dhe përmbajtja e saj;
- ✓ Procedura gjyqësore për vendosje sipas kërkesave për urdhër mbrojtjeje;
- ✓ Llojet e masave mbrojtëse dhe kohëzgjatja e tyre;
- ✓ Ekzekutimi dhe pasojat e mos ekzekutimit të urdhrin për mbrojtjeje;
- ✓ Qasja ndaj dhunës në familje sipas Konventës të Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje.

Metodologjia trajnuese

Ky trajnim do të aplikojë një metodologji interaktive të të mësuarit e cila përbëhet prej ushtrimeve dhe diskutimeve, prezantim i rasteve konkrete nga praktika gjyqësore dhe diskutime për mënyrën e vendosjes meritorë për rastet konkrete.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe gjykatave themelore (divizioni civil), bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët ligjor, policia e Kosovës, mbrojtësit e viktimave dhe Qendrat për Pune Sociale. Trajnimi do të zgjas një (1) ditë.

35. Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar - në lëmin civile

Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet civile është një prej fushave më komplekse e karakterizuar me vështirësi në përcaktimin, eksplorimin dhe aplikimin e ligjit të huaj, përfshirë këtu edhe një numër të çështjeve procedurale, siç janë çështjet e shërbimeve të dokumenteve ndërkufitare, ndihma juridike ndërkombëtare, njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore, etj.

Secili gjyqtar është ballafaqur njëjtë si me çështje të brendshme ashtu edhe me ato ndërkufitare, dhe si rrjedhojë secili gjyqtar civilist ka nevojë për trajnim në trajtimin e rasteve me element ndërkombëtar. Programi është hartuar në atë formë që të adresoj dilemat dhe vështirësitë që hasen në praktikën gjyqësore aktuale, përmes diskutimeve interaktive dhe shqyrtimit të rasteve praktike. Gjithashtu përmes rasteve studimore do të trajtohet praktika gjyqësore e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Avancojnë njohuritë rreth bashkëpunimit juridik ndërkombëtar për çështjet civile, si dhe njohjen e vendimeve të huaja;
- Zbatojnë drejtë legjislacionin vendor dhe ndërkombëtarë për bashkëpunimin ndërkufitar në çështjet civile.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Korniza ligjore vendore për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet civile;
- ✓ Rregulloret e BE-së për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet civile (Rregulloret Bruksel I, Bruksel II, Rome I si dhe rregulloret Nr. 805/2004, 1393/2007, 650/2012, 4/2009);
- ✓ Konventat e Hagës për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet civile.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë trajnimit do të përdoren metoda të kombinuara duke përfshirë shpjegime teorike të përcjella me shembuj nga praktika gjyqësore.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët e gjykatave themelore (divizioni civil), bashkëpunëtorët profesional të gjykatave, si dhe zyrtarët ligjore. Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

36. Kontrata mbi mbajtjen e përjetshme dhe cedimi i pasurisë gjatë jetës për së gjalli

Duke qenë se me Ligjin e ri për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është paraparë edhe kontrata mbi mbajtjen e përjetshme, e cila si institut i veçantë për një kohë nuk ka qenë e rregulluar me LMD, është paraqitur nevoja e trajnimit të kësaj çështjet në të cilin pjesëmarrës janë gjyqtarët, të cilët në praktikë ballafaqohen me zgjidhjen e kontesteve të kësaj natyre. Kontrata në fjalë nuk ka qenë e rregulluar me LMD e vitit 1978, por me dispozitat e Ligjit për Trashëgiminë të KSA të Kosovës, të vitit 1974, i cili ligj është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Ligjit për Trashëgiminë të Kosovës, i vitit 2006 (LTK), i cili nuk e ka rregulluar këtë kontratë, mirëpo për të njëjtën ka referuar në LMD, i cili në fakt ka hyre në fuqi në fund të vitit 2012. Si rezultat i kësaj edhe gjyqtarët kanë pasur dhe kanë vështirësi në zbatimin adekuat të këtyre ligjeve, të cilat i referohen marrëdhënieve juridiko detyrimore, të cilat rregullohen me kontratën mbi mbajtjen e përjetshme, për çka edhe janë krijuar edhe praktika të ndryshme gjyqësore. Përveç kontratës së sipërpërmendur, me rëndësi të veçantë paraqiten edhe marrëdhëniet ndër kontraktuale, të cilat për bazë kanë bartjen e të drejtave të pasurisë për së gjalli (inter vivos), në mes paraardhësit dhe trashëgimtarëve të tij ligjor, e të cilat janë të rregulluara me dispozitat e LTK, por edhe me dispozitat e LMD, e që i referohen procedurës për lidhjen dhe anulimin e kësaj kontrate. Andaj, edhe gjyqtarët kanë pasur dhe kanë vështirësi në zbatimin adekuat të këtyre ligjeve, të cilat i referohen marrëdhënieve juridiko detyrimore, të cilat rregullohen me kontratën mbi cedimin e pasurisë për së gjalli, si rezultat i të cilave gjithashtu janë praktika të ndryshme gjyqësore.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Dallojnë kontestet për zgjidhjen, anulimin, apo vërtetimin e nulitetit të kontratës mbi mbajtjen e përjetshme dhe kontratës për cedimin e pasurisë për së gjalli;
- Zbatojnë drejtë dispozitat e ligjit përkatës të LMD dhe LTK, duke vlerësuar afatet ligjore për të kërkuar mbrojtje gjyqësore.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Kontrata mbi mbajtjen e përjetshme;
- ✓ Kontrata për cedimin e pasurisë për së gjalli;
- ✓ Kushtet ligjore për lidhjen e këtyre kontratave;
- ✓ Shkaqet për zgjidhjen, anulimin apo nulitetin e këtyre kontratave;
- ✓ Afatet ligjore për anulimin e tyre;
- ✓ Vendimet gjyqësore të gjykatës në lidhje me këto kontrata.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë trajnimit do të përdoren metoda të kombinuara duke përfshirë shpjegime teorike të përcjella me shembuj nga praktika gjyqësore.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, gjykatave themelore (divizioni civil), si dhe bashkëpunëtorët profesional të gjykatave. Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

37. Mbrojtja gjyqësore në kontestet nga marrëdhënia e punës sipas Ligjit të Punës

Kohëve të fundit është rritur numri i kontesteve nga marrëdhënia e punës. Shkak për këtë është se legjislacioni në fuqi ka pasur mangësi dhe mbrojtja gjyqësore nuk ka qenë adekuate me ç' rast i është cenuar e drejta e punëtorit nga marrëdhënia e punës. Si rrjedhojë dispozitat të cilat e kanë rregulluar këtë fushë kanë qenë të shpërndara në shumë ligje dhe rregullore, të cilat janë nxjerr dhe miratuar në rrethana të ndryshme ekonomike, shoqërore dhe politike. Si rezultat i kësaj edhe gjyqtarët kanë pasur dhe kanë vështirësi në zbatimin adekuat të këtyre ligjeve, të cilat i referohen mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, si rezultat i të cilave janë krijuar edhe praktika të ndryshme gjyqësore. Ky trajnim është dizajnuar dhe strukturuar në mënyrë që të analizojë dhe zbërthej procedurën e filluar nga punëmarrësit në rastet e shkeljeve të detyrave të punës nga ana e punëdhënësve, përfshirë këtu edhe identifikimin e kushteve paraprake të cilat duhet të plotësohen nga kërkuesi para se t'i drejtohet gjykatës me padi për të siguruar mbrojtje gjyqësore në konteste të tilla.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Dallojnë kontestet për shërbyesit civil dhe kontestet e tjera nga marrëdhënia e punës sipas ligjit të punës;
- Zbatojnë drejtë dispozitat e ligjit përkatës, duke vlerësuar afatet për të kërkuar mbrojtje gjyqësore.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Kontratat e punës dhe llojet e tyre;
- ✓ Kontestet nga marrëdhënia e punës sipas ligjit të punës;
- ✓ Procedura gjyqësore për mbrojtjen e të drejtave të punës;
- ✓ Diskriminimi në marrëdhëniet e punës;
- ✓ Respektimi i afateve për të kërkuar mbrojtje gjyqësore.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë trajnimit do të përdoren metoda të kombinuara duke përfshirë shpjegime teorike të përcjella me shembuj nga praktika gjyqësore.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, gjykatave themelore (divizioni civil), si dhe bashkëpunëtorët profesional të gjykatave. Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Punëtori dhe tryeza nga lemia civile

38. Tryezë për çështje familjare

Tryeza për çështje familjare ka për fokus trajtimin dhe adresimin e sfidave të praktikës gjyqësore lidhur me zbatimin e dispozitave materiale dhe procedurale nga fusha e së drejtës familjare. E drejta familjare si tërësi është rregulluar me Ligjin e Familjes, i cili në vitin 2019, ka pasuar disa ndryshime lidhur me mënyrën e llogaritjes së kontributit të bashkëshortëve, mirëpo në të njëjtën kohë praktika gjyqësore ka njohur zhvillimin e saj në trajtimin e rasteve nga marrëdhëniet martesore dhe familjare e të cilat do të trajtohen edhe në kuadër të kësaj tryeze. Çështjet familjare zakonisht janë sensitive dhe kërkojnë përkushtim dhe profesionalizëm të nivelit të lartë në trajtimin e rasteve sipas kërkesave për mbrojtje gjyqësore, prandaj kjo tryezë synon që të adresoj problematikat lidhur me zbatimin e Ligjit për Familjen i Kosovës.

Tryeza do të shërbej si bazë e mirë e ofrimit të njohurive për gjyqtaret pjesëmarrës lidhur me praktikën e konsoliduar. Punimet e tryezës do të zhvillohen sipas një agjende kornizë (*të paracaktuar*) për çështjet që përfshihen në kuadër të fushës së marrëdhënieve martesore dhe familjare. Trajtimi i çështjeve do të bëhet duke prezantuar sfidat e identifikuara në praktikën e gjykatës së shkallë së dytë dhe të tretë e të cilat do të prezantohen përmes rasteve konkrete.

Raste e prezantuara duhet të përzgjidhen me kujdes në mënyrë që të konsumohen të gjitha sfidat që kanë të bëjnë me fushën përkatëse, në këtë rast me fushën e çështjeve familjare. Lidhur me rastet e përzgjedhura moderatorët duhet të bëjnë hulumtimet e duhura nga praktika gjyqësore në gjykatat ku punojnë dhe duhet të sigurohen se ato raste paraqesin në mënyrë objektive problematikën e çështjeve të trajtuara, por edhe mënyrën se si duhet të vepohet në të ardhmen.

Punimet e tryezës duhet të mbështetën në konceptet ligjore të rregullimit të marrëdhënieve familjare, për çka moderatorët duhet të jenë të përgatitur për të dhënë komentet e tyre të mbështetura në praktikën gjyqësore dhe dispozitat ligjore për të gjitha çështjet e fushës që trajtohet.

Temat e përfshira në agjendën kornizë janë një përzgjedhje e kujdesshme e çështjeve më të rëndësishme dhe më aktuale, të cilat përmbledhen në: E drejta martesore, zgjidhja e martesës, procedura e shkurorëzimit, detyrimi për ushqim dhe e drejta prindërore; Format e veçanta të mbrojtjes së fëmijëve pa kujdes prindëror; Kundërshtimi dhe vërtetimi i amësisë apo i atësisë; Marrëdhëniet pasurore në mes bashkëshortëve, etj.

Praktika gjyqësore e cila duhet të jetë pjesë e kësaj tryeze është një burim i pazëvendësueshëm jo vetëm për të qartësuar mënyrën e zbatimit të dispozitave ligjore por edhe për të njohur standardet e zhvilluara në këtë fushë.

Tryeza është dizajnuar që të zhvillohet në një ambient interaktiv të diskutimeve dhe ushtrimeve praktike. Prezantimi i temave do të bëhet përmes paraqitjes së një apo disa rasteve praktike të ndërlydhura drejtpërdrejtë me çështjen që duhet të trajtohet sipas agjendës. Për parashtrimin e rastit moderatori duhet të marrë në konsideratë aspektet faktike dhe juridike të rastit, të parashtrij disa pyetje/dilema mbi të cilat do të zhvillohet diskutimi dhe do të konsumohet tema. Moderatorin duhet të jetë i përgatitur dhe i hapur për të diskutuar rastin/rastet e ndërlydhura me temën e sesionit përkatës duke nxitur diskutimin interaktiv dhe analitik të çështjes përkatëse, por duke ofruar njëkohësisht pikëpamjet teorike/doktrinare, perspektiven ligjore dhe atë të praktikës gjyqësore si mbështetje për përfundimet e mundshme që dalin nga rasti që diskutohet. Adresimi i secilës çështje/temë të përmbledhur në këtë tryezë duhet të bëhet edhe përmes një prezantimi fare të shkurtës (teorik) të nocioneve dhe kuptimeve tjera të secilës çështje të ngritur dhe njëkohësisht duhet të pasohet me shembuj për secilën temë/çështje.

Shembjet duhet të jenë të përzgjedhur me kujdes dhe duhet të kenë mbështetje në një praktikë gjyqësore të konsoliduar. Në fund të punimeve në tryezë moderatorët duhet të hartojnë një raport përmbledhës për tryezën e mbajtur. Raporti do të shërbej për të shpërndarë rezultatet e tryezës por edhe për të identifikuar ndonjë çështje që duhet të përfshihet në programet e akademisë për trajnime apo eventualisht edhe të trajtohen nga seanca e përgjithshme Gjykatës Supreme të Kosovës.

Objektivat e tryezës

- Identifikimi i sfidave për zbatimin e dispozitave të ligjit për Familjen i Kosovës;
- Identifikimi i praktikave jo unike në gjykatat e instancave më të ulëta;
- Adresimi i sfidave përmes prezantimit të praktikës unike gjyqësore, si konkluzion.

Përmbajtja e tryezës

- ✓ Zgjidhja e martesës, procedura e shkurorëzimit, detyrimi për ushqim dhe e drejta prindërore;
- ✓ Format e veçanta të mbrojtjes së fëmijëve pa kujdes prindëror;
- ✓ Kundërshtimi dhe vërtetimi i amësisë apo i atësisë;
- ✓ Marrëdhëniet pasurore në mes bashkëshortëve.

Metodologjia e tryezës

Gjatë kësaj tryeze do të zhvillohet diskutim interaktiv, prezantim i çështjeve përmes rasteve, diskutim për rastet dhe përmbledhje e konkluzave për çështjen e diskutuar.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e tryezës

Gjyqtaret e Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatave Themelore. Tryeza do të zgjatë dy (2) ditë (përsëritet varësisht nga nevoja).

39. Tryezë për çështje nga Procedura Kontestimore

Tryeza për çështje nga procedura kontestimore ka për fokus trajtimin dhe adresimin e sfidave të praktikës gjyqësore lidhur me zbatimin e dispozitave nga procedura kontestimore. Procedura Civile është pjesë e të drejtës pozitive dhe si e tillë përfshinë të gjitha rregullat juridike sipas të cilave bëhet mbrojtja dhe realizimi i të drejtave subjektive civile lidhur me marrëdhëniet juridiko-civile. Në këtë kuptim zhvillimi i shkathtësive për zbatimin e dispozitave të procedurës kontestimore për shkak të fushës së gjer të zbatimit është pikësynim i programit të vazhdueshëm në kuadër të Akademisë së Drejtësisë. Tryeza është dizajnuar që të paraqes mënyrën se si duhet të zbatohen dispozita e Ligjit për Procedurën Kontestimore në praktikën gjyqësore. Pra, pjesë e rëndësishme e prezantimit në tryezë janë rastet praktike të cila mbështetën nga një praktikë e mirëfilltë dhe unike gjyqësore. Çështjet që do të trajtohen janë: shqyrtimi paraprak i padisë dhe përgatitja e shqyrtimit kryesor, mbajtja e shqyrtimit gjyqësor (përgatitor dhe kryesor), mjetet provuese, bashkëndergjyqësia dhe pjesëmarrja e personave të tretë në procedurë, përfundimi i procedurës me veprime disponibile dhe me vendim gjyqësor, mjetet e goditjes dhe procedurat veçanta kontestimore.

Nevoja për mbajtjen e një tryezë të tillë diktohet nga numri i madh i rasteve që kthen në rishqyrtim për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe nga nevoja e unifikimit të praktikës gjyqësore për të gjitha nivelet e instancave gjyqësore. Tryeza do të shërbejë si bazë e mirë e ofrimit të njohurive për gjyqtaret pjesëmarrës lidhur me praktikën e konsoliduar për çështje procedurale. Punimet e tryezës do të zhvillohen sipas një agjende kornizë (të paracaktuar) për çështjet që përfshihen në kuadër të fushës së zbatimit të dispozitave të procedurës kontestimore. Trajtimi i çështjeve do të bëhet duke prezantuar sfidat e identifikuar në praktikën e gjykatës së shkallë së dytë dhe të tretë e të cilat do të prezantohen përmes rasteve konkrete. Raste e prezantuara duhet të përzgjidhen me kujdes në mënyrë që të konsumohen të gjitha sfidat që kanë të bëjnë me fushën përkatëse, në këtë rast me fushën e zbatimit të dispozitave të procedurës kontestimore. Lidhur me rastet e përzgjedhura moderatorët duhet të bëjnë hulumtimet e duhura nga praktika gjyqësore në gjykatat ku punojnë dhe duhet të sigurohen se ato raste paraqesin në mënyrë objektive problematikën e çështjeve të trajtuara, por edhe mënyrën se si duhet të veprohet në të ardhmen. Punimet e tryezës duhet të mbështetën në konceptet ligjore të rregullimit të procedurës për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave subjektive civile, për çka moderatorët duhet të jenë të përgatitur për të dhënë komentet e tyre të mbështetura në praktikë gjyqësore dhe dispozitat ligjore për të gjitha çështjet e fushës që trajtohet.

Moderatorët duhet referuar vazhdimisht në praktikën gjyqësore lidhur me sfidat e zbatimit unik të Ligjit për Procedurën Kontestimore, si garancion i ligjshmërisë së procesit gjyqësor dhe avancimit të standardeve për gjykim të drejtë dhe në kohe të arsyeshme. Në tryezë duhet të prezantohen materiale të mjaftueshme për të shpjeguar institutet qendrore në kuadër të Procedurës Kontestimore, për të qartësuar dhe eliminuar sfidat dhe dilemat lidhur me mënyrë e zbatimit të dispozitave procedurale dhe për të mbështetur veçanërisht gjyqtarët e rinj me praktikë gjyqësore të mjaftueshme për çështjet e trajtuara.

Praktika gjyqësore e cila duhet të jetë pjesë e kësaj tryeze është një burim i pazëvendësueshëm jo vete për të qartësuar mënyrën e zbatimit të dispozitave ligjore por edhe për të njohur standardet e zhvilluar në këtë fushë.

Tryeza është dizajnuar që të zhvillohet në një ambient interaktiv të diskutimeve dhe ushtrimeve praktike. Prezantimi i temave do të bëhet përmes paraqitjes së një apo disa rasteve praktike të ndërlidhura drejtpërdrejtë me çështjen që duhet të trajtohet sipas agjendës. Për parashtrimin e rastit moderatori duhet të marrë në konsideratë aspektet faktike dhe juridike të rastit, të parashtror disa pyetje/dilema mbi të cilat do të zhvillohet diskutimi dhe do të konsumohet tema.

Moderatori duhet të jetë i përgatitur dhe i hapur për të diskutuar rastin/rastet e ndërlidhur me temën përkatëse duke nxitur diskutimin interaktiv dhe analitike të çështjes përkatëse, por duke ofruar njëkohësisht pikëpamjet teorike/doktrinare, perspektiven ligjore dhe atë të praktikës gjyqësore si mbështetje për përfundimet e mundshëm që dalin nga rastin që diskutohet. Adresimi i secilës çështje/temë të përmbledhur në këtë tryezë duhet të bëhet edhe përmes një prezantimi fare të shkurtës (teorik) të nocioneve dhe kuptimeve tjera të secilës çështje të ngritur dhe njëkohësisht duhet të pasohet me shembuj për secilën temë/çështje. Shembjet duhet të jenë të përzgjedhur me kujdes dhe duhet të kenë mbështetje në një praktikë gjyqësore të konsoliduar. Në fund të punimeve në tryezë moderatorët duhet të hartojnë një raport përmbledhës për tryezën e mbajtur. Raporti do të shërbej për të shpërndarë rezultate e tryezës por edhe për të identifikuar ndonjë çështje që duhet të përfshihet në programet e akademisë për trajnime apo eventualisht edhe të trajtohen nga seanca e përgjithshme Gjykatës Supreme të Kosovës.

Objektivat e tryezës

- Identifikimi i sfidave për zbatimin e dispozitave të ligjit për Procedurën Kontestimore të Kosovës;
- Identifikimi i praktikave jo unike në gjykatat e instancave më të ulëta;
- Adresimi i sfidave përmes prezantimit të praktikës unike gjyqësore, si konkluzion.

Përmbajtja e tryezës

- ✓ Parimet e procedurës kontestimore;
- ✓ Shqyrtime të përgjithshme lidhur me kompetencën;
- ✓ Përbërja e rregullt e gjykatës dhe përjashtimi i gjyqtarit;
- ✓ Palët në procedurën kontestimore;
- ✓ Seancat, afatet dhe kthimi në gjendjen e mëparshme;
- ✓ Përfundimi i procedurës me vendim të gjykatës;
- ✓ Llojet e aktgjykimeve sipas LPK-së;
- ✓ Mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të goditjes;
- ✓ Paraqitja e padisë në gjykatën e shkallës së parë;
- ✓ Shqyrtimi paraprak i padisë dhe përgjigja në padi;
- ✓ Bashkëndërgjyqësia dhe pjesëmarrja e personave të tretë në gjykim;
- ✓ Seanca përgatitore dhe pajtimi gjyqësor si dhe seanca për shqyrtim kryesor;
- ✓ Mjetet provuese dhe marrja e provës;
- ✓ Dëshmitaret, ekspertet dhe palët;
- ✓ Sigurimi i kërkesëpadisë;
- ✓ Ndërprerja dhe pushimi i procedurës kontestimore;
- ✓ Procedurat e posaçme kontestimore.

Metodologjia e tryezës

Gjatë kësaj tryeze do të zhvillohet diskutim interaktiv, prezantim i çështjeve përmes rasteve, diskutim për rastet dhe përmbledhje e konkluzave për çështjen e diskutuar.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e tryezës

Gjyqtarët e gjykatës së Apelit dhe Gjykatave Themelore. Tryeza do të zgjatë tri (3) ditë (përsëritet sipas nevojës).

40. Tryezë për çështje nga Procedura Përmbartimore

Tryeza për çështje nga procedura përmbartimore ka për fokus trajtimin dhe adresimin e sfidave të praktikës gjyqësore lidhur me zbatimin e dispozitave nga procedura përmbartimore. Tryeza për çështje nga procedura përmbartimore përfshinë të gjitha çështjet që janë rregulluar me Ligjin për Procedurën Përmbartimore. Procedura Përmbartimore është pjesë e të drejtës pozitive dhe si e tillë përfshinë të gjitha rregullat juridike me të cilat rregullohen marrëdhëniet proceduralo-juridike dhe substancialo-juridike që krijohen gjatë procedurës përmbartuese dhe lidhur me të. Procedura përmbartuese është procedura që garanton zbatimin e dhunshëm të përmbartimit sipas vendimeve gjyqësore dhe titujve tjerë ekzekutiv, prandaj numri i raste të përmbartimit është jashtëzakonisht i madh që në vetvete e justifikon nevojën e përfshirjes së tryezës në programin për vitin 2021/2022. Tryeza është dizajnuar që të paraqes mënyrën se si duhet të zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbartimore në praktikën gjyqësore. Pra, pjesë e rëndësishme e prezantimit në tryezë janë raste praktike të cila mbështetën nga një praktikë e mirëfilltë dhe unike gjyqësore. Në tryezë do të trajtohen çështjet ma thelbësore të procedurës së përmbartimit si për raste kur procedura fillohet tek përmbartuesi privat ashtu edhe për raste kur procedura fillohet tek gjykata, pa përjashtuara edhe çështjet që lidhen me zbatimin e përmbartimit si dhe procedurën sipas mjeteve të goditjes.

Nevoja për mbajtjen e një tryezë të tillë diktohet nga numri i madh i rasteve që kthen në rishqyrtim për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës konetstimore dhe përmbartimore dhe nga nevoja e unifikimit të praktikës gjyqësore për të gjitha nivelet e instancave gjyqësore. Tryeza do të shërbejë si bazë e mirë e ofrimit të njohurive për gjyqtarët pjesëmarrës lidhur me praktikën e konsoliduar për çështje procedurale. Punimet e tryezës do të zhvillohen sipas një agjende kornizë (të paracaktuar) për çështjet që përfshihen në kuadër të fushës së zbatimit të dispozitave të procedurës përmbartimore. Trajtimi i çështjeve do të bëhet duke prezantuar sfidat e identifikuar kryesisht në praktikën e gjykatës së shkallë së dytë dhe të tretë e të cilat do të prezantohen përmes rasteve konkrete. Raste e prezantuara duhet të përzgjidhen me kujdes në mënyrë që të konsumohen të gjitha sfidat që të kanë të bëjnë më fushën përkatëse, në këtë rast më fushën e zbatimit të dispozitave të procedurës përmbartimore. Lidhur me rastet e përzgjedhura moderatorët duhet të bëjnë hulumtimet e duhura nga praktika gjyqësore në gjykatat ku punojnë dhe duhet të sigurohen se ato raste paraqesin në mënyrë objektive problematikën e çështjeve të trajtuara, por edhe mënyrën se si duhet të veprohet në të ardhmen.

Punimet e tryezës duhet të mbështetën në konceptet ligjore të rregullimit të procedurës për realizimin e të drejtave përmes zbatimit të dhunshëm të përmbartimit për çka moderatorët duhet të jenë të përgatitur për të dhënë komente e tyre të mbështetura në praktikë gjyqësore dhe dispozitat ligjore për të gjitha çështjet e fushës që trajtohet. Moderatorët duhet referuar vazhdimisht në praktikën gjyqësor lidhur me sfidat e zbatimit unik të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, si garancion i ligjshmërisë së procesit të përmbartimit dhe avancimit të standardeve për efikasitet në këtë procedurë. Në tryezë duhet të prezantohen materiale mjaftueshme për të qartësuar dhe eliminuar sfidat dhe dilemat lidhur me mënyrë e zbatimit të dispozitave procedurale dhe për të mbështetur veçanërisht gjyqtarët e rinj me praktikë gjyqësore të mjaftueshme për çështjet e trajtuara. Praktika gjyqësore e cila duhet të jetë pjesë e kësaj tryeze është një burim i pazëvendësueshëm jo vete për të qartësuar mënyrën e zbatimit të dispozitave ligjore por edhe për të njohur standardet e zhvilluar në këtë fushë. Tryeza është dizajnuar që të zhvillohet në një ambient interaktiv të diskutimeve dhe ushtrimeve praktike. Prezantimi i temave do të bëhet përmes paraqitjes së një apo disa rasteve praktike të ndërlidhura drejtpërdrejtë me çështjen që duhet të trajtohet sipas agjendës. Për parashtrimin e rastit moderatori duhet të marrë në konsideratë aspektet faktike dhe juridike të rastit, të parashtror disa pyetje/dilema mbi të cilat do të zhvillohet diskutimi dhe do të konsumohet tema. Moderatorin duhet të jetë i përgatitur dhe i hapur për të diskutuar rastin/rastet e ndërlidhur me

temën e sesionit përkatës duke nxitur diskutimin interaktiv dhe analitike të çështjes përkatëse por duke ofruar njëkohësisht pikëpamjet teorike/doktrinare, perspektiven ligjore dhe atë të praktikës gjyqësore si mbështetje për përfundimet e mundshëm që dalin nga rastin që diskutohet. Adresimi i secilës çështje/temë të përmbledhur në këtë tryezë duhet të bëhet edhe përmes një prezantimi fare të shkurtës (teorik) të nocioneve dhe kuptimeve tjera të secilës çështje të ngritur dhe njëkohësisht duhet të pasohet me shembuj për secilën temë/çështje. Shembjet duhet të jenë të përzgjedhur me kujdes dhe duhet të kenë mbështetje në një praktikë gjyqësore të konsoliduar.

Në fund të punimeve në tryezë moderatorët duhet të hartojnë një raport përmbledhës për tryezën e mbajtur. Raporti do të shërbej për të shpërndarë rezultate e tryezës por edhe për të identifikuar ndonjë çështje që duhet të përfshihet në programet e akademisë për trajnime apo eventualisht edhe të trajtohen nga seanca e përgjithshme Gjykatës Supreme të Kosovës.

Objektivat e tryezës

- Identifikimi i sfidave për zbatimin e dispozitave të ligjit për Procedurën Përmbartimore të Kosovës;
- Identifikimi i praktikave jo unike në gjykatat e instancave më të ulëta;
- Adresimi i sfidave përmes prezantimit të praktikës unike gjyqësore, si konkluzion.

Përmbajtja e tryezës

- ✓ Fillimi i procedurës së përmbartimit, kompetenca dhe vendimet e organit përmbartues;
- ✓ Bazat juridike për caktimin e përmbartimit;
- ✓ Mjetet, objekti dhe zbatimi i përmbartimit;
- ✓ Mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme në procedurën e përmbartimit, procedura për kthimin e punëtorit në punë dhe procedura për marrjen dhe dorëzimin e fëmijës.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë kësaj tryeze do të zhvillohet diskutim interaktiv, prezantim i çështjeve përmes rasteve, diskutim për rastet dhe përmbledhje e konkluzave për çështjen e diskutuar.

Përfituesit dhe kohëzgjatja

Gjyqtarët e gjykatës së Apelit dhe Gjykatave Themelore. Tryeza do të zgjatë dy (2) ditë.

41. Tryezë për çështje pronësore

Tryeza për çështje pronësore ka për fokus trajtimin dhe adresimin e sfidave të praktikës gjyqësore lidhur me zbatimin e dispozitave materiale në fushën e të drejtës pronësore. Në tryezën për çështje pronësore do të trajtohen çështjet ma thelbësore në kuadër të së drejtës pronësore. Çështjet pronësore në vendin tonë tërheqin pas tyre një tërësi të gjerë problematikash duke filluar nga ato ligjore e deri tek praktika gjyqësore e zbatimit jo unik të ligjit material.

Nisur nga rëndësia e marrëdhënieve pronësore juridik jo vete për qytetaret por edhe për vete vendin, por edhe nga kompleksiteti dhe sfidat e kësaj fushe, kësaj tryeze duhet kushtuar rëndësia e duhur në programin e vazhdueshëm të arsimit ligjor. Ndryshimet ligjore që kanë ndodhur viteve të fundit lidhur me mënyrën e rregullimit të marrëdhënieve pronësore, ndryshimi i sistemit shoqëror lidhur me konceptin e pronës dhe llojet e pronës, transaksionet joformale të transferimit të pronësisë, mos shqyrtimi i trashëgimisë, etj, kanë ndikuar që numri i rasteve të jetë tejet i madh në gjykata tonë. Praktika gjyqësore përballët me sfida të mëdha të cilat nuk kanë adresuar në mënyrë unike në sistemin gjyqësor, gjë që ka ndikuar drejtpërdrejtë në sigurinë juridike.

Gjykata Supreme e Kosovës në kuadër të juridiksionit të saj si gjykata e vlerësimit të ligjshmërisë së vendimmarrjes në nivelet tjera gjyqësore, synon që përmes kësaj tryeze të organizuara nga Akademia e Drejtësisë të mbështes drejtpërdrejtë rritjen e performancës gjyqësore përmes rritej se efikasitetit, cilësisë, zbatimit unik të dispozitave ligjore në mënyrë që puna e gjykatave të jetë objektive, ligjore dhe e besueshme. Temat e përfshira në këtë për këtë tryezë janë një përzgjedhje e kujdesshme e çështjeve më të rëndësishme dhe më aktuale, të cilat përmbledhen në: E drejta e pronësisë; Bashkëpronësia dhe Pronësia e Përbashkët; Mënyrat e fitimit të drejtës së pronësisë -Fitimi derivativ dhe origjinere i pronësisë; Mbrojtja gjyqësore e të drejtës së pronësisë; Të drejtat sendore në sendet e huaja, vërtetimi, konstituimi dhe ndërprerja e servituteve sendore si dhe mbrojtja e servituteve sendore; Posedimi dhe mbrojtja e posedimit; Pengu, Hipoteka, Parablerja, Barra Sendore, dhe e Drejta e ndërtimit (Superficies).

Praktika gjyqësore e cila duhet të jetë pjesë e këtij nën moduli është një burim i pazëvendësueshëm jo vete për të qartësuar idetë mbi institutet qendrore por edhe për të kuptuar mënyrat e veprimt dhe në tërësi praktikën gjyqësore ekzistuese për paqartësitë, dilemat apo edhe mangësi ligjore. Punimet tryezës do të zhvillohen sipas një agjende kornizë (të paracaktuar) për çështjet që përfshihen në kuadër të fushës së marrëdhënieve pronësore. Trajtimi i çështjeve do të bëhet duke prezantuar sfidat e identifikuar në praktikën e gjykatës së shkallë së tretë e të cilat do të prezantohen përmes rasteve konkrete.

Raste e prezantuara duhet të përzgjidhen me kujdes në mënyrë që të konsumohen të gjitha sfidat që të kanë të bëjnë me fushën përkatëse, në këtë rast me fushën e çështjeve pronësore. Lidhur me rastet e përzgjedhura moderatorët duhet të bëjnë hulumtimet e duhura nga praktika gjyqësore në gjykata ku punojnë dhe duhet të sigurohen se ato raste paraqesin në mënyrë objektive problematikën e çështjeve të trajtuara, por edhe mënyrën se si duhet të veprohet në të ardhmen. Punimet e tryezës duhet të mbështeten në konceptet ligjore të rregullimit të marrëdhënieve pronësore, për çka moderatorët duhet të jenë të përgatitur për të dhënë komente e tyre të mbështetura në praktikën gjyqësore dhe dispozitat ligjore për të gjitha çështjet e fushës që trajtohet.

Tryeza është dizajnuar që të zhvillohet në një ambient interaktiv të diskutimeve dhe ushtrimeve praktike. Prezantimi i temave do të bëhet përmes paraqitjes së një apo disa rasteve praktike të

ndërlidhura drejtpërdrejtë me çështjen që duhet të trajtohet sipas agjendës. Për parashtrimin e rastit moderatori duhet të marrë në konsideratë aspektet faktike dhe juridike të rastit, të parashtrij disa pyetje/dilema mbi të cilat do të zhvillohet diskutimi dhe do të konsumohet tema. Moderatori duhet të jetë i përgatitur dhe i hapur për të diskutuar rastin/rastet e ndërlidhur ma temën e sesionit përkatës duke nxitur diskutimin interaktiv dhe analitike të çështjes përkatëse por duke ofruar njëkohësisht pikëpamjet teorike/doktrinare, perspektiven ligjore dhe atë të praktikës gjyqësore si mbështetje për përfundimet e mundshëm që dalin nga rastin që diskutohet. Adresimi i secilës çështje/temë të përmbledhur në këtë tryezë duhet të bëhet edhe përmes një prezantimi të fare të shkurtës (teorik) të nocioneve dhe kuptimeve tjera të secilës çështje të ngritur dhe njëkohësisht duhet të pasohet me shembuj për secilën temë/çështje. Shembjet duhet të jenë të përzgjedhur me kujdes dhe duhet të kenë mbështetje në një praktikë gjyqësore të konsoliduar.

Në fund të punimeve në tryezë moderatorët duhet të hartojnë një raport përmbledhës për tryezën e mbajtur. Raporti do të shërbej për të shpërndarë rezultate e tryezës por edhe për të identifikuar ndonjë çështje që duhet të përfshihet në programet e akademisë për trajnime apo eventualisht edhe të trajtohen nga seanca e përgjithshme Gjykatës Supreme të Kosovës.

Objektivat e tryezës

- Identifikimi i sfidave për zbatimin e dispozitave të ligjit për Pronësinë dhe të drejtat tjera sendore;
- Identifikimi i praktikave jo unike në gjykatat e instancave më të ulëta;
- Adresimi i sfidave përmes prezantimit të praktikës unike gjyqësore, si konkluzion.

Përmbajtja e tryezës

- ✓ E drejta e pronësisë;
- ✓ Bashkëpronësia dhe pronësia e përbashkët;
- ✓ Mënyrat e fitimit të drejtës së pronësisë -Fitimi derivativ dhe origjinere e fitimit të drejtës së pronësisë;
- ✓ Mbrojtja gjyqësore e të drejtës së pronësisë;
- ✓ Të drejtat sendore në sendet e huaja, vërtetimi, konstituimi dhe ndërprerja e servituteve sendore, dhe mbrojtja e servituteve sendore;
- ✓ Posedimi dhe mbrojtja e posedimit;
- ✓ Pengu, hipoteka, parablerja, barra sendore, dhe e drejta e ndërtimit (Superficies).

Metodologjia e tryezës

Gjatë kësaj tryeze do të zhvillohet diskutim interaktiv, prezantim i çështjeve përmes rasteve, diskutim për rastet dhe përmbledhje e konkluzave për çështjen e diskutuar.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e tryezës

Gjyqtarët e gjykatës së Apelit dhe Gjykatave Themelore. Tryeza do të zgjatë dy (2) ditë (përsëritet sipas nevojë).

42. Tryeza për unifikimin e praktikës gjyqësorë

Nevoja për një tryezë lidhur me unifikimin e praktikës gjyqësore e cila duhet të bëhet nga Gjykata Supreme, si gjykatë me juridiksion edhe për përcaktimin e standardeve të praktikës gjyqësore del si rezultat i diskutimeve në tryezat e ndryshme në Akademinë e Drejtësisë por edhe nga diskutimet e brendshme të gjyqtarëve në nivele të ndryshme gjyqësore. Është fakt i njohur se praktika gjyqësore në vendin tonë përballet me vështirësi të ndryshme lidhur me unifikimin, për shkak të disa faktorëve të cilët kanë ndikuar në kontinuitet në shkaktimin e zbatimit jo unik të ligjeve dhe rrjedhimisht në krijimin e praktikave jo unike. Konstatimet për praktika jo unike janë edhe vlerësime nga vendimmarrja gjyqësore në Gjykatën Supreme, e cila vlerëson ligjshmërinë e vendimeve të instancave më të ulëta, prandaj në këtë kontekst nevoja për një tryezë të tillë është e domosdoshme dhe urgjente. Qëllimi i mbajtjes së tryezës është që moderatorët e tryezës të cilët duhet të jenë gjyqtarë të Gjykatës Supreme përmes vendimeve nga praktika gjyqësore të identifikojnë sfidat, problematikat e zbatimit të ligjit dhe veprimin jo unik në praktikën gjyqësore në të gjitha nivelet gjyqësore. Prezantimi i sfidave, problematikave dhe veprimit jo unik në praktikën gjyqësore duhet të bëhet përmes prezantimit të rasteve konkrete, (*vendimeve të Gjykatës Supreme*) përmes së cilave do të konstatohet çështja e identifikuar si sfidë, problem, apo veprim jo unik.

Rastet e prezantuara duhet të jenë të përzgjedhura me kujdes nga ana e moderatorëve në atë mënyrë që përmes rastit apo rasteve të trajtohet çështja e përzgjedhur për diskutim në tryezë. Rastet duhet të parashtrihen sipas një koncepti të parapërgatitur nga moderatorët që nënkupton që moderatorin duhet të paraqesë disa të dhëna për aspektet faktike dhe juridike të çështjes së trajtuar lidhur me vendimin e gjykatës, të parashtrijë disa pyetje për mënyrën e zbatimit të dispozitave materiale juridike, sipas figurës faktike të çështjes së parashtruar. Moderatorët përveç prezantimit të sfidave, problemeve dhe veprimit jo unik në praktikën gjyqësore, pjesëmarrësve duhet të ju ofrojnë materiale të mjaftueshme nga praktika gjyqësore përmes së cilës adresohen çështjet e diskutuara dhe udhëzohen gjyqtarët se si duhet të veprojnë në praktikën gjyqësore. Kjo nënkupton se moderatorët duhet ta hulumtojnë praktikën e Gjykatës Supreme në masë të mjaftueshme për t'u siguruar se materialet e prezantuara (vendimet, opinionet, udhëzimet dhe mendimet juridike) prezantojnë qëndrim unik të gjykatës. Punimet e tryezës duhet të zhvillohen në një ambient interaktiv të diskutimeve, ku pjesëmarrësit do të jenë të lirë të parashtrijë çështjet për diskutim, ndërsa moderatorët duhet të jenë të përgatitur që të ofrojnë përgjigjet adekuate për çështjet e ngritura. Tryeza zhvillohet sipas një agjende kornize të paracaktuar e cila është e kornizuar mbi bazën e çështjeve me problematike të praktikës gjyqësore. Si çështje për diskutim në agjendën kornizë parashihet të jenë diskutimet për çështje pronësore: veçanërisht për mënyrën e fitimit dhe mbrojtjen e pronësisë; diskutimi për çështje procedurale veçanërisht për vendimmarrjen (hartimin dhe arsyetimin e vendimeve); diskutimet për çështje nga marrëdhënia e detyrimeve – veçanërisht çështja e bazave të përgjegjësisë, shkaktimi i dëmit, kriteri dhe masa për vlerësimin e dëmit, nuliteti dhe rrëzueshmërisë së kontratave, institutit të parashkrimit, kamatave, etj.; diskutimeve për çështjet nga e drejta e trashëgimisë me fokus nga cenimi i pjesës së domosdoshme, parashkrimit, etj.; diskutime për çështje nga marrëdhëniet martesore dhe familjare, me fokus për pjesëtimin e pasurisë së përbashkët, mbajtja financiare, besimi dhe ushqimi i fëmijëve. Në agjendën kornizë mund të përfshihen në ndërkohë edhe çështje të cilat identifikohen nga vet moderatorët e tryezës të cilët duhet ta hartojnë edhe agjendën e tryezës. Pas përfundimit të punimeve në tryezë, moderatorët duhet të hartojnë një raport mbi punën e tryezës, e cila përveç të tjerave duhet të prezantojë edhe konkluzat e tryezës por edhe çështjet të cilat mund të jenë objekt i adresimit në seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme të Kosovës. Raporti duhet të jete i hartuar në mënyrë të tillë, që të ofrojë për gjyqtarët jo pjesëmarrës, informacion të mjaftueshëm për diskutimet dhe konkluzionet e arritura në tryezë.

Objektivat e tryezës

- Identifikimi i sfidave në praktiken gjyqësore;
- Identifikimi i situatave të zbatimit jo unik të dispozitave ligjore nga kolegjet apo gjyqtarët e niveleve të ndryshme;
- Adresimi, prezantimi dhe dhënia e rekomandimeve për mënyrën unike të veprimit në praktikën gjyqësore.

Përmbajtja e tryezës

- ✓ Mënyrat e fitimit dhe mbrojtjes së pronësisë;
- ✓ Diskutimi për çështje procedurale veçanërisht për vendimmarrjen (hartimin dhe arsyetimin e vendimeve);
- ✓ Diskutimet për çështje nga marrëdhënia e detyrimeve – veçanërisht çështja e bazave të përgjegjësisë;
- ✓ Shkaktimi i demit;
- ✓ Kriteri dhe masa për vlerësimin e demit;
- ✓ Nuliteti dhe rrëzueshmeria e kontratave;
- ✓ Instituti i parashkrimit;
- ✓ Kamatat;
- ✓ Diskutime për çështjet nga e drejta e trashëgimisë me fokus cenimi i pjesës së domosdoshme;
- ✓ Parashkrimi;
- ✓ Diskutime për çështje nga marrëdhëniet martesore dhe familjare, me fokus për Pjesëtimin e pasurisë së përbashkët,
- ✓ Mbajtja financiare,
- ✓ Besimi dhe ushqimi i fëmijëve.

Metodologjia e tryezës

Gjatë kësaj tryeze do të zhvillohet diskutim interaktiv, prezantim i çështjeve përmes rasteve, diskutim për rastet dhe përmbledhje e konkluzave për çështjen e diskutuar.

Përfituesit e tryezës

Gjyqtarët e gjykatës së Apelit. Tryeza do të zgjatë dy (2) dite.

Drejtësia për fëmijë

Aspekti Civil

43. Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror dhe në rastet e ndryshimit të statusit të tyre

Trajnimet nga fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve zënë vend të rëndësishëm në programin trajnues. Në këtë program ndër të tjera do të trajtohen çështjet rreth mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror, si dhe për format e mbrojtjes së veçantë të këtyre fëmijëve të cilat janë të normuara me Ligjin për Familjen (LFK), duke pasur si reference Konventën për të Drejtat e Fëmijës (KDF). Gjithashtu do të diskutohet rreth mënyrës dhe metodave të komunikimit të gjykatës me fëmijët në procedurë gjyqësore, parimit të interesit më të lartë të fëmijës, rolit të gjykatës dhe organit të kujdestarisë në procedurat që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror dhe në rastet e ndryshimit të statusit të tyre, si dhe legjislacionit të zbatueshëm vendor dhe atij ndërkombëtar, përfshirë këtu edhe risitë e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës. Ky program do të fokusohet në analizimin e legjislacionit të zbatueshëm që i referohet procedurës gjyqësore për dhënien e mbrojtjes juridike për të drejtat e fëmijëve pa përkujdesje prindërore dhe në rastet e ndryshimit të statusit të tyre.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Vlerësojnë rastet lidhur me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror;
- Analizojnë dispozitat ligjore mbi adoptimin, atësinë dhe amësinë;
- Aplikojnë drejtë mënyrat dhe metodat e komunikimit të gjykatës me fëmijët në procedurën gjyqësore.
- Të njohin dhe zbatojnë dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror;
- ✓ Adoptimi, Amësia dhe atësia;
- ✓ Mënyrat dhe metodat e komunikimit të gjykatës me fëmijët në procedurë gjyqësore;
- ✓ Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në procedurën e kundërshtimit dhe vërtetimit të atësisë apo amësisë dhe parimi i interesit më të lartë të fëmijës.
- ✓ Risitë dhe zbatimi në praktikë i dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës.

Metodologjia

Gjatë trajnimit do të përdoren metoda të kombinuara teorike dhe praktike, punë në grupe, të përcjella me shembuj nga praktika gjyqësore.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët e nivelit të Apelit dhe nivelit themelor (divizioni civil), bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët e Organit të Kujdestarisë. Trajnimi do të zgjasë dy (2) ditë.

44. Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në rastet e shkurorëzimit dhe në rastet e dhunës në familje

Kontestet martesore–familjare janë mjaft komplekse për shkak të natyrës së tyre dhe se roli i gjykatës në këto konteste nuk është vetëm shqyrtues por edhe hetues. Dhunë në familje konsiderohet çdo shkelje e të drejtës së gruas, burrit dhe fëmijëve nga persona që janë dhe konsiderohen pjesëtarë të familjes. Rastet e dhunës në familje bëhen edhe më të vështira dhe sfiduese në rastet kur janë të përfshirë edhe fëmijët.

Trajnimi do të fokusohet në analizimin e legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar mbi çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në kontestet martesore – familjare dhe në rastet e dhunës në familje.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zbatojnë mbrojtje efikase dhe efektive të të drejtave të fëmijëve gjatë procedurës së shkurorëzimit;
- Zbatojnë drejtë dispozitat ligjore me rastin e besimit, ruajtjes dhe kujdesit të fëmijëve;
- Aplikojnë procedurat standarde të veprimtimit për mbrojtje nga dhuna në familje;
- Zbatojnë drejtë procedurën dhe afatet për vendosje sipas kërkesave për urdhër mbrojtje;
- Krahasojnë specifikat e dhunës në familje në procedurë civile dhe penale.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Parimet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve sipas legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar;
- ✓ Kriteret që merr për bazë gjykata në rastet e besimit të fëmijëve dhe parimet për përcaktimin e alimentacionit;
- ✓ Caktimi i kontakteve personale të fëmijëve të mitur me prindërit;
- ✓ Dhuna në familje, urdhri për mbrojtje dhe procedura gjyqësore për vendosje sipas kërkesave për urdhër mbrojtje;
- ✓ Llojet e masave mbrojtëse dhe kohëzgjatja e tyre, ekzekutimi dhe pasojat e mos ekzekutimit të urdhrit për mbrojtje.

Metodologjia e trajnimit

Trajnimi do të realizohet me metoda interaktive dhe prezantim të rasteve konkrete nga praktika gjyqësore. Përfituesit janë gjyqtarët e nivelit të Apelit dhe atij themelor (divizioni civil), bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët ligjor, policia e Kosovës, mbrojtësit e viktimave dhe përfaqësuesit e Qendrave Sociale.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët e nivelit të Apelit dhe nivelit themelor (divizioni civil), bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët e Organit të Kujdestarisë. Trajnimi do të zgjasë dy (2) ditë.

Aspekti Penal

45. Procedura përgatitore te kryesit e mitur të veprave penale

Prokurori i shtetit për të mitur mund të fillojë procedurën përgatitore ndaj të miturit të caktuar në bazë të kallëzimit penal. Për veprat penale të dënueshme me burgim prej më pak se tre vjet ose me gjobë, prokurori i shtetit për të mitur mund të vendosë të mos fillojë procedurën përgatitore edhe pse ekziston dyshim i bazuar se i mituri e ka kryer vepër penale, nëse prokurori i shtetit për të mitur mendon se nuk do të ishte e përshtatshme të zbatohet procedura ndaj të miturit për shkak të natyrës së veprës penale, të rrethanave në të cilat është kryer ajo, mungesës së dëmit të rëndë ose të pasojave për të dëmtuarin, si edhe të së kaluarës së të miturit dhe karakteristikave të tij personale.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zbatojnë drejtë dispozitat ligjore;
- Identifikojnë problemet praktike me rastin e zhvillimit të procedurës përgatitore;
- Vlerësojnë se për cilat raste prokurori për të mitur mund të fillojë procedurën përgatitore.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Aktvendimi për fillimin e procedurës përgatitore;
- ✓ Roli i gjykatësit për të mitur dhe prokurorit për të mitur;
- ✓ Roli i palëve tjera në këtë fazë të procedurës.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij sesiioni të trajnimit do të përdoren prezantime të materialeve në PowerPoint, metoda interaktive të trajnimit duke i shoqëruar me raste praktike dhe hipotetike për situata të ndryshme kur prokurori për të mitur bie aktvendim për fillimin e procedurës përgatitore.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarë dhe prokurorë nga Departamenti për të Mitur si dhe zyrtar nga Shërbimi Sprovues i Kosovës. Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

46. Të miturit si kryes të veprave penale dhe kategorizimi i tyre

Të miturit dallohen nga të rriturit për sa i përket zhvillimit fizik dhe psikologjik, si dhe nga nevojat emocionale dhe edukative. Dallimet e tilla paraqesin parimet bazë për fajësinë më të vogël në rastin e të miturve që bien ndesh me ligjin. Këto dhe dallimet tjera janë arsyet për sistem të veçantë të drejtësisë për të mitur dhe kërkojnë trajtim të ndryshëm të tyre gjatë zhvillimit të procedurës si dhe me rastin e shqiptimit të ndonjërës nga masat apo dënimet, varësisht nga mosha si dhe vepra penale e kryer nga i mituri.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Interpretojnë drejtë dispozitat ligjore;
- Dallojnë rastet kur kemi të bëjmë me të miturin e ri dhe të miturin e rritur;
- Saktësojnë se kur kemi të bëjmë interesin më të mirë të të miturit i cili ka rënë ndesh me ligjin.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Nocioni i të miturit dhe fillimi i përgjegjësisë penale për të mitur;
- ✓ I mituri i ri, i mituri i rritur;
- ✓ Zhvillimi i procedurës penale për të miturin që ka kryer vepër penale.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij trajnimi do të përdoret një metodologji e kombinuar, ku do të aplikohen metodat të diskutimit interaktiv me pjesëmarrësit. Gjithashtu, përfituesve do t'ju ofrohen për të diskutuar edhe raste praktike.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarë dhe prokurorë nga Departamenti për të Mitur si dhe zyrtarë nga Shërbimi Sprovues i Kosovës. Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

47. Veprat penale kundër integritetit seksual të fëmijëve

Kodi Penal i Republikës së Kosovës, në kuadër të kapitullit të veprave penale kundër integritetit seksual, ndër të tjera parasheh edhe disa vepra që prekin integritetin seksual të fëmijëve. Zbatimi i drejtë i dispozitave ligjore nga ky kapitull shpesh herë në praktikë paraqitet si sfida për gjyqtarët dhe prokurorët, për shkak të specifikave të cilat duhet të respektohen. Fëmijët janë kategoria më e ndjeshme e shoqërisë për të cilët shteti me mekanizmat e tij është i obliguar të kujdeset dhe t’ju ofroj mbrojtje gjatë dhe pas gjithë procedurës, duke e pasë parasysh interesin më të mirë për të miturin dhe pasojat negative të cilat i ka përjetuar fëmija si viktimë e këtyre krimeve.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Analizojnë drejtë veprimet procedurale të cilat ndërmerren kur kemi të bëjmë me viktimën fëmijë;
- Ti njohin elementet dhe karakteristikat e veprave penale kundër integritetit seksual të fëmijëve;
- Zbatojnë drejtë dispozitat lidhur me këto vepra penale.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Veprat penale të kryera nga madhorë ku viktimë janë fëmijët;
- ✓ Parimet e përgjithshme që duhet të respektohen si dhe veprimet procedurale të cilat duhet të ndërmerren kur kemi të bëjmë me viktimën fëmijë nga veprat penale kundër integritetit seksual;
- ✓ Marrja në pyetje e të dëmtuarit fëmijë kur është viktimë e veprës penale kundër integritetit seksual.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij trajnimi do të bëhet prezantimi i rasteve nga praktika gjyqësore dhe diskutimet në grupe, do të ofrohen alternativa për shumë çështje që kanë të bëjnë me veprat penale kundër integritetit seksual të fëmijëve. Trajtimi i këtyre çështjeve do të bëhet përveç tjerash, edhe me një pjesëmarrje dhe diskutim interaktiv me pjesëmarrësit, për t’u përgjigjur edhe në të gjitha pyetjet dhe dilemat që mund të paraqiten në praktikën gjyqësore.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarë dhe prokurorë nga Departamenti për të Mitur si dhe zyrtarë nga Shërbimi Sprovues i Kosovës. Trajnimi do të zgjasë dy (2) ditë.

48. Shqyrtimi gjyqësor të kryesit e mitur të veprave penale

Shqyrtimi gjyqësor konsiderohet faza më e rëndësishme e procedurës penale për të mitur. Me qëllim që kjo fazë të zhvillohet me sukses dhe pa pengesa, atëherë nevojitet që gjyqtari për të mitur apo i trupit gjykues për të mitur ti bëjë pararakisht përgatitjet e caktuara. Këto përgatitje kanë të bëjnë si me caktimin e shqyrtimit gjyqësor, ashtu edhe me çështje tjera përgatitore për shkak të specifikave që ka shqyrtimi gjyqësor i rasteve penale kur si kryes të veprave penale janë të miturit. Të gjitha këto situata do të adresohen përmes këtij trajnimi duke zbërthyer procedurën e shqyrtimit gjyqësor përmes rasteve praktike dhe analizimit të dispozitave ligjore që i referohen kësaj procedure.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zbatojnë drejtë procedurën lidhur me shqyrtimin gjyqësor;
- Evitojnë disa nga dilemat e mundshme që janë paraqitur në praktikën tonë gjyqësore;
- Interpretojnë drejtë normat ligjore që rregullojnë shqyrtimin gjyqësor.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Përgatitja, fillimi zhvillimi i shqyrtimit gjyqësor;
- ✓ Subjektet dhe palët në procedurë;
- ✓ Zbatimi i konventave ndërkombëtare kur kemi të bëjmë me gjykimin e të miturit si pasojë e kryerjes së veprës penale.

Metodologjia e trajnimit

Trajnimi ka për qëllim që të përgjigjet në pyetjet lidhur me këtë çështje duke analizuar dhe sqaruar dispozitat ligjore përkatëse. Gjithashtu do të analizohen problemet praktike përmes diskutimeve dhe studimit të rasteve nga praktika gjyqësore.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarë dhe prokurorë nga Departamenti për të Mitur si dhe zyrtar nga Shërbimi Spovues i Kosovës. Trajnim do të zgjasë një (1) ditë.

49. Llojet e masave dhe dënimeve që shqiptohen ndaj të miturve

Kodi garanton që interesi më i lartë i fëmijës të përcaktohet me kujdes në sistemin e drejtësisë, si dhe do ta sjellë sistemin e drejtësisë për të miturit në përputhje me standardet ndërkombëtare të cilat rrjedhin nga Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës. Kështu që masat edukative, si dhe dënimet që mund t'ju shqiptohen kryerësve të veprave penale kanë disa kufizime ligjore, pra mund t'i shqiptohen çdo të mituri që ka mbushur moshën e përcaktuar sipas KDM. Si faktorë për mos zbatim shpesh konsiderohet anketa sociale jo e plotë apo jo profesionale dhe mos vlerësimi i drejtë i përfitimeve të këtyre masave. Drejtësinë për të mitur në Kosovë e përshkojnë një numër i madh i parimeve, disa prej të cilave janë universale. Ndër parimet e veçanta dhe specifike është që kryerësve të mitur sipas nevojës u shqiptohen masat e ndryshme edukative si dhe dënimet.

Objektivat e modulit të trajnimit

- Identifikojnë kushtet ligjore për shqiptimin e këtyre masave apo dënimeve;
- Zbatojnë llojet masave apo të dënimeve që mund të shqiptohen ndaj të miturit;
- Dallojnë kushtet për shqiptimin e masave apo dënimeve.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Masat e diversitetit;
- ✓ Masat edukuese;
- ✓ Dënimet;
- ✓ Aktvendimet dhe Aktgjykimet.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij trajnimi do të përdoret një metodologji e kombinuar, ku do të aplikohen metodat të diskutimit interaktiv me pjesëmarrësit. Gjithashtu, do t'ju ofrohen për të diskutuar edhe rastet praktike.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarë dhe prokurorë nga Departamenti për të Mitur si dhe zyrtarë nga Shërbimi Sprovues i Kosovës. Trajnim do të zgjasë një (1) ditë.

Drejtësia komerciale

50. Praktika gjyqësore komparative në lëmin e falimentimit në vendet e Bashkimit Evropian

Rëndësia e procedurave të falimentimit është e dukshme kohët e fundit për shkak të ndryshimit të trendeve ekonomike. Kriza ekonomike e vitit 2008 ishte një mësim i mirë që duhet t'i kushtohet vëmendje edhe mbylljes së bizneseve, përveç stimujve të krijuar për hapjen e bizneseve. Një rëndësi e tillë theksohet për shkak të ndikimit të procesit të falimentimit në rritjen e përgjithshme të produktivitetit të vendeve. Çdo vit, miliarda dollarë në vlerë biznesi, vende pune dhe kapital humben ose anashkalohen, si rezultat i asaj që bizneset e humbin aftësinë paguese dhe mbyllen. Kthimi joefektiv i borxheve dhe mekanizmat e dobët për mbylljen e bizneseve krijojnë kosto më të lartë të kapitalit dhe rritjen e perceptimit të rrezikut në mesin e investitorëve dhe institucioneve financiare. Procedura e falimentimit si mekanizëm i shpëtimit të bizneseve nga likuidimi është aktualizuar sidomos në kohën e paraqitjes së pandemisë e cila ka shkakuar vështirësi të mëdha për bizneset dhe rrezikon shuarjen e tyre, andaj pothuajse të gjitha shtetet janë përqendruar në gjetjet e metodave dhe mekanizmave më efikas që përmes procedurës së falimentimit respektivisht riorganizimit të shoqërive tregtare të ruhet ekonomia dhe vendet e punës.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Avancojnë njohuritë rreth procedurave të përshpejtuara dhe specifikat e tyre;
- Vlerësojnë drejtë specifikat e hapjes së rastit të falimentimit, proceduarat ligjore, afatet dhe vendimet e gjykatës;
- Njohin specifikat e hapjes së rastit të falimentimit, proceduarat ligjore, afatet dhe vendimet e gjykatës;
- Zgjerojnë njohuritë lidhur me riorganizimi, likuidimin dhe specifikat e tyre;
- Zbatojnë drejtë dispozitat ndërkufitare dhe përmbajtja e tyre

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Procedurat e përshpejtuara (NVM dhe para-pakot);
- ✓ Fillimi dhe hapja e rasteve, Pasojat e hapjes së rastit;
- ✓ Kërkesat e kreditorëve;
- ✓ Riorganizimi;
- ✓ Likuidimi;
- ✓ Lirimi individual dhe Mbyllja e rastit;
- ✓ Dispozitat ndërkufitare.

Metodologjia e trajnimit

Në këtë trajnim do të aplikohet një metodologji interaktive e të mësuarit e cila përbëhet prej ligjëratave, ushtrimeve dhe diskutimeve dhe do të përfshijë: Prezantim të rasteve hipotetike dhe rasteve konkrete nga praktika gjyqësore dhe diskutime për mënyrën e vendosjes meritore për rastet konkrete dhe diskutim-bashkëbisedim.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët nga Departamenti për Çështje Ekonomike i Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit, Prokurorët nga Departamentet për krime ekonomike. Trajnimi do të zgjasë dy (2) ditë.

51. Të drejtat e pronësisë intelektuale, markat tregtare, patentat

Të drejtat nga pronësia intelektuale (DPI) janë duke zënë gjithnjë e më shumë një vend të rëndësishëm në sferën juridike. Këto të drejta dhe mbrojtja e tyre mund të konsiderohen si tregues të zhvillimit ekonomik, krahas faktorëve të tjerë. Mbrojtja e të drejtave nga pronësia intelektuale ka efekt në rritjen e qëndrueshmërisë ekonomike dhe krijimin e parakushteve për zhvillim ekonomik si dhe tërheqjen e investimeve të huaja. Mbrojtja e të drejtave të pronës intelektuale tashmë është bërë një ndër fushat më të rëndësishme për bizneset, meqë shumica e tyre identifikohen me një emër, shenjë, formë, dizajn dhe produkt të caktuar. Edhe pse në Kosovë ekziston infrastruktura ligjore për mbrojtjen e të Pronësisë Intelektuale, si në aspektin civil ashtu edhe penal, megjithatë ende nuk është arritur që të krijohen mekanizma funksional për parandalimin e shkeljes së këtyre të drejtave, andaj rrjedhimisht titullarët e këtyre të drejtave të vetmen mundësi të mbrojtjes efektive të të drejtave e kanë mbrojtjen gjyqësore. Si rezultat i kësaj, në gjykatë janë paraqitur një numër i caktuar i rasteve por ky numër pritet të rritet shumë në të ardhmen e afërt. Prandaj trajtimi i kësaj teme, është i një rëndësie të veçantë për të rritur njohuritë e pjesëmarrësve dhe krijimin e praktikave uniforme në trajtimin e rasteve.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Avancojnë njohuri lidhur me sistemin kompleks të të drejtave të pronësisë intelektuale si dhe rregullimin juridik të tyre;
- Identifikojnë llojet e ndryshme të të drejtave nga pronësia intelektuale dhe mënyrën e krijimit, realizimit dhe mbrojtjes së tyre;
- Zgjerojnë njohuritë për mbrojtjen juridike në aspektin civil, penal dhe mbrojtjen alternative të drejtave të autorit – shoqatat profesionale;
- Aplikojnë drejtë procedurën gjyqësore për mbrojtjen e të drejtës së autorit.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Të drejtat e autorit;
- ✓ Markat tregtare;
- ✓ Patentat;
- ✓ Dizajnet industriale.

Metodologjia e trajnimit

Metodologjia e kursit përfshinë prezantime nga trajnuesi, të cilat orientohen dhe përdorin si shembuj raste konkrete dhe hipotetike. Kjo metodologji bazohet në ushtrime, diskutime, simulime, dhe aktivitete të përpiluara për aplikimin e koncepteve të strukturave afariste në situata praktike.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët nga Departamenti për Çështje Ekonomike i Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit, Prokurorët nga Departamentet për krime ekonomike. Trajnimi do të zgjasë dy (2) ditë.

52. Zbatimi në praktikë i Ligjit për Shoqëritë Tregtare

Shoqëritë tregtare janë bartës i zhvillimit ekonomik në vendet me ekonomi të tregut. Kosova në përpjekjet e saj për zhvillim ekonomik ka ndërmarrë masa të ndryshme për të siguruar infrastrukturën e nevojshme për krijim e parakushteve për zhvillimin e biznesit. Në këtë drejtim Kosova ka miratuar Ligjin për shoqëritë tregtare i cili përbën një bazament të mirë për krijimin e një ekonomie të tregut dhe mundësimin e investime të huaja në Kosovë. Ky ligj përcakton llojet e shoqërive tregtare, kushtet e regjistrimit, themelimin dhe shuarjen e shoqërive, të drejtat dhe detyrimet e pronarëve, zyrtarëve të shoqërive tregtare, përfaqësuesve të tyre. Në praktikën gjyqësore, numri i kontesteve që rrjedhin nga veprimtaria afariste e shoqërive tregtare është i konsiderueshëm, me tendencë të rritjes, prandaj trajtimi i kësaj teme, është i një rëndësie të veçantë për rritur njohuritë e gjyqtarëve lidhur me trajtimin e rasteve.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Njohin kapacitetin dhe strukturat juridike të shoqërive tregtare;
- Analizojnë kushtet e regjistrimit, themelimit dhe shuarjes së shoqërive tregtare;
- Zgjerojnë njohuritë për të drejtat dhe detyrimet e pronarëve, zyrtarëve të shoqërive tregtare, përfaqësuesve të tyre dhe personave të tretë.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Mënyrat e themelimit dhe shuarjes së shoqërive tregtare dhe pasojat juridike që krijojnë;
- ✓ Mënyrat e organizimit, struktura e kapitalit dhe të drejtat dhe detyrimet e pronarëve, zyrtarëve të shoqërive tregtare, përfaqësuesve të tyre dhe personave të tretë;
- ✓ Procedurat ligjore dhe aplikimi i tyre në mbrojtjen e të drejtave që rrjedhin nga shoqëritë tregtare.

Metodologjia e trajnimit

Metodologjia e trajnimit përfshinë prezantime nga trajnuesi, të cilat orientohen dhe përdorin si shembuj raste konkrete dhe hipotetike. Kjo metodologji bazohet në ushtrime, diskutime, simulime, dhe aktivitete të përpiluara për aplikimin e koncepteve të strukturave afariste në situata praktike.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët nga Departamenti për Çështje Ekonomike i Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit. Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

53. E drejta kontraktuese, kontratat e ndërtimit

Në ekonominë e tregut bizneset e zhvilluara të cilat merren me veprimtari specifike, përdorin kontrata që janë specifike për afarizmin e tyre, e të cilat dallojnë si për nga struktura ashtu edhe nga të drejtat dhe detyrimet që krijojnë për palët. Kontratat mbi ndërtimin dhe Kontratat e Inxhinjeringut aktualisht kanë gjetur përdorim shumë të madh në fushën e ndërtimit duke pasur parasysh fazën e rindërtimit të vendit. Po ashtu, kontratat publike nga kjo fushë kanë një përdorim të gjerë në sferën publike. Ndërsa shoqëritë tregtare gjatë zhvillimit të biznesit në sferën ndërkombëtare shpesh aplikojnë kontratat për të cilat zbatohet Konventa për shitje ndërkombëtare të mallrave. Këto kontrata kanë specifika të veçanta dhe kërkojnë njohuri të veçantë me rastin e zbatimit dhe interpretimit të dispozitave kontraktuese andaj kërkohen njohuri të posaçme, jo vetëm juridike por edhe nga fushat që mbulojnë këto kontrata, për zgjidhjen e kontestve që lindin nga raporti afarist i krijuar përmes këtyre kontratave.

Në praktikën gjyqësore numri i kontesteve që rrjedhin nga këto kontrata është i konsiderueshëm, me tendencë të rritjes, prandaj trajtimi i kësaj teme është i një rëndësie të veçantë për rritur njohuritë e gjyqtarëve për trajtimin e rasteve.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Rrisin ekspertizën profesionale rreth kontratës së ndërtimit, specifikat e saj, klauzolat e posaçme dhe karakteristikat tjera;
- Avancojnë njohuritë rreth kontratës së inxhinjeringut dhe kontratat publike, llojet dhe karakteristikat e saj;
- Aplikojnë drejtë procedurat ligjore në mbrojtjen e të drejtave të palëve afariste, në kontestet që rrjedhin nga mos përmbushja e këtyre kontratave.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Kontrata mbi ndërtimin dhe specifikat e tyre;
- ✓ Kontrata publike dhe specifikat e tyre;
- ✓ Klauzolat e kontratës së ndërtimit;
- ✓ Uzansat e ndërtimit të kontratat e ndërtimit.

Metodologjia e trajnimit

Metodologjia e trajnimit përfshinë prezantime nga trajnuesi, të cilat orientohen dhe përdorin si shembuj raste konkrete dhe hipotetike. Kjo metodologji bazohet në ushtrime, diskutime, simulime, dhe aktivitete të përpiluara për aplikimin e koncepteve të strukturave afariste në situata praktike.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët nga Departamenti për Çështje Ekonomike i Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit. Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

Konventa Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e
Njeriut

54. Ndalimi i torturës - Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Ndalimi i torturës është një nga të drejtat themelore të garantuara të njeriut. Kjo e drejtë zë vend të rëndësishëm në nenin 3 të KEDNJ-së ku garantohet që askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore apo poshtëruese. Neni 3 mishëron një nga vlerat më themelore të shoqërisë demokratike. Ndalimi i torturës zë vend të rëndësishëm në një mori instrumentesh të detyrueshme ndërkombëtare, si dhe në kushtetutat e të gjitha vendeve demokratike, përfshirë edhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Aktualisht, rastet e torturës janë format më të rënda dhe më akute të shkeljes së Nenit 3. Mbrojtja që siguron Neni 3 është kundër llojeve të ndryshme të dhunës ndaj dinjitetit njerëzor dhe integritetit fizik.

Neni 3 i KEDNJ-së ofron mbrojtje për ankimet për personat që administrohen nga policia nën pretendimet se janë keqtrajtuar ose që kushtet e ndalimit kanë qenë çnjerëzore, që dëbimi i një individ do ta ekspozonte atë ndaj trajtimit çnjerëzor në vendin ku dorëzohet, tek palët e treta, e deri në ankime për të cilat gjykatat kanë dështuar në mbrojtjen që duhet t'i siguronin viktimave nga abuzimi prej individëve të tjerë privatë.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Shpjegojnë kushtet dhe kujdesin shëndetësor në paraburgim dhe përgjegjësitë gjyqësore;
- Analizojnë përgjegjësitë shtesë gjyqësore, papranueshmërinë e provave, ekstraterritorialitetin, si dhe pretendimet civile;
- Demonstrjnë mënyrën e marrjes së veprimeve hetimore ndaj shkeljeve të Nenit 3.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Përkufizimi i torturës ose dënimeve apo trajtimeve çnjerëzore, poshtëruese ose denigruese;
- ✓ Kushtet dhe kujdesi shëndetësor në paraburgim dhe përgjegjësitë gjyqësore;
- ✓ Përgjegjësitë shtesë gjyqësore: papranueshmëria e provave, ekstraterritorialiteti, pretendimet civile;
- ✓ Masat mbrojtëse procedurale dhe organizative;
- ✓ Detyrimet pozitive për të kryer një hetim efektiv për një shkelje të pretenduar të nenit 3;
- ✓ Fillimi i hetimeve, detyrimet procedurale dhe luftimi i mosndëshkimit.

Metodologjia e trajnimit

Diskutime interaktive, përkatësisht do të kombinohen me raste studimore, duke u përcaktuar në zgjidhjen e detyrave individuale dhe atyre grupore brenda vijuesve.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatave Themelore, Bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor. Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

55. E drejta në pronë - Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 1 i Protokollit Nr. 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut garanton të drejtën e pronës. Kjo dispozitë parasheh që: “Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.”

KEDNJ nuk është instrumenti i vetëm ndërkombëtar i të drejtave të njeriut që parasheh të drejtën e pronës. Edhe në kohën e hartimit të protokollit, shtetet kanë pasur rezervat e veta karshi detyrimeve që do të dalin nga këto detyrime ndërkombëtare. Me kalimin e kohës jurisprudenca ndërkombëtare është konsoliduar dhe ka dhënë shembuj të mirë të zbatimit të ligjshmërisë në shumë raste, duke krijuar standarde të larta të vendimmarrjes shtetërore karshi personave që ushtrojnë dhe kanë të drejtat pronësore brenda një juridiksioni shtetëror brenda shteteve anëtare të Konventës. Veçanërisht në vitet e fundit, ka pasur shumë raste në të cilat Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka gjetur se Shteti ka tejkalluar kufirin e tij të vlerësimit dhe ka shkelur të drejtën e pronës të garantuar nga neni 1 i Protokollit Nr. 1.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Përkufizojnë të drejtën e pronës sipas KEDNj dhe jurisprudencës së GJEDNj;
- Shpjegojnë shtrirjen e të drejtës së pronës sipas KEDNj dhe jurisprudencës së GJEDNj;
- Analizojnë rregullat e veçanta (tri rregullat) të të drejtës së pronës sipas KEDNj dhe jurisprudencës së GJEDNj;
- Demonstrojnë rastet e kufizimit të të drejtës së pronës sipas KEDNj dhe jurisprudencës së GJEDNj;

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Përkufizimi i të drejtës së pronës sipas KEDNj dhe jurisprudencës së GJEDNj;
- ✓ Shtrirja e të drejtës së pronës sipas KEDNj dhe jurisprudencës së GJEDNj;
- ✓ Rregullat e veçanta (tri rregullat) të të drejtës së pronës sipas KEDNj dhe jurisprudencës së GJEDNj;
- ✓ Kufizimi i të drejtës së pronës sipas KEDNj dhe jurisprudencës së GJEDNj;
- ✓ Zbatimi i të drejtës së pronës ndërmjet palëve private sipas KEDNj dhe jurisprudencës së GJEDNj.

Metodologjia e trajnimit

Tema e këtij trajnimi do të ligjërohet me ligjërata interaktive, përkatësisht do të kombinohet me raste studimore, duke u përcaktuar në zgjidhjen e detyrave individuale dhe atyre grupe brenda vijuesve.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit: Gjyqtarët nga Departamenti nga Departamenti i Përgjithshëm, për Çështje Ekonomike dhe Administrative. Trajnimi do të zgja së një (1) ditë.

56. E drejta e mbrojtjes së pronës - Neni 1. i Protokollit nr.1. të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore

Qëllimi i këtij trajnimi është avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me të drejtën e respektimit të pasurisë së personit dhe mundësia e privimit nga kjo e drejtë për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuar nga ligji si dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Arsye tjetër shtesë për trajtim të kësaj tematike është shpjegimi i ndërhyrjes së domosdoshme në një shoqëri demokratike nga ana e autoriteteve kombëtare. Fokusi do të jetë edhe në zbërthimin e nocioneve dhe kategorive që përmban neni 1. i Protokollit 1, si dhe mënyra e interpretimit që bënë Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në Strasburg.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Njohin rolin e së drejtës për respektimin e pasurisë së individit;
- Zbërthejnë kushtet për ndërhyrjen në të drejtën e pronës për arsye të interesit publik;
- Zbatojnë drejtë standardet dhe kriteret për kompensim për privimet nga prona në kontekst të nenit 1. Protokollit nr.1 të KEDNJ dhe praktikës së GJEDNJ.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Nocionet themelore që përmban Neni 1. i Protokollit nr.1 të KEDNJ;
- ✓ Roli i së drejtës për respektimin e pasurisë së individit;
- ✓ Kushtet për ndërhyrje në të drejtën e pronës për arsye të interesit publik;
- ✓ Standardet dhe kriteret për kompensim për privimet nga prona në kontekst të Nenit 1. Protokollit nr.1 të KEDNJ dhe praktikës së GJEDNJ.

Metodologjia e trajnimit

Ndër metodat kryesore që do të përdoren gjatë këtij trajnimi do të jenë: shpjegime të pjesshme teorike dhe raste nga praktika gjyqësore; diskutime interaktive në grupe të ndara, të cilët do të mbrojnë dhe argumentojnë qëndrime të ndryshme dhe do të bëjnë analizë të rasteve gjyqësore nga GJEDNJ. Gjithashtu, në këtë trajnim synohet arritja e një pjesëmarrjeje aktive të përfituesve, në mënyrë që edhe ata të kontribuojnë në realizimin e objektivave të trajnimit.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët dhe prokurorët të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës dhe bashkëpunëtorët profesional. Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

57. E drejta për jetë private, jetë familjare, të vendbanimit dhe korrespondencës, për tu martuar dhe krijuar familje dhe për barazi të bashkëshortëve – Neni 8 Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore

Synimi i këtij trajnimi është avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me të drejtën e jetës private dhe familjare. Arsye tjetër shtesë për trajtim të kësaj tematike është edhe hezitimi në zbatimin e KEDNJ nga gjyqtarët e Kosovës. Fokusi i trajnimit do të jetë në zbërthimin e nocioneve dhe kategorive që përmban Neni 8 për të drejtën në respektimin e jetës private dhe familjare si dhe mënyrën e interpretimit që bënë Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në Strasburg.

Në trajnim do të trajtohen dilemat dhe pyetjet që kanë të bëjnë me aspektet e dispozitave që përmban neni 8 i KEDNJ. Njëkohësisht në trajnim do të evitohen dilemat rreth interpretimit të dispozitave në fjalë përmes rasteve praktike të GJEDNJ. Gjithashtu do të trajtohen nocionet themelore që përmban neni 8 i KEDNJ, nocionin dhe natyrën juridike të jetës private, të jetës familjare, dhe kriteret e KEDNJ lidhur me privatësinë, korrespondencën dhe vendbanimin, përgjimin si dhe mbledhjen e të dhënave. Gjithashtu në fokus do jenë edhe zbatimi i drejtë dispozitave të Nenit 8 lidhur me ndërhyrjen e autoritetit publik në ushtrimin e kësaj të drejte, në shkallën e parashikuar me ligj.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zbërthejnë natyrën juridike të jetës familjare;
- Njohin kriteret e KEDNJ lidhur me privatësinë, korrespondencën dhe vendbanimin-përgjimin si dhe mbledhjen e të dhënave;
- Zbatojnë drejtë dispozitat e Nenit 8 lidhur me ndërhyrjen e autoritetit publik në ushtrimin e kësaj të drejte, në shkallën e parashikuar me ligj.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Kuptimi dhe natyra juridike e jetës familjare;
- ✓ Privatësia, korrespondenca dhe vendbanimi-përgjimi dhe mbledhja e të dhënave;
- ✓ Ndërhyrja e autoritetit publik në ushtrimin e kësaj të drejte, në shkallën e parashikuar me ligj.

Metodologjia e trajnimit

Ndër metodat kryesore që do të përdoren gjatë këtij trajnimi do të jenë: shpjegime të pjesshme teorike dhe raste nga praktika gjyqësore; diskutime interaktive në grupe të ndara, të cilët do të mbrojnë dhe argumentojnë qëndrime të ndryshme dhe analizë të rasteve gjyqësore nga GJEDNJ. Gjithashtu në këtë trajnim synohet arritja e një pjesëmarrjeje aktive të përfituesve, në mënyrë që edhe ata të kontribuojnë në realizimin e objektivave të trajnimit.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës dhe bashkëpunëtorët profesional. Trajnim do të zgjasë një (1) ditë.

58. E drejta për një proces të rregullt

Qëllimi i këtij trajnimi është avancimi i njohurive mbi të drejtën për proces të rregullt në procedurat civile dhe administrative. Fokusi do të jetë edhe në zbërthimin e kuadrit të së drejtës për proces të rregullt, e drejta për qasje në gjykatë, gjykimi në kohë të arsyeshme, parimi i sigurisë juridike – harmonizimi i praktikës gjyqësore vendore, procedurat jashtë-kontestimore, shembuj nga aktgjykimet e GJEDNJ). Në trajnim do të trajtohen çështjet që kanë të bëjnë me aspektet e dispozitave ligjore që përmban neni 6 i KEDNJ. Njëkohësisht do të elaborohen nocionet dhe kategoritë që përmban neni 6 i KEDNJ lidhur me procedurat civile dhe administrative; Kuadri i të drejtës për një proces të rregullt; nocioni “e drejta për qasje në gjykatë” dhe garancitë që ofrohen, si dhe Standardet dhe kërkesat lidhur me gjykimin në kohë të arsyeshme në procedurat civile.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zbërthejnë kuadrin e së drejtës për një proces të rregullt;
- Interpretojnë nocionin e drejta për qasje në gjykatë dhe provizionet që ofron kjo;
- Zbatojnë drejtë standardet dhe kërkesat lidhur me gjykimin në kohë të arsyeshme në procedurat civile.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Nocionet dhe kategoritë që përmban neni 6 i KEDNJ lidhur me procedurat civile dhe administrative;
- ✓ Kuadri i së drejtës për një proces të rregullt;
- ✓ Nocioni “e drejta për qasje në gjykatë” dhe garancitë që ofrohen;
- ✓ Standardet dhe kërkesat lidhur me gjykimin në kohë të arsyeshme në procedurat civile.

Metodologjia e trajnimit

Ndër metodat kryesore që do të përdoren gjatë këtij trajnimi do të jenë: shpjegime të pjesshme teorike dhe raste nga praktika gjyqësore; diskutime interaktive në grupe të ndara, të cilët do të mbrojnë dhe argumentojnë qëndrime të ndryshme dhe analizë të rasteve gjyqësore nga GJEDNJ. Gjithashtu, në këtë trajnim synohet arritja e një pjesëmarrjeje aktive të përfituesve, në mënyrë që edhe ata të kontribuojnë në realizimin e objektivave të trajnimit.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët dhe prokurorët të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës dhe bashkëpunëtorët profesional. Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

59. Zbatimi gjyqësor i KEDNJ dhe efektet e nenit 53 dhe 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në praktikën gjyqësore në Kosovë

Siç e dijmë, në Kosovë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ) është e inkuorporuar si pjesë e së drejtës së brendshme. Qëllimi i trajtimit të kësaj teme është që gjyqtarët të avancojnë njohuritë e tyre lidhur me mënyrën e adoptimit të KEDNJ në sistemin kushtetues të Kosovës dhe refleksionet e saja në këtë sistem. Republika e Kosovës është në situatë specifike, kur bëjmë fjalë për bazat e zbatimit të Konventës evropiane në territorin e saj.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Kuptojnë efektin e KEDNJ në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe sistemin e saj kushtetues dhe rolin e praktikës së GJEDNJ;
- Nihen me rolin dhe rëndësinë e Nenit 22 dhe 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në praktikën gjyqësore në Kosovë;
- Zbatojnë drejtë dispozitat e KEDNJ në praktikën gjyqësore në Republikën e Kosovës;
- Njohin dhe zërthejnë obligimet nga Konventa evropiane për shtetet anëtare dhe ato që e zbatojnë atë.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Efekti i KEDNJ në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe sistemin e saj kushtetues;
- ✓ Nenit 22 dhe 53 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës në praktikën gjyqësore në Kosovë;
- ✓ Interpretimi i KEDNJ dhe zbatimi i saj gjyqësor;
- ✓ Obligimet nga Konventa evropiane për shtetet anëtare dhe ato që zbatojnë atë.

Metodologjia e trajnimit

Gjate trajnimit do të përdoret metodologji e kombinuar me shpjegime të pjesshme teorike dhe raste nga praktika gjyqësore; si dhe diskutime interaktive në grupe të ndara.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët e gjykatave themelore, të Gjykatës së Apelit, prokurorë dhe bashkëpunëtor profesional. Trajnim do të zgjasë një (1) ditë.

60. E drejta në mjetin juridik efektiv - Neni 13 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore

Qëllimi i këtij trajnimi është avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me të drejtën në mjetin juridik efektiv. Arsye tjetër shtesë për trajtim të kësaj tematike është shpjegimi i mënyrave mbi zgjidhjen efektive para një autoriteti kombëtar pavarësisht nga fakti që shkelja është kryer nga persona që veprojnë në kapacitet zyrtar. Fokusi do të jetë edhe në zbërthimin e nocioneve dhe kategorive që përmban neni 13 si dhe mënyrën e interpretimit që e bën Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në Strasburg.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Analizojnë rolin mbi të drejtën e një ankimi efektiv para një instance kombëtare;
- Zbatojnë drejtë dispozitat mbi efektivitetin e zgjidhjeve në kuptimin e nenit 13 të KEDNJ;
- Evitajnë dilemat mbi nocionin “I debatueshëm” në kontekst të nenit 13 të KEDNJ dhe praktikës së GJEDNJ.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Nocionet themelore që përmban neni 13 i KEDNJ;
- ✓ Roli për të drejtën e një ankimi efektiv para një instance kombëtare;
- ✓ Efektiviteti i zgjidhjeve në kuptimin e nenit 13 të KEDNJ;
- ✓ Dilemat mbi nocionin “I debatueshëm” në kontekst të nenit 13 të KEDNJ dhe praktikës së GJEDNJ.

Metodologjia e trajnimit

Ndër metodat kryesore që do të përdoren gjatë këtij trajnimi do të jenë: shpjegime të pjesshme teorike dhe raste nga praktika gjyqësore; diskutime interaktive në grupe të ndara të pjesëmarrësve të cilët do të mbrojnë dhe argumentojnë qëndrime të ndryshme dhe do të bëjnë analizë të rasteve gjyqësore nga GJEDNJ. Gjithashtu në këtë trajnim synohet arritja e një pjesëmarrjeje aktive të përfituesve, në mënyrë që edhe ata të kontribuojnë në realizimin e objektivave të trajnimit.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët dhe prokurorët të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës dhe bashkëpunëtorët profesional. Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

E Drejta e Bashkimit Evropian

61. E Drejta e Bashkimit Evropian

Ky trajnim ka për qëllim avancimin e njohurive mbi të drejtën e Bashkimit Evropian, efektin e saj dhe zbatimin e saj nga ana e shteteve nacionale para anëtarësimit në BE. Ky modul i arsimit është i koncipuar që të mbulojë nevojat arsimore të gjyqtarëve dhe prokurorëve nga lëmia e vlerave juridike të Bashkimit Evropian. Gjithashtu, me këtë ofrohen shpjegime profesionale dhe analiza të marrëdhënieve në mes sistemeve juridike të shteteve anëtare dhe të drejtës evropiane, Standardeve të përgjithshme evropiane në çështjet ekonomike - buxhetore dhe obligimet e shteteve anëtare dhe atyre që janë candidate' Njohja me vendimet e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian dhe autorizimet e saja; dhe Njohja me Traktatin e Lisbonës si dhe me parimet e Kopenhagës të cilat kanë të bëjnë me shtetet candidate.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Analizojnë efektin e së drejtës evropiane në nivel nacional (efekti i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë);
- Njohin traktatin e Lisbonës dhe rëndësinë e tij;
- Zbatojnë drejtë legjislacionin e BE-së në nivel nacional;
- Zbërthejnë raste praktike të zbatimit të së drejtës së BE-së nga ana e gjykatave të një shteti anëtar të BE-së.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Efekti dhe zbatimi i së drejtës evropiane në nivel nacional;
- ✓ Traktati i Lisbonës dhe rëndësia e tij;
- ✓ Zbatimi së drejtës së BE-së nga ana e gjykatave nacionale – përvojat;
- ✓ Harmonizimi i të drejtës nacionale me atë evropiane, vëllimi dhe kufijtë e interpretimit gjyqësor në periudhën para anëtarësimit dhe vështirësitë;
- ✓ Raste praktike të zbatimit të së drejtës së BE-së nga ana e gjykatave të një shteti anëtar të BE-së.

Metodologjia e trajnimit

Ndër metodat kryesore që do të përdoren gjatë këtij trajnimi do të jenë: shpjegime të pjesshme teorike dhe raste nga praktika gjyqësore; diskutime interaktive në grupe të ndara, të cilët do të mbrojnë dhe argumentojnë qëndrime të ndryshme dhe do të bëjnë analizë të rasteve gjyqësore. Gjithashtu, në këtë trajnim synohet arritja e një pjesëmarrjeje aktive të përfituesve, në mënyrë që edhe ata të kontribuojnë në realizimin e objektivave të trajnimit.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës. Trajnimi do të zgjasë dy (2) ditë.

62. E Drejta Ekologjike e BE-së - Konventa e Arhusit, Rregulloret, direktivat, dhe aktet tjera juridike të BE -së

Konventa e UNECE (KEEOKB-Komisioni Ekonomik për Evropën i OKB-së) lidhur me të drejtën në informacion, pjesëmarrje të publikut në vendimmarrje dhe qasjes në drejtësi në çështje mjedisore, vendos një sërë të drejtash për publikun dhe detyrime për autoritetet shtetërore për të fuqizuar demokracinë mjedisore. Konventa përmban tri shtylla themelore: 1. E drejta e publikut për të pasur e për të kërkuar informacion mjedisor; 2. E drejta e publikut për të marrë pjesë në vendimmarrjet publike për çështje të mjedisit; 3. E drejta e publikut për t'u ankuar në gjykatë për çështje të mjedisit. Ndonëse Kosova nuk është palë e Konventës së Arhusit, nga të dhënat e mbledhura rezulton se zbatimi gjyqësor i kësaj Konvente në trajtimin e kontesteve administrative dhe civile është ende i mangët. Rrjedhimisht, gjyqtarët por edhe prokurorët kanë nevojë të konsiderueshme që t'i thellojnë njohuritë e tyre rreth zbatimit të kësaj Konvente.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Avancojnë njohuritë mbi të drejtën ekologjike të Bashkimit Evropian;
- Analizojnë përgjegjësinë penale për ndotjen e ambientit.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Qasja në informacion mjedisor;
- ✓ Qasja në drejtësi mjedisore;
- ✓ Përgjegjësia penale në fushën e mjedisit;
- ✓ Pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje.

Metodologjia e trajnimit

Rast studimor dhe ligjërime të shkurtër.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët e Departamentit për çështje Ekonomike të Gjykatës Themelore në Prishtinë, gjyqtarët e Divizionit për Kundërvajtje, gjyqtarët e Departamentit për çështje administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë, prokurorët dhe bashkëpunëtorët profesional. Trajnim do të zgjasë një (1) ditë.

E Drejta Kushtetuese

63. Praktika aktuale e Gjykatës Kushtetuese sipas kërkesave-ankesave në lëminë civile

Qëllimi kryesor i këtij trajnimi është prezantimi dhe njohja me praktikën aktuale të kësaj gjykate sipas kërkesave-ankesave në lëminë civile. Njashtu, synim i këtij trajnimi është edhe avancimi i njohurive lidhur me lejueshmërinë e kërkesave, raportin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës me gjykatat e rregullta në kontekst të dispozitave kushtetuese, përvoja e kësaj gjykate sipas kërkesave-ankesave në lëminë civile, dhe rolin e kontrollit incidental të kushtetutshmërisë.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zbërthejnë procedurën e lejueshmërisë së kërkesave;
- Dallojnë raportin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës me gjykatat e rregullta në kontekst të dispozitave kushtetuese;
- Njohin praktikën aktuale të Gjykatës Kushtetuese sipas kërkesave-ankesave në lëminë civile;
- Zbërthejnë dhe kuptojnë rolin e kontrollit incidental të kushtetutshmërisë.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Lejueshmëria e Kërkesave;
- ✓ Raporti i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës me gjykatat e rregullta në kontekst të dispozitave kushtetuese;
- ✓ Praktika aktuale e Gjykatës Kushtetuese sipas kërkesave-ankesave në lëminë civile;
- ✓ Kontrolli incidental i kushtetutshmërisë.

Metodologjia e trajnimit

Trajnimi do të realizohet në formë të bashkëbisedimit interaktiv dhe shpjegimeve të trajnuesve që do t'i thellojnë njohuritë e pjesëmarrësve lidhur me çështjet e ndryshme nga praktika gjyqësore aktuale e kësaj gjykate sipas kërkesave-ankesave në lëminë civile, si dhe mbi rolin e kontrollit incidental të kushtetutshmërisë.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët e të gjitha niveleve dhe gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese. Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

64. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe efektet juridike të tyre

Qëllimi i organizimit të këtij trajnimi është thëllimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me vendimet e Gjykatës Kushtetuese, efektet juridike, llojet e tyre si dhe zbatimin e tyre në praktikë. Në praktikën e Gjykatës Kushtetuese dallohen disa lloj vendimesh në varësi nga qëndrimi që ato mbajnë ndaj normave që kontrollojnë. Roli i Gjykatës Kushtetuese qëndron pikërisht në fuqinë e vendimeve të saja. Vendimet e gjykatave kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës andaj edhe shtrohet nevoja e trajtimit të tyre të gjithanshëm. Realizimi dhe zbatimi praktik i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është një çështje me rëndësi të veçantë që kërkon trajtim të gjithanshëm.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Njohin rolin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese;
- Zbërthejnë efektet juridike të cilat prodhojnë vendimet në fjalë;
- Interpretojnë drejtë natyrën juridike dhe detyrueshmërinë e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës;
- Dallojnë llojet e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese;
- Zbatojnë drejtë vendimet e Gjykatës Kushtetuese në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet në fuqi.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe llojet e tyre;
- ✓ Natyra juridike e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese;
- ✓ Efekti i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese;
- ✓ Vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe mënyra e përmbartimit të tyre.

Metodologjia e trajnimit

Trajnimi do të realizohet në formë të bashkëbisedimit interaktiv dhe shpjegimeve të trajnuesve që do t'i thellojnë njohuritë e pjesëmarrësve lidhur me çështjet e ndryshme nga praktika gjyqësore aktuale e kësaj gjykate sipas kërkesave-ankesave në lëminë civile, dhe mbi rolin e kontrollit incidental të kushtetutshmërisë.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët e të gjitha niveleve dhe gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese. Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

Kundërvajtje

65. Procedura kundërvajtësve sipas kërkesës se inspektoreve

Gjatë punës gjyqtarët hasin në shumë paqartësi lidhur me kërkesat për zhvillimin e procedurës së kundërvajtjes të paraqitura nga inspektoratet e lëmive të ndryshme. Si pasojë e kësaj paqartësie, gjyqtarët e kundërvajtjes pos që zhvillojnë procedurën me kërkesë e cila është e paqartë dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore, nxjerrin edhe verdikt të gabuar dhe jo ligjor, dhe në procedurat ankimore këto çështje po anulohen. Në raste të shumta kërkesat e inspektorateve paraqiten ndaj personave juridik dhe jo edhe ndaj personit përgjegjës të personit juridik, paraqiten ndaj subjektit afarist përgjegjësia e të cilit është individuale, por në kërkesë akuzohet edhe pronari i subjektit afarist. Gjithashtu problem permanent i këtyre kërkesave është edhe cilësimi juridik i veprimeve kundërvajtëse dhe dispozitat sanksionuese, sepse aplikohen dispozita ligjore të parapara në disa ligje, ose plotësim-ndryshim të ligjeve. Dhe kështu po krijohet paqartësi në aplikimin ligjor të dispozitave përkatëse të ligjit. Është mëse e rëndësishme që pas pranimit të një kërkesë të tillë për fillimin e procedurës së kundërvajtjes, para nxjerrjes së vendimit për fillimin e procedurës kundërvajtëse gjyqtari të jetë në gjendje ta vlerësoj ligjshmërinë e kërkesës, dhe pas zhvillimit të procedurës të vërtetoj konkretisht se cilat janë ato veprime që paraqesin kundërvajtje, dispozitat ligjore sipas të cilave përcaktohet kundërvajtja dhe dispozitat sanksionuese.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zbatojnë drejtë procedurën e kundërvajtjes, të nxjerrin aktgjykim ligjor duke i aplikuar drejtë dispozitat ligjore;
- Përpilojnë një kërkesë ligjore për zhvillimin e procedurës së kundërvajtjes;
- Zbatojnë drejtë procedurat në rastet kur kërkesa nuk është e përpiluar komfor ligjit;

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Përmbajtja e kërkesës sipas nenit 87 të LK,- e paraqitur nga organet kompetente-inspektorët;
- ✓ Përshkrimi faktik i veprimeve nga të cilat rezultojnë tiparet juridike të kundërvajtjes;
- ✓ Cilësimi juridik i kundërvajtjes;
- ✓ Vendimi për fillim të procedurës- kushtet.

Metodologjia e trajnimit

Për realizimin e këtij trajnimi do të përdoren metodat e kombinuara: shpjegimi i shkurtë teorik, diskutimet interaktive, prezantime në PowerPoint, pyetje e përgjigje, të përcjellura me shembuj praktik, si dhe analizimi i përbashkët i problemeve rreth aplikimit të këtyre dispozitave në praktikë, në mënyrë që secili nga pjesëmarrësit të jetë aktiv gjatë gjithë kohës së trajnimit.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Përfitues të trajnimit do të jenë gjyqtarët e gjykatave themelore-divizioni i kundërvajtjes dhe inspektorët e Drejtorive të Inspektorateve. Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

66. Kompetenca Lëndore dhe territoriale sipas Ligjit për Kundërvajtje

Kryerësit e veprave të kundërvajtjes pos që gjykohen në gjykata - gjyqtari i vetëm gjykues në gjykatën e shkallës së parë dhe kolegji i përberë nga tre gjyqtar në gjykatën e shkallës së dytë, për disa kundërvajtje të përcaktuara me ligj apo rregullore të Kuvendit të Komunës, procedura e kundërvajtjes mund të zhvillohet, dhe sanksionin kundërvajtës mund ta shqiptoj edhe organi i administratës shtetërore ose organi i cili kryen autorizime publike - organi për kundërvajtje të mbikëqyrjes për zbatimin e ligjit, në të cilin janë paraparë kundërvajtje. Organi kundërvajtës zhvillon procedurën e kundërvajtjes, nëse me ligj është paraparë kompetenca ekskluzive për veprimin e saj por përjashtimisht organi për kundërvajtje është kompetent që të veproj sipas të gjitha kundërvajtjeve për të cilat është paraparë sanksioni i gjobës në shumën e caktuar, për të cilat është paraparë shqiptimi i gjobës në vend. Në praktikën gjyqësore, janë paraqitur dilema të çështjeve lidhur me kompetencën e gjykatave ose të organit për kundërvajtje dhe atë kryesisht për kundërvajtjet nga lëmia e rendit dhe qetësisë publike, komunikacionit dhe nga lëmia ekonomike.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Identifikojnë rastet në kompetencën gjyqësore dhe atë të organit kundërvajtës;
- Zbatojnë drejtë dispozitat ligjore, LRQP, LRRTRR dhe Ligjet nga lëmia ekonomike.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Kompetenca lëndore;
- ✓ Kompetenca e gjyqtarit individual;
- ✓ Kompetenca e organit kundërvajtës;
- ✓ Konflikti i kompetencave;
- ✓ Procedurat.

Metodologjia e trajnimit

Për realizimin e këtij trajnimi do të përdoren metodat e kombinuara si shpjegimi i shkurtë teorik, diskutimet interaktive, prezantime në PowerPoint, pyetje e përgjigje, të përcjellura me shembuj praktik, si dhe analizimi i përbashkët i problemeve rreth aplikimit të këtyre dispozitave në praktikë, në mënyrë që secili nga pjesëmarrësit të jetë aktiv gjatë gjithë kohës së trajnimit.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Përfitues të trajnimit do të jenë gjyqtarët e gjykatave themelore-divizioni i kundërvajtjes, gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe përfaqësuesit e organit kundërvajtës. Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

Kompetenca Interdisciplinare

67. Menaxhimi i Stresit

Thuaj se është e pamundur të mendohet jeta e përditshme në “botën moderne“ pa stresin si pjesë e pandashme e saj. Stresi është tërësi e reagimeve emocionale, trupore dhe të sjelljes ndaj atyre kërkesave, sfidave dhe ngarkesave të cilave individit u nënshtrohet në rrethana të ndryshme të punës e jetës. Në përgjithësi, stresi është pasojë dhe tregues i një “ngulfatje” të jetës shpirtërore në nivelin e dominimit të tehnosferës ndaj socio sferës. Prezenca e shpeshtë e stresit në përditshmërinë e individit shkakton demotivimin, redukton produktivitetin, dobëson performancën, shkakton probleme mentale fizike, ndryshon sjelljen e individit etj.

Menaxhimi i mirë i kohës dhe prioritizimi i nevojave janë disa nga predispozitat e menaxhimit të mirë dhe mbajtjes nën kontroll të vazhdueshëm të stresit si parakusht i ruajtjes së shëndetit dhe mirëqenies së individit. Shumë njohës të kësaj problematike preferojnë vendosjen e kufijve si teknikë e parandalimit të efektit negativ të stresit. Vendosja e kufijve material dhe formal, si dhe përmbajtja e kufijve emocional, janë elementet e përmbajtjes së kësaj teknike. Edhe identifikimi i nevojave është një predispozitë e nevojshme në menaxhimin e stresit.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Njohin karakteristikat dhe veçoritë dalluese të personaliteteve të cilat do të jenë në raport me ta në cilësi të ndryshme;
- Dallojnë elementet dhe faktorët influentues pozitiv dhe ata degjenerues negativ në socium dhe në ambientin e punës;
- Identifikojnë faktorët determinues të individit në sjellje devijante dhe kundërligjore;
- Mësojnë mënyrat më të mira të tejkalimit të situatave stresuese;
- Zhvillojnë shkathtësi mbi menaxhimin e mirë të kohës dhe stresit;

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Faktorët e stresit;
- ✓ Llojet e stresit;
- ✓ Shenjat dhe simptomat paralajmëruese të stresit;
- ✓ Stresi në punë;
- ✓ Administrimi i kohës

Metodologjia e trajnimit

Vijuesit do ta kenë një ushtrim lidhur mbi prioritetet e aktiviteteve, interferimi i anekdotës së profesorit të filozofisë dhe dy paqe tave me kafe.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarë dhe prokurorë nga gjitha nivelet. Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

68. Menaxhimi i rasteve

Zbatimi i teknikave të menaxhimit të rasteve nga gjyqtarët dhe prokurorët në krahasim me menaxhimin e fluksit të rasteve me të cilat merren gjykatat dhe prokuroritë, paraqesin sfida të cilat janë mjaft problematike në punën e përditshme. Ndikim në këtë problem kanë edhe ndryshimet në strukturën organizative që janë bërë në gjykata dhe prokurori e të cilat do të kenë një efekt pozitiv në përmirësimin e menaxhimit të rasteve.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zbatojnë parimet e menaxhimit të rasteve;
- Zbatojnë njohuritë në menaxhimin e rasteve;
- Aplikojnë teknikat e menaxhimit të rasteve.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Menaxhimi i rasteve;
- ✓ Parimet themelore të menaxhimit të rasteve;
- ✓ Teknikat kryesore të menaxhimit të rasteve;
- ✓ Përdorimi efektiv i SMIL në menaxhim të rasteve.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë trajnimit do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, shpjegime teorike dhe praktike, punë në grupe, të përcjella me shembuj praktik, prezantim në PowerPoint.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor. Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

69. Arsyetimi i vendimeve gjyqësore

Trajnimi për shkrimin dhe arsyetimin ligjor ka për qëllim të ndihmoj gjyqtarët, bashkëpunëtorët dhe zyrtarët ligjor në ngritjen e kapaciteteve të tyre profesionale lidhur me hulumtimin ligjor, shqyrtimin gjyqësor dhe hartimin e vendimeve gjyqësore. Ky trajnim do zhvillohet në një ambient interaktiv diskutimi në mënyrë që drejtpërdrejtë të ndihmohet në zhvillimin e aftësive analitike tek pjesëmarrësit duke trajtuar mënyrën se si duhet t'i qasemi një çështjeje juridike, si duhet të realizohet hulumtimi i resurseve për çështjen që është objekt shqyrtimi, si duhet të realizohet analiza ligjore dhe sipas cilave standarde duhet të bëhet shkrimi dhe arsyetimi ligjor. Përveç udhëzimeve teorike lidhur me parimet dhe metodat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor, pjesë e këtij trajnimi do të jenë edhe rastet dhe udhëzimet praktike në mënyrë që pjesëmarrësit njohuritë e fituara të mund t'i aplikojnë në praktikë. Përmes udhëzimeve dhe rasteve konkrete nga fusha civile dhe penale, pjesëmarrësit do të kenë mundësi që duke zbatuar kërkesat e ligjeve nga procedura penale dhe civile të japin konkluzionet e tyre për vendosjen e çështjeve që trajtojnë. Përveç tjerave, ky modul ofrohet ngase është identifikuar nevoja e juristëve në përgjithësi por veçanërisht e gjyqtarëve, bashkëpunëtorëve dhe zyrtarëve ligjor për ngritje të kapaciteteve profesionale në fushën e shkrimit dhe arsyetimit ligjor. Shkrimi dhe arsyetimi ligjor paraqet standard vlerësimi të punës së gjykatave. Në këtë kuptim, shkrimi dhe arsyetimi ligjor në punën e gjyqtarëve, bashkëpunëtorëve dhe zyrtarëve e përfaqëson një objektiv jo lehtë të arritshëm, prandaj përmes këtij trajnimi synohet të përmirësohet cilësia e shkrimit dhe arsyetimit ligjor në punën e tyre.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Njohin rregullat bazë të shkrimit të akteve dhe dokumenteve ligjore;
- Krijojnë ide të qarta për mënyrën e arsyetimit të akteve dhe dokumenteve ligjore;
- Zhvillojnë shkathtësitë e arsyetimit dhe shkrimit ligjor;
- Përpilojnë aktet ligjore dhe ti arsyetojnë sipas metodave më bashkëkohore të arsyetimit dhe shkrimit ligjor;
- Përdorin aftësitë interpretuese dhe zhvillojnë mendimin kritik, si dhe demonstrojnë aftësitë hulumtuese për çështjet ligjore.

Përmbajta e modulit të trajnimit

- ✓ Llojet e arsyetimit ligjor;
- ✓ Parimet e shkrimit të mirë ligjor;
- ✓ Kërkesat ligjore për shkrimin dhe arsyetimin e vendimeve gjyqësore;
- ✓ Zbatimi i metodës IRAC të vendimet penale.

Metodologjia trajnuese

Trajtimi teorik i elementeve të shkrimit, mënyrës së formularit të akteve ligjore, interpretimit të akteve, analizës së fakteve, i hartimit të akteve kryesore procedurale. Diskutim teorik lidhur me dispozitat ligjore procedurale që i referohen kërkesave ligjore për shkrimin e akteve ligjore. Demonstrim praktik i mënyrës së arsyetimit dhe shkrimit ligjor. Diskutim teorik dhe praktik për metodat e analizës ligjore në rastet konkrete. Prezantim i rasteve civile dhe penale dhe diskutime për mënyrën e vendosjes së supozuar meritore për rastet konkrete. Një rëndësi të veçantë në organizimin dhe ndërtimin e këtij trajnimi do të kenë ushtrimet praktike për të nxitur pjesëmarrjen aktive të pjesëmarrësve. Për demonstrimin e çështjeve kryesisht përdoret forma interaktive me qëllim që të arrihet që të gjithë pjesëmarrësit të jenë aktiv gjatë gjithë kohës duke e dhënë kontributin e tyre më parashtrimin e pyetjeve, ofrimin e zgjidhjeve dhe me sygjerimet e tyre. Pjesëmarrësit përveç kontributit të tyre në diskutime sfidojnë edhe idetë e trajnuesit lidhur me shtruarjen dhe zgjidhjen e shumë çështjeve alternative apo edhe problematike.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët e Gjykatave Themelore. Trajnim do të zgjasë një (1) ditë.

Trajnimet nga fusha e mbrojtjes ndaj
diskriminimit

70. Aspekti material dhe procedural i ligjit për mbrojtje nga diskriminimi dhe sfidat në zbatimin e tij

Në aspektin procedural Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, shprehë qëllimin e qartë të ligjvënësist për të siguruar mjete juridike për çështjet e diskriminimit përmes të gjitha rrugëve të mundshme ligjore, përfshirë organet administrative, gjykatat, hetimet penale, prokuroritë, si dhe mekanizmat e ndërmjetësimit. Pretendimin e bazuar në bazat e diskriminimit si të parapara me LMnD-në dhe sipas legjislacionit në fuqi, mund ta paraqesë çdo person ose grup personash (kushtëzuar) të cilët pretendojnë se janë diskriminuar. LMnD shpreh qartazi tiparet e veçanta procedurale në rastet që trajtojnë diskriminimin si: afatin për paraqitjen e kërkesës nga pala që pretendon se është diskriminuar, urgjenca në trajtim të rasteve të diskriminimit, llogaridhënia, provat dhe metodat e ligjshme (përfshirë, por pa u kufizuar në të dhëna statistikore) që mund të dëshmojnë sjellje diskriminuese, barrën e provës e cila bie mbi të paditurin, si dhe llojet e masave, sanksioneve dhe dëmshpërblimit, kjo edhe kur LMnD zbatohet në ndërthurje me ligjet përkatëse procedurale. LMnD-ja si një ligj themelor kundër diskriminimit, vlen për të gjitha veprimet ose mosveprimet e të gjitha institucioneve shtetërore dhe lokale, personave fizik dhe juridik, sektorit publik dhe privat, të cilët shkelin ose mund të shkelin të drejtat e ndonjë personi (fizik dhe juridik) të parashikuara me legjislacionin në fuqi. Duke i pasë parsysh tiparet e lartcekura padyshim del se LMnD është një ligj me qëllim dhe fushëveprim të gjerë. Andaj, edhe pse për zbatimin e drejtë të saj kërkohet shkathtësi analitike e hulumtuese, si dhe njohuri e thukët e legjislacionit vendor dhe instrumenteve ndërkombëtare dhe mekanizmave të tyre, gjithsesi ka hapësirë për interpretime të ndryshme që jo rrallë paraqesin dilema për profesionistët.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Identifikojnë elementet thelbësore të secilës formë të diskriminimit;
- Identifikojnë tiparet thelbësore procedurale në trajtimin e rasteve të diskriminimit;
- Zbatojnë në mënyrë të drejtë dispozitat procedurale në trajtimin e rasteve të diskriminimit;
- Ballafaqohen me sfidat në zbatimin e dispozitave ligjore në rastet e diskriminimit;
- Zbatojnë në mënyrë unike dispozitat e LMnD.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Bazat dhe format e manifestimit të diskriminimit sipas LMnD;
- ✓ Mënyrat e zbatimit të aspekteve procedurale të LMnD në ndërthurje me ligjet përkatëse procedurale;
- ✓ Llojet e masave, dëmshpërblimi dhe sanksionet që mund të shqiptohen ndaj atyre që diskriminojnë;
- ✓ Sfidat e zbatimit të LMnD;
- ✓ Zbatimi i LMnD në ndërthurje me ligjet tjera.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij trajnimi do të përdoret metodologji e kombinuar, ku përveç prezantimeve në PowerPoint, që do të ndërthejnë dispozitat ligjore të përcjella me shembuj nga praktika gjyqësore të cilat pasqyrojnë mënyrat e ndërveprimit, po ashtu do të aplikohen edhe metodat ndërvepruese të diskutimit me pjesëmarrësit.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët nga Departamenti Civil dhe Administrativ, Bashkëpunëtorët Profesional të nivelit të Supremes, Apelit dhe nivelit Themelor, si dhe avokatët, përfshirë avokatët e Ndihmës Juridike Falas, zyrtarë të qeverisë qendrore dhe komunave, si dhe përfaqësues të IAP dhe të organizatave jo-qeveritare që merren me këtë fushë. Trajnimi do të zgjasë dy (2) ditë.

71. KEDNJ në rastet e diskriminimit përfshirë edhe Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi i Republikës së Kosovës dhe raporti i tij me ligjet e tjera me theks në Ligjin e Punës dhe Ligjin e Procedurës Kontestimore

Konventa Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Liritë Themelore (KEDNJ) në nenin 14, respektivisht me Protokollin e 12, mbron nga diskriminimi i çfarëdo të drejte të parashikuar me ligj dhe nga çdo autoritet publik duke ofruar kështu fushëveprim më të gjerë se sa neni 14, që ndërlidhet vetëm me të drejtën e garantuar nga KEDNJ. Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka bërë pjesë të pandashme të rendit juridik të vendit instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut ndër të cilat është edhe KEDNJ. Më tej, mos diskriminimi, trajtimi i barabartë dhe klauzolat e mos diskriminimit përfshihen edhe në ligje të shumta në Kosovë, veçanërisht në Ligjin për mbrojtje nga diskriminimi. Ka raste kur ligjet tjera i referohen Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi, ndërsa ka të tjerë që numërojnë bazat e mbrojtura të cilat shpesh ndryshojnë nga bazat e mbrojtura të përfshira në Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi. Për më tepër, Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ofron veçantitë procedurale në trajtimin e lëndëve të diskriminimit që gjithsesi prekin procedurat e parapara me ligjet tjera, në veçanti Ligjin për Procedurën Kontestimore dhe Ligjin e Punës.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Interpretojnë drejtë dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me diskriminimin;
- Njohin kompleksitetet praktike në situatat ku ndërveprojnë ligjet në rastet e diskriminimit;
- Analizojnë trajtimin e rasteve të diskriminimit në procedurën kontestimore, përfshirë këtu në trajtimin e kontesteve të punës me elemente diskriminimi; si dhe
- Përafrojnë qëndrimet në zbatimin unik të dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me diskriminimin.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Neni 14 dhe Protokoli 12 i KEDNJ-së;
- ✓ Praktika e GJEDNJ-së lidhur me mbrojtjen nga diskriminimi;
- ✓ Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi dhe bashkëveprimi me Ligjin e Procedurës kontestimore dhe Ligjin e punës;
- ✓ Raste nga praktika gjyqësore.

Metodologjia e trajnimit

Do të jetë e kombinuar, ku përveç prezantimit të shkurtër lidhur me vështrimet profesionale dhe praktike, do të aplikohet metoda interaktive të diskutimit me pjesëmarrësit. Gjithashtu, pjesëmarrësve do t'ju ofrohen raste nga praktika gjyqësore si vendore ashtu edhe nga praktika e GJEDNJ-së, për të diskutuar në grupe dhe nga ta do të kërkohet që t'i paraqesin pikëpamjet e tyre në lidhje me zgjidhjen e problemeve dhe dilemave në situata të caktuara.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët nga departamenti civil, penal dhe administrativ të nivelit të supremes, apelit dhe nivelit themelor, prokurorët, bashkëpunëtorët profesional si dhe avokatë. Trajnimi do të zgjasë dy (2) ditë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme

72. Definimi i statusit juridik të shoqërive aksionare - ndërmarrjeve shoqërore

Në kuadër të këtij moduli do të trajnimit do të trajtohet hierarkia ligjore e ndërmarrjeve shoqërore (pakoja e ligjeve të Ante Markoviçit lidhur me Ndërmarrjet) me të cilat është rregulluar procesi i transformimit të Ndërmarrjeve Shoqërore. Nëse ndërmarrja i është nënshtruar transformimit, a do të ndikoj transformimi në të drejtat dhe kompetencat ekskluzive të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP). Po ashtu, do të trajtohet nëse transformimi është bazuar dhe kryer në përputhje të plotë me ligjin, si dhe a janë përmbushur të gjitha obligimet që ndërlidhen me transformimin, qofshin ato që kanë dalur gjatë apo pas transformimit. Gjithashtu, do të trajtohet nëse transformimi nuk ka qenë diskriminues dhe nuk ka shkelur parimet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Po ashtu, do të ketë edhe raste nga praktika e dhoma e posaçme lidhur me çështjen e statusit të disa ndërmarrjeve shoqërore.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Identifikojnë drejtë se kush mund të konsiderohet Shoqëri aksionare;
- Kuptojnë se cilat kushte–kriter është dashur të plotësohen që një ndërmarrje shoqërore të transformohet në shoqëri aksionare;
- Vlerësojnë rastet kur një ndërmarrje shoqërore e ka përfunduar në tërësi transformimin konform kushteve dhe ligjeve të kohës;
- Njohin nëse një transformim i tillë nuk ka pasur qëllime diskriminuese dhe nuk janë shkelur parimet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Zbërthimi i ligjeve të pakos së Ante Markoviçit;
- ✓ Plotësimi apo mos plotësimi i kushteve ligjore për transformimin e ndërmarrjeve nga një ndërmarrjeve shoqërore në shoqëri aksionare;
- ✓ Identifikimi i ekzistimit të diskriminimit apo mos diskriminimit gjatë procesit të transformimit.

Metodologjia e trajnimit

Diskutime interaktive me pjesëmarrësit në formë të tryezës, raste praktike gjyqësore dhe shtjellimi i tyre me PowerPoint.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët e Dhomës së Posaçme, gjyqtarët e gjykatave tjera, bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtar ligjor të gjykatës. Trajnimi do të zgjasë dy (2) ditë.

73. Përputhshmëria e procesit dhe rregullave të tenderit me ligjin e AKP-së dhe ligjeve tjera

AKP duke u bazuar në rregullat e përgjithshme të tenderit dhe bazuar në Ligjin e AKP-së bënë publikimin e shitjeve të aseteve të ndërmarrjeve shoqërore. Në bazë të këtyre rregullave AKP vendos për shitjen apo anulimin e kësaj shitje në procedurat e tenderimit. Nga ky proces lindin edhe konteste të shumta e të cilat zgjidhen në Dhomën e Posaçme. Dilemat lindin nëse AKP ka të drejtë të anuloj një apo disa herë shitjen e të njëjtit aset.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zbatojnë drejtë dispozitat ligjore dhe rregullat e tenderit gjatë procesit të privatizimit;
- Identifikojnë se cilët persona mund të jenë pjesëmarrës në tender;
- Vlerësojnë se rregullat e tenderit a janë transparente, a sigurojnë konkurrencë dhe a janë në përputhje me çmimin e tregut;
- Konstatojnë nëse Bordi i AKP-së kishte të drejtë në aprovimin apo anulimin e një shitjeje.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Dispozitat ligjore që zbatohen në procesin e shitjes, gjegjësisht tenderimit të aseteve;
- ✓ Diskrecioni i Bordit të AKP-së për anulimin e shitjeve të aseteve të ndërmarrjeve shoqërore;
- ✓ E drejta e palëve tenderuese për të kërkuar anulimin e këtyre shitjeve për të cilat ka dyshime se janë në kundërshtim me rregullat tenderuese.

Metodologjia e trajnimit

Trajnimi do të fokusohet në diskutime interaktive në formë të tryezës së rrumbullakët, raste praktike, shtjellimi i tyre, prezantimi me PowerPoint.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Përfitues të këtij trajnimi do të jenë gjyqtarët e Dhomës së posaçme, të gjykatave të ndryshme në Kosovë, si dhe bashkëpunëtorët e zyrtarët ligjor pranë këtyre gjykatave. Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

74. Procesi i likuidimit vullnetar të ndërmarrjeve shoqërore, shqyrtimi para Autoritetit të Likuidimit dhe trajtimi gjyqësor në Dhomën e Posaçme

Likuidimi vullnetar i aseteve të ndërmarrjeve shoqërore është në autoritetin ligjor të AKP-së përmes Autoritetit të Likuidimit të NSH-ve të caktuara nga AKP. Autoriteti i Likuidimit të AKP-së njofton gjykatën për fillimin e procesit të likuidimit dhe të gjitha procedurat gjyqësore lidhur me kërkesat që eventualisht ekzistojnë ndaj kësaj NSH-je, duhet të pezullohen. Autoriteti i Likuidimit i AKP-së i shqyrton të gjitha kërkesat që janë parashtruar brenda afatit ligjor para këtij autoriteti. Palët e pakënaqura parashtrojnë ankesë ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së në Dhomën e Posaçme dhe për këtë ankesë vendos shkalla e parë në Dhomën e Posaçme. Ndaj këtyre vendimeve të shkallës së parë të Dhomës së Posaçme mund të parashtrohen ankesa në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zbatojnë drejtë dispozitat ligjore dhe kuptojnë qartë se a janë të drejta ankesat/kërkesat që paraqiten në procedurë administrative para Autoritetit të Likuidimit të AKP-së e më vonë në procesin gjyqësor para Dhomës së Posaçme;
- Kuptojnë se cilat janë procedurat deri në Dhomën e Posaçme dhe cilat janë kushtet që duhet të plotësojë një kërkesë për tu konsideruar e pranueshme dhe e bazuar;
- Identifikojnë se cilat kërkesa që arrijnë në Dhomën e Posaçme duhet të pezullohen, cilat të hedhen poshtë si të pa pranueshme dhe cilat nuk duhet të pezullohen.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ E drejta e palëve në këtë procedurë që të kërkojnë mbrojtje që mund të konsiderohet si mbrojtje tri shkallëshe;
- ✓ Veprimet e DHP-së në të dyja shkallët lidhur me një kërkesë kreditore dhe pronësore e që është refuzuar nga Autoriteti i Likuidimit të AKP-së;
- ✓ Dispozitat ligjore që zbatohen në procesin e likuidimit vullnetar para Autoritetit të Likuidimit të AKP-së dhe para DHP-së;
- ✓ Cilat kërkesa nuk duhet të pezullohen domosdoshmërisht dhe arsyet se pse nuk duhet të pezullohen kërkesat e tilla.

Metodologjia e trajnimit

Trajnimi do të fokusohet në diskutime interaktive, raste praktike, shtjellimi i tyre, prezantimi me PowerPoint.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Përfitues të këtij trajnimi do të jenë gjyqtarët e Dhomës së posaçme, të gjykatave të ndryshme në Kosovë, si dhe bashkëpunëtorët e zyrtarët ligjor pranë këtyre gjykatave. Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

75. Trajtimi i kërkesave pronësore dhe kreditore

Kërkesat që pretendojnë një të drejtë, titull apo interes në lidhje me çfarëdo pasurie apo pronë mbi të cilën AKP apo AKM-ja ka apo ka shpallur autoritetin administrativ, pronësinë e një ndërmarrjeje apo korporate, pronësinë mbi kapitalin e një ndërmarrjeje apo korporate, ose çfarëdo prone apo pasurie në posedim apo kontroll të një ndërmarrjeje apo korporate, nëse një e drejtë, titull apo interes i tillë pohohet të ketë lindur gjatë apo para kohës kur ajo ndërmarrje apo korporatë i është nënshtruar autoritetit administrativ të AKM-së apo Agjencisë.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Interpretojnë drejtë ligjshmërinë e lidhjes së kontratave të shitblerjes, faljes dhe arondimit të lidhura ndërmjet viteve 1950/60;
- Identifikojnë rastet në lidhje me kompozimin apo zhdëmtimin e punëtorëve për shkak të lëndimeve në punë;
- Vlerësojnë vlefshmërinë e kontratave afariste të lidhura ndërmjet ndërmarrjeve dhe subjekteve tjera private;
- Dallojnë dhe vlerësojnë nëse duhet njohur kompensimin financiar nga marrëdhënia e punës së një punëtori me ndërmarrjet shoqërore;
- Avancojnë njohuritë praktike dhe jurisprudencën e Dhomës së Posaçme lidhur me trajtimin e rasteve që kanë të bëjnë me kërkesat pronësore dhe kreditore.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Trajtimi i kontratave të shitblerjes, faljes dhe arondimit lidhur me paluajtshmëritë;
- ✓ Lëndimet në punë dhe kompensimi i dëmit;
- ✓ Borxhet si rezultat i afarizmit ndërmjet vetë NSH-ve si dhe ndërmarrjeve private;
- ✓ Trajtimi i kërkesave që dalin nga kontestet nga marrëdhënia e punës;
- ✓ Praktika gjyqësore e Dhomës së Posaçme.

Metodologjia e trajnimit

Diskutime interaktive me pjesëmarrësit në formë të tryezës, raste praktike gjyqësore dhe shtjellimi i tyre me PowerPoint.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët e Dhomës së Posaçme, gjyqtarët e gjykatave tjera, bashkëpunëtor profesional dhe zyrtar ligjor të gjykatës. Trajnimi do të zgjasë dy (2) ditë.

76. Trajtimi i kërkesave të punëtorëve lidhur me të drejtën e tyre në realizimin e 20 % nga shitja Ndërmarrjeve shoqërore

Pas pranimit të listës së të punësuarve me të drejta legjitime në bazë të nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13, apo në bazë të çfarëdo legjislacioni pasues që rregullon krijimin e një liste të tillë, Agjencia shpall listën së bashku me njoftimin për qytetarët mbi të drejtat e personit për të parashtruar një ankesë në Agjenci brenda njëzetë (20) ditëve pas datës së shpalljes. Personi i cili parashtron një kërkesë apo kundërshtim të tillë, do të përfshijë aty në deklaratë të fakteve dhe argumenteve ligjore që mbështesin kërkesën apo kundërshtimin e tillë. Agjencia mund të kërkojë nga parashtruesi që të sigurojë prova shtesë dhe/apo informata që janë të nevojshme. Agjencia shpall zyrtarisht listën përfundimtare të të punësuarve me të drejta legjitime. Punëtorët e pakënaqur me listën përfundimtare, pavarësisht nëse është ankuar ndaj listës preliminare apo jo, ka të drejtë të dorëzojë ankesën me shkrim pranë Dhomës së Posaçme para skadimit të afatit kohor prej njëzet (20) ditësh. Pastaj gjykata është ajo e cila shqyrton kërkesat/ankesat e punëtorëve nëse i plotësojnë kriteret përkatëse për tu futur në listën përfundimtare për marrjen e 20% nga shitja e Ndërmarrjes Shoqërore (N.SH).

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Kuptojnë se cilat kritere duhet plotësuar punëtorët për të marrë pjesë në shpërndarjen e 20% e të ardhurave nga shitja e N.SH-së;
- Vlerësojnë se cilat janë procedurat dhe afatet ligjore që duhet ndjekur para Agjencisë dhe Gjykatës;
- Identifikojnë drejtë rastet kur një punëtor duhet apo nuk duhet të futet në listën përfundimtare të përfituesve me të drejta në 20%.
- Njohin praktikën dhe jurisprudencën e Dhomës së Posaçme lidhur me trajtimin e rasteve që kanë të bëjnë me 20 %;

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Trajtimi i kërkesave të punëtorëve për realizimin e 20% nga shitja e Ndërmarrjeve Shoqërore;
- ✓ Procedurat dhe afatet ligjore para Agjencisë dhe Dhomës së Posaçme;
- ✓ E drejta e pensionistëve dhe ish-punëtorëve që kanë vdekur para privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore;
- ✓ Praktika gjyqësore e Dhomës së Posaçme lidhur me të drejtat e punëtorëve për realizimin e 20%.

Metodologjia e trajnimit

Diskutime interaktive me pjesëmarrësit në formë të tryezës, raste praktike gjyqësore dhe shtjellimi i tyre me PowerPoint.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët e Dhomës së Posaçme, gjyqtarët e gjykatave tjera, bashkëpunëtor profesional dhe zyrtar ligjor të gjykatës. Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

E drejta administrative

77. Trajnim hyrës për ligjin dhe politikën e konkurrencës dhe rregullimin e ndihmës shtetërore në Kosovë

Të dyja ligjet janë krijuar për të siguruar tregje të ndershme dhe konkurruese në Kosovë në përfitimin përfundimtar të konsumatorëve dhe tatimpaguesve. Trajnimi është krijuar për të pajisur praktikuesit juridik me njohuri themelore se si synojnë të funksionojnë këto ligje të reja, ose relativisht të reja në Kosovë në përputhje me ligjin dhe praktikën e BE-së.

Objektivat e modulit trajnues

Pas përfundimit të trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Aplikojnë dhe zbatojnë drejtë Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Ligjin për Ndhimë Shtetërore;
- Avancojnë njohuritë lidhur me praktikën anti-konkurruese dhe mënyrën e rregullimit të tyre.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Hyrje në ligjin e BE-së për konkurrencën dhe zbatimin e saj në Kosovë;
- ✓ Karakteristikat kryesore të praktikave anti-konkurruese dhe mënyrën e rregullimit të tyre;
- ✓ Hyrje në ligjin e BE-së për Ndhimë Shtetërore dhe zbatimin e tij në Kosovë;
- ✓ Karakteristikat kryesore të procesit rregullues të ndihmës shtetërore.

Metodologjia e trajnimit

Trajnimi do të përdorë metoda të kombinuara shpjegimi, përfshirë shpjegime teorike dhe praktike dhe shembuj të praktikës gjyqësore

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët e Gjykatës Administrative dhe Ekonomike, stafi administrativ i gjykatës dhe prokurorët. Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

78. Procedura administrative lidhur me kërkesat nga lëmia e marrëdhënieve të punës, veçmas masat disiplinore

Në bazë të Ligjit për Zyrtarët publik janë përcaktuar saktë kompetencat dhe masat disiplinore ndaj shërbyesit civil – zyrtarit publik. Meqenëse LZP është ligj i ri dhe se është i domosdoshëm për trajtim, ka nevojë për zbatimin e dispozitave të tija veçmas atyre që kanë të bëjnë me masat disiplinore. Qëllimi i këtij trajnimi është avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me problematikën e shkeljeve të dispozitave të LZP dhe masat disiplinore që mund shqiptohen.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zbërthejnë procedurat para Komisionit Disiplinor në procedurat disiplinore;
- Dallojnë në mes të shkeljeve disiplinore dhe veprave penale të kryera gjatë detyrave të punës dhe jashtë detyrave të punës;
- Njohin llojet e masave disiplinore;
- Zbatojnë drejtë dispozitat lidhur me kompetencën dhe rolin e organit disiplinor.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Përgjegjësia disiplinore;
- ✓ Shkeljet disiplinore;
- ✓ Masat disiplinore;
- ✓ Kompetenca dhe organet në procedurën disiplinore.

Metodologjia e trajnimit

Dilemat dhe çështjet e ngritura gjatë trajnimit do të adresohen përmes shpjegimit të pjesshëm teorik, duke u bazuar në raste dhe shembuj konkret. Gjithashtu, përmes ushtrimeve, diskutimeve dhe shembujve praktik mbi parimet dhe rregullat kryesore të Ligjit për zyrtarët publik, pastaj do të ketë punë në grupe-ndarje paraprake të detyrave; raste praktike si dhe diskutimi i tyre me pjesëmarrës.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore, gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës së Apelit, anëtarët e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, si dhe zyrtarët e organeve administrative të nivelit komunal dhe qendrorë. Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

79. Zbatimi i Ligjit për Skemat Pensionale të Financuar nga Shteti

Ligjit për Skemat Pensionale të Financuar nga Shteti përfshin skemën e pensionit bazik të moshës, skemën e pensionit kontribut pagues të moshës, skemën e pensionit të aftësisë së kufizuar dhe skemën e pensionit të përkohshëm si dhe rregullon çështjet e pensionit familjar dhe invalidor të punës, në rastet kur kontribuuesit lëndohen në punë apo fitojnë sëmundje profesionale. Ky ligj përcakton procedurat administrative përmes të cilave personat mund të aplikojnë për përfitimin e pensioneve. Me këtë ligj unifikohet sigurimi i vazhdueshëm i këtyre pensioneve për shtetas të Kosovës dhe për shtetasit e huaj. Qëllimi i këtij trajnimi është avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me zbatimin e unifikuar të legjislacionit në fuqi për pensionet.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zbërthejnë Skemat Pensionale të Financuar nga Shteti;
- Zbërthejnë procedurën administrative përmes të cilave personat mund të aplikojnë për përfitimin e pensioneve;
- Njohin kushtet e pranimi për pension;
- Avancojnë njohurit lidhur me skemat pensionale të përcaktuar me ligjin në fjalë.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Rëndësia e Ligjit për Skemat Pensionale të Financuar nga Shteti;
- ✓ Procedura administrative përmes të cilave personat mund të aplikojnë për përfitimin e pensioneve;
- ✓ Kushtet e pranimi për pension;
- ✓ Skemat pensionale të përcaktuar me ligjin në fjalë.

Metodologjia e trajnimit

Dilemat dhe çështjet e ngritura gjatë trajnimit do të adresohen përmes shpjegimit të pjesshëm teorik, duke u bazuar në raste dhe shembuj konkret. Gjithashtu, përmes ushtrimeve, diskutimeve dhe shembujve praktik mbi parimet dhe rregullat kryesore të Ligjit për skemat pensionale të financuar nga shteti, pastaj do të ketë punë në grupe- me ndarje paraprake të detyrave; si dhe raste praktike dhe diskutimi i tyre me pjesëmarrës.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore, gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës së Apelit, anëtarët e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, si dhe zyrtarët e organeve administrative të nivelit komunal dhe qendror. Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

80. Procedura Administrative në Administratën Tatimore dhe në Doganën e Kosovës

Duke pasur parasysh se çështjet e gjyqësorit të parashtruara para një gjykate janë shumë të rëndësishme, sidomos në lidhje me ndikimin e tyre në ekonominë e vendit dhe jo vetëm për palët e interesuara drejtpërdrejtë, trajnimi i vazhdueshëm për gjyqtarët në fushën e taksave dhe për çështjet doganore janë të domosdoshëm për gjyqësorin. Duke rritur kompetencat e gjyqtarëve në fushën e tatimeve, këto trajnime ndihmojnë pavarësinë e gjyqësorit, gjë e cila rritë sigurinë e tatim paguesve dhe investitorëve. Andaj, qëllimi i këtij trajnimi është që të plotësoj njohuritë dhe shkathtësitë e gjyqtarëve, duke siguruar një trajnim adekuat për legjislacionin tatimor. Këto njohuri dhe aftësi janë thelbësore për gjyqtarët të cilët në punën e tyre të përditshme duhet të shqyrtojnë ekspertizat e ekspertëve të kontabilitetit dhe dokumentet tjera përcjellëse nga autoritetet tatimore. Trajnimi do të adresoj edhe problemet lidhur me zbatimin e Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës. Me theks të veçantë të klasifikimi tarifor i mallrave, origjina e mallrave, procedura doganore dhe taksimi i produkteve me akcizë.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Vlerësojnë procesin e numrit fiskal dhe pajisjen me certifikatë fiskale;
- Interpretojnë drejtë deklaratat tatimore;
- Të kuptojnë procedurat e ekzekutimit të masës për konfiskimin e pasurisë në rast të mos pagimit të tatimit të obligueshëm;
- Aplikojnë drejtë Kodin Doganor dhe Akcizave të Kosovës në kontestet gjyqësore;
- Kuptojnë drejtë dispozitat dhe kriteret mbi importet e përkohshme.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Shqyrtimi i përgjithshëm lidhur me numrin fiskal dhe pajisjen me certifikate fiskale;
- ✓ Procedura e çregjistrimit të tatim paguesve dhe kuptimi i deklaratës tatimore;
- ✓ Procedura e ekzekutimit lidhur me masat për konfiskimin e pasurisë në rast të mos pagimit të tatimit të obligueshëm;
- ✓ Tarifa Doganore e Kosovës dhe Klasifikimi tarifor i mallrave;
- ✓ Origjina e mallrave;
- ✓ Procedurat Doganore dhe Taksimi i produkteve me akcizë.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij trajnimi do të përdoren metodat te kombinuar si: shpjegim i pjesshëm teorik, ushtrime, diskutime dhe shembuj praktik.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit, përfaqësuesit e ATK të nivelit lokal dhe qendror dhe Doganave të Kosovës. Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

81. Shqyrtim kryesor, procedura e provave dhe Barra e të Provuarit në Konfliktin administrativ

Konflikti Administrativ është një procedurë gjyqësore e cila udhëhiqet nga gjyqësori duke përfshirë tre shkallëshmërinë në gjykata dhe në të njëjtën kohë, përpos shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimeve të organeve administrative të cilën procedurë e zhvillon përmes padive dhe të cilat ushtrohen nga palët e pakënaqura kundër një vendimi përfundimtar në procedurë administrative. Po ashtu, në të njëjtën kohë është një procedurë e cila shërben edhe si Instrument për kontroll të punës së organeve administrative gjatë vendosjes lidhur me kërkesat e palëve me rastin e shqyrtimit të kërkesës e deri te marrja e vendimit, ku në këtë procedurë edhe vlerësohet ligjshmëria e akteve administrative, gjë që edhe i jep rëndësinë e institucionit të veçantë Konfliktit Administrativ. Trajnimi do të fokuset tek problemet praktike sa i përket shqyrtimit kryesor dhe zhvillimit të tij, procedura e provave si dhe barra e të provuarit në konfliktin administrativ.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zbatojnë drejtë dispozitat e LKA-së, për shqyrtimin kryesor;
- Identifikojnë qartë provat;
- Vlerësojnë drejtë barrën e të provuarit.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Shqyrtimi kryesor dhe zhvillimi i tij;
- ✓ Procedura e provave;
- ✓ Barra e të provuarit.

Metodologjia e trajnimit

Për realizimin e këtij trajnimi do të përdoren metodat e kombinuara: shpjegimi i shkurtë teorik, diskutimet interaktive, prezentime në PowerPoint, pyetje e përgjigje dhe analizimi i përbashkët i problemeve rreth punës në praktikë.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative-Gjykata Themelore, gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative-Gjykata e Apelit. Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

82. Procedura administrative që nga shpallja e tenderit deri të vendimmarrja e OSHP

Me këtë trajnim do të trajtohet tema që ka të bëjë me procedurat e prokurimit, zbatimin fillestar të procedurës së shqyrtimit, vlerësimi i shkresave nga eksperti shqyrtues dhe rekomandimin për OSHP. Do të analizohen dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik duke zërthyer kriteret lidhur me ciklin e procesit të prokurimit publik dhe kontestet me OSHP. Gjithashtu në këtë trajnim do të trajtohen procedurat tek organi për shqyrtimin e prokurimit publik dhe mënyra e inicimit të konfliktit administrativ nga gjykata kompetente.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zbërthejnë etapat e procedurës së prokurimit publik;
- Identifikojnë karakteristikat në procedurën e konfliktit administrativ sipas Ligjit për Prokurim Publik;
- Interpretojnë dhe zbatojnë drejtë dispozitat e ligjit për prokurimin publik në praktikën gjyqësore.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Udhëheqja e procedurës së prokurimit- dispozitat e përgjithshme;
- ✓ Shqyrtimi fillestar i shkresave nga eksperti shqyrtues dhe rekomandimi për OSHP;
- ✓ Nënshkrimi i kontratës pas përfundimit të procedurës në bazë të Ligjit për Prokurimin Publik.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij trajnimi do të përdoren metodat siç janë: shpjegimi i pjesshëm teorik, ushtrime, diskutime dhe shembuj praktik mbi parimet dhe rregullat kryesore të Ligjit për Prokurim Publik, diskutime interaktive, pyetje dhe përgjigje, si dhe raste nga praktika gjyqësore.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit, zyrtarët e OSHP. Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

83. Zbatimi i Ligjit për Regjistrimin Civil

Qëllimi i organizimit dhe mbajtjes së trajnimit mbi zbatimin e Ligjit për Regjistrin Civil është ngritja e njohurive profesionale të gjyqtarëve, për regjistrat e gjendjes civile: si bëhet korigjimi dhe plotësimi në regjistrin qendror të gjendjes civile, regjistrimin e lindjes në bazë të dokumenteve, në bazë të lindjes dhe regjistrimin e mëvonshëm dhe ri regjistrimin. Ky ligj i rregullon përbërësit e gjendjes civile, shtetasve të Kosovës, shtetasve të huaj dhe personave pa shtetësi, me banim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Kosovës, përcaktimin e rregullave për krijimin, ruajtjen dhe ndryshimin e regjistrave civil, organizimin dhe funksionimin e shërbimit të gjendjes civile në Republikën e Kosovës.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të trajtimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zbatojnë drejtë dispozitat përkatëse lidhur me regjistrimin e lindjes në bazë të dokumenteve bazë të lindjes;
- Dallojnë procedurat në mes të regjistrimit të mëvonshëm dhe ri regjistrimit;
- Aplikojnë drejtë dispozitat e Ligjit për Regjistrimin Civil të Kosovës;
- Zbatojnë drejtë mënyrën e korigjimit dhe plotësimin e regjistrave qendror të gjendjes civile.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Dispozitat ligjore për regjistrat e gjendjes civile në Republikën e Kosovës;
- ✓ Regjistrat e gjendjes civile, korigjimi dhe plotësimi në regjistrin qendror të gjendjes civile.
- ✓ Regjistrimi i lindjes në bazë të dokumenteve bazë të lindjes.
- ✓ Regjistrimi i mëvonshëm dhe ri regjistrimi.

Metodologjia e trajnimit

Metodat që do të përdoren gjatë këtij trajnimi do të jenë shpjegim i pjesshëm teorik, ushtrime, diskutime dhe shembuj praktik mbi parimet dhe rregullat kryesore të Ligjit për Regjistrat Civil të Kosovës, diskutime interaktive, pyetje dhe përgjigje, si dhe raste nga praktika gjyqësore.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe të Gjykatës së Apelit, Zyrtarët e departamentit për regjistrim civil në Ministrinë e Punëve të Brendshme në Republikën e Kosovës. Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

Trajnimet për Stafin Administrativ gjyqësor dhe
prokurorial

84. Risitë në kompetencat dhe strukturën organizative dhe menaxheriale në sistemin gjyqësor dhe prokurorial

Sistemi gjyqësor dhe ai prokurorial janë kategori kushtetuese dhe ligjore. Në kuadër të sistemit gjyqësor dhe prokurorial hyjnë trupat administruese të tyre si: Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Gjykatat dhe Prokurori i Shtetit. Mandati, struktura dhe kompetencat e këshillave, gjykatave dhe prokurorive janë të përcaktuara me ligje të veçanta. Qëllimi kryesor i këtij moduli trajnues është që përmes temave konkrete të njoftojë stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive me kompetencat, strukturën organizative, mandatin dhe kornizën ligjore të sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

Në kuadër këtij trajnimi do të trajtohen zhvillimet aktuale përreth punës së këshillave, vendimet më të rëndësishme të tyre, aktet normative kryesore dhe politikat e ndryshme për administrimin e sistemit. Gjithashtu sfidat në ushtrimin e mandatit të këshillave, gjykatave dhe prokurorit të shtetit do të jenë pjesë e diskutimeve në trajnimet e këtij moduli.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Njohin strukturën, organizimin dhe kompetencat e sistemit gjyqësor/prokurorial;
- Zbatojnë aktet normative dhe politikat e Këshillave.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Korniza ligjore e sistemit gjyqësor - prokurorial;
- ✓ Organizimi i sistemit gjyqësor - prokurorial;
- ✓ Kompetencat e sistemit gjyqësor - prokurorial.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë mbajtjes së trajnimeve të cilat janë pjesë e këtij moduli do të përdoret metodologjia si në vijim: prezantim i shkurtër i temave përmes teknikave moderne trajnuese, diskutime interaktive me pjesëmarrës (pyetje/përgjigje/komente), demonstrim i dokumenteve të këshillit/video eventuale (takime/ pune të këshillit).

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Zyrtarët ligjorë (përfshirë zyrtarët ligjor të sekretariateve), referentët administrativ dhe zyrtarët për komunikim me mediet dhe publikun. Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

85. Menaxhimi i punës në administratën e sistemit gjyqësor dhe prokurorial

Sistemi gjyqësor dhe ai prokurorial përbëjnë njërin nga shtyllat kryesore të pushtetit shtetëror. Korniza ligjore aktuale përkitazi me gjyqësorin dhe prokurorinë është e veçantë dhe ka themeluar dy trupa administruese, përkatësisht Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK). Kjo kornizë ligjore po ashtu ka rregulluar edhe strukturën e gjykatave dhe prokurorive. Në kuadër të trupave administruese të sistemit gjyqësor (KGJK) dhe prokurorial (KPK) si dhe në kuadër të gjykatave dhe prokurorive, funksionon administrata e cila ka status, strukturë organizative dhe kompetenca specifike. Kjo administratë përfshinë kategori dhe profile të ndryshme të stafit, në varësi të strukturës organizative dhe detyrave të punës. Ky trajnim do të trajtojë aspekte të menaxhimit dhe udhëheqjes, planifikimit, vendimmarrjes dhe punës së përditshme, përfshirë por pa u kufizuar në efikasitetin dhe llogaridhënien e stafit administrativ. Roli dhe përgjegjësitë e sekretariatit të KGJK -së në raport me gjykatat duhet të merret parasysh në krahasim me rolin dhe përgjegjësitë e sekretariatit të KPK-së në raport me Prokurorin e Shtetit.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Aplikojnë standardet adekuate të menaxhimit dhe udhëheqjes;
- Hartojnë plane për një punë të suksesshme dhe marrin vendime të arsyeshme;
- Krijojnë ambient për një punë kreative, efikase dhe efektive;
- Menaxhojnë situatat stresuese dhe punës me presion.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Menaxhimi dhe udhëheqja;
- ✓ Planifikimi dhe vendimmarrja;
- ✓ Proceset e brendshme dhe të jashtme të punës;
- ✓ Efikasiteti dhe llogaridhënia e stafit administrativ.

Metodologjia e trajnimit

Trajnimi do të realizohet duke përdorë metodologji të ndryshme përfshirë diskutime interaktive, punë në grupe, përgatitje dhe trajtim të rasteve nga praktika.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Administratorët dhe ndihmës administratorët e gjykatave dhe administratorët e prokurorive. Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

86. Shkrimi dhe arsyetimi ligjor

Përmes këtij trajnimi synohet të ngriten kapacitetet profesionale për shkrimin dhe arsyetimin ligjor duke ju dhënë mundësi pjesëmarrësve të njihen me standardet bashkëkohore të shkrimit dhe arsyetimin ligjor. Shkrimi dhe arsyetimi ligjor është pjesë e punës së përditshme për secilin zyrtar të gjykatave dhe prokurorive, prandaj është edhe parakusht për ngritje të cilësisë së vendimeve gjyqësore dhe akteve të tjera të ndryshme, e rrjedhimisht edhe parakusht për efikasitetin dhe besueshmërinë e publikut në vendimet gjyqësore.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Njohin parimet e shkrimit të mirë ligjor;
- Njohin metodat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor;
- Hartojnë vendimet sipas metodës IRAC;
- Njohin teknikat dhe burimet e hulumtimit ligjor.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Procesi dhe parimet e të shkruarit mirë ligjor;
- ✓ Shkrimi dhe arsyetimi ligjor përmes metodës IRAC;
- ✓ Rëndësia dhe nevoja për procesin analitik;
- ✓ Udhëzime për Shkrimin dhe Arsyetimin e Aktgjykimeve;
- ✓ Teknikat e hulumtimit ligjor.

Metodologjia e trajnimit

Realizimit të trajnimit do ti kontribuojnë metodat e prezantimit përmes PowerPoint, punës në grupe dhe rastet praktike.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët ligjor dhe asistentet-sekretaret juridike. Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

87. Menaxhimi i dosjes dhe lëndës në sistemin gjyqësor dhe prokurorial

Qëllimi kryesor i këtij trajnimi është që nëpërmjet prezantimit të koncepteve dhe parimeve të menaxhimit të rrjedhës së rasteve, pjesëmarrësit të njoftohen dhe të përgatiten me shkathtësi për identifikimin, fillimisht të problemeve të menaxhimit të rasteve dhe më pas për të zhvilluar dhe zbatuar një plan për menaxhimin e rrjedhjes së lëndës.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Avancojnë njohuritë për menaxhimin e rasteve;
- Respektojnë parimet e menaxhimit të rasteve;
- Demonstrojnë teknikat e menaxhimit të rasteve;
- Avancojnë njohuritë lidhur me parimet dhe metodologjinë e CEPEJ.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Regjistrat e gjykatave dhe prokurorive;
- ✓ Organizimi i rrjedhës së punës dhe zhvillimit të lëndës;
- ✓ Mbledhja e të dhënave statistikore dhe raportimi;
- ✓ Menaxhimi efikas i lëndëve bazuar në metodologjinë CEPEJ;
- ✓ Digjitalizimi i procesit të punës në gjykata dhe prokurori.

Metodologjia e trajnimit

Realizimit të trajnimit do ti kontribuojnë metodat e prezantimit përmes PowerPoint, punës në grupe dhe përdorimi i rasteve praktike.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Administratorët, ndihmës administratorë, shefi i ZML-së, referentët, zyrtarët e statistikave, zyrtarët ligjor, sekretarët juridik, zyrtarët e informimit, njësi për vlerësimin e performancës së prokurorëve dhe gjyqtarëve. Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

88. Komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun

Qasja e publikut dhe e medieeve në procedurat gjyqësore paraqet një ndër elementet kryesore të transparencës. Publiku në Kosovë është i etshëm të dijë se çka punohet nëpër gjykata. Në përgjithësi gjykatat në Kosovë kanë hapësirë të vogël dhe mungesë të sallave të gjykimit. Qasja e publikut në seancat gjyqësore rritë njohuritë e publikut për punën e gjykatave dhe besimin e qytetarëve tek gjykatat. Mediet paraqesin një nga mjetet dhe format më efikase të transparencës. Raportimet, historitë apo pjesët interesante nga proceset gjyqësore ishin, janë dhe mbeten çështje mjaft interesante për publikun. Përderisa seancat gjyqësore janë të hapura për publikun (përveç atyre që me ligj duhet të jenë të mbyllura), publiku informohet nga ana e pjesëmarrësve të medieeve. Megjithatë neve na duhet që të krijojmë raporte informacioni për ato që kanë ndodhur në seancat gjyqësore. Kjo realizohet nga ana e zëdhënësve të gjykatave/prokurorive.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Kuptojnë rëndësinë e komunikimit në përgjithësi;
- Zbatojnë në praktikë raportimin nga seancat gjyqësore;
- Zbatojnë në praktikë komunikimin me medie dhe publikun.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Qasja në komunikim dhe marrëdhëniet me medie;
- ✓ Qasja e publikut dhe medieeve në procedurat gjyqësore;
- ✓ Raportimi nga seancat gjyqësore;
- ✓ Prezantimi institucional dhe informata për publikun;
- ✓ Kuptimi i kontekstit, kërkesës /interesimit, informatës dhe mesazhit;
- ✓ Organizimi i konferencës për shtyp;
- ✓ Prezantimi para publikut dhe prezantimi në medie.

Metodologjia e trajnimit

Trajnimi do të realizohet nëpërmjet metodave interaktive, diskutimit lidhur me raste praktike, të cilat do të mundësojnë që pjesëmarrësit të marrin njohuri dhe në mënyrë praktike ti demonstrojnë njohuritë e fituara.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Zyrtarët përgjegjës për komunikim me medie dhe publikun në Gjykata dhe Prokurori. Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

89. Integriteti dhe sjelljet etike

Qëllimi më i lartë i administratës gjyqësore dhe prokuroriale në Kosovë, për të gjithë stafin që i përket sistemit gjyqësor dhe prokurorial, është rritja e cilësisë së performancës profesionale, duke siguruar zbatimin e duhur praktik të parimeve dhe standardeve etike në përputhje më Kodin e Etikës siç janë: profesionalizmi, disiplina në punë, paañësia, pavarësia, konfidencialiteti, shmangia nga konflikti i interesit dhe nga sjelljet e pa hijshme, ndershmëria dhe llogaridhënia. Moduli është hartuar në atë formë që përmes shpjegimeve të pjesshme teorike dhe diskutimeve interaktive, të trajtojë rregullat e përcaktuara të sjelljes etike dhe profesionale, duke ofruar bazën ligjore dhe shembuj praktik për pjesëmarrësit.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Dallojnë sjelljet etike brenda dhe jashtë zyrës;
- Zbatojnë në mënyrë të drejtë Kodin e Etikës dhe parimet e tij;
- Identifikojnë rastet kur kemi të bëjmë me shkelje etike.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Parimet dhe normat e sjelljes etike;
- ✓ Sjellja brenda dhe jashtë zyrës; dhe
- ✓ Ndërgjegjësimi social dhe përgjegjësia.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij trajnimi do të aplikohet metodologjia e kombinuar me shpjegime teorike, përmes PowerPoint dhe diskutime interaktive.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Stafi administrativ gjyqësor dhe prokurorial. Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

90. Menaxhimi i kohës dhe stresit

Ky trajnim është i konceptuar si projekt i nevojshëm i zhvillimit të shkathtësive të menaxhimit të kohës dhe stresit për zyrtarët e administratës së Gjykatave dhe Prokurorive si një predispozitë e përmirësimit të performancës së tyre në funksion të mbështetjes së punës dhe rritjes së efikasitetit të punës së Gjykatave dhe Prokurorive gjatë ushtrimit të detyrave dhe funksioneve të tyre të përcaktuara me ligj. Stresi sot është një dukuri negative përcjellëse në të gjitha aktivitetet, zhvillimet, veprimet e sjelljet e individit dhe dukuri e pashmangshme në përgjithësi në socium. Zyrtarët e administratës së Gjykatave dhe Prokurorive gjatë punës së tyre të përditshme përballen me situata të shumta stresuese dhe u ekspozohen gjatë punës stresorëve të shumtë, të cilët interferojnë negativisht në shërbimet e këtyre zyrtarëve në raport me Gjykatësit e Prokurorët por edhe në raport me palët e subjektet tjerë. Menaxhimi i kohës dhe stresit është nevojë imediate, si parandalim i atakimit të personaliteteve të zyrtarëve në administratë në rastin konkret, nga ana e stresorëve të ndryshëm, në mënyrë që puna e tyre të jetë cilësore dhe efikase.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Dijnë të menaxhojnë mirë kohën;
- Bëjnë prioritizimin e aktiviteteve të tyre ditore, javore dhe mujore;
- Njohin dhe aplikojnë teknikat dhe mënyrat e ruajtjes së shëndetit dhe kondicionit të punës.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Stresi dhe përkufizimi teorik;
- ✓ Menaxhimi i kohës;
- ✓ Prioritizimi i aktiviteteve;
- ✓ Teknikat e ruajtjes së shëndetit dhe kondicionit të punës;
- ✓ Ruajtja nga “djegia” e profesionit.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij trajnimi do të aplikohen metoda dhe teknika bashkëkohore, prezantim në PowerPoint, pune në grupe dhe studim i rasteve nga praktika.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Stafi administrativ gjyqësor dhe prokurorial. Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

91. Trajnimi në përdorimin e Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL)

Sistemi për Menaxhimin Informativ të Lëndëve ka reformuar punën në sistemin e drejtësisë ku është dixhitalizuar puna në gjykata dhe prokurori. Menaxhimi i lëndëve në mënyrë elektronike mundëson që gjykatat dhe prokuroritë të realizojë vizionin e tyre për një sistem gjyqësor efikas, transparent, llogaridhënës dhe të qasshëm për të gjithë qytetarët. Me qenë se ky sistem është jetësuar viteve të fundit, sfidat në aplikimin e tij sigurisht që janë të pashmangshme. Ky modul trajnimi do të adresojë sfidat gjatë përdorimit të SMIL dhe do të kontribuojë në ngritjen e aftësive dhe përgatitjen e stafit administrativ në gjykata dhe prokurori për përdorimin e SMIL, për ti kryer punët dhe detyrat e tyre në menaxhimin e lëndëve gjatë punës së tyre.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Avancojnë njohuritë në përdorimin e SMIL;
- Zgjerojnë njohuritë rreth sistemit dhe aplikacioneve të SMIL.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- Sistemi SMIL;
- Aplikacionet e SMIL;
- Regjistrimi i lëndëve, caktimi i seanceve,
- Procesverbalet,
- Menaxhimi i ftesave deri në arkivim.

Metodologjia e trajnimit

Për realizimin me sukses të trajnimeve dhe arritjen e objektivave të trajnimeve, metodologjia më e përshtatshme është metoda e mbajtjes së trajnimit klasik. Me këtë rast, në Akademinë e Drejtësisë duhet të sigurohen salla të pajisura me pajisje kompjuterike të duhura të cilat kanë edhe qasje në SMIL që përdoren për qëllime të trajnimit.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Përfituesit e trajnimit janë stafi administrativ gjyqësor dhe prokurorial. Trajnimi do të zgjasë dy (2) ditë.

92. Trajnimet për sistemet audio/ video dhe për sistemet e mbrojtjes së dëshmitarëve

Qëllimi i këtij trajnimi është ngritja e aftësive të stafit të gjykatave në përdorimin e sistemeve audio dhe video në gjykatë si dhe sistemeve që mundësojnë dhënien e dëshmisë së mbrojtur nga distanca për dëshmitarët e mbrojtur.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Avancojnë aftësitë rreth përdorimit të pajisjeve dhe sistemeve audio/ video;
- Zgjerojnë njohuritë rreth përdorimit të sistemeve për mbrojtjen e identitetit të dëshmitarëve në seancat gjyqësore të drejtpërdrejta.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Sistemet audio dhe video që janë në përdorim për gjykata;
- ✓ Mbajtja e seancave duke përdorur sisteme audio dhe video si dhe ruajtjen e incizimeve.

Metodologjia e trajnimit

Për realizimin me sukses të trajnimeve dhe arritjen e objektivave të trajnimeve në aftësimin e gjyqtarëve për përdorimin e TIK-ut në punën e tyre, metodologjia më e përshtatshme është metoda e mbajtjes së trajnimit në klasë. Me këtë rast, në Akademinë e Drejtësisë duhet të sigurohen salla të pajisura me pajisje kompjuterike si dhe sistemet e duhura audio dhe video. Këto trajnime mund të organizohen edhe në kombinim në hapësirat e Akademisë së Drejtësisë dhe në salla të gjyqimit në gjykata, për të parë funksionimin e këtyre sistemeve në kushte reale.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Përfituesit e trajnimit janë gjyqtarët dhe stafi administrativ. Trajnimi do të zgjasë dy (2) ditë.

Trajnimet për avancim për Gjyqtarët dhe
Prokurorët e Shtetit

93. Trajnimet për avancim për Gjyqtarët dhe Prokurorët e Shtetit

Për gjyqtarët dhe prokurorët e shtetit të cilët janë avancuar nga një nivel në tjetrin, apo nga një departament në tjetrin, do të ofrohen trajnime adekuate me qëllim të përmbushjes së nevojave dhe kërkesave të tyre të karakterit profesional, interdisiplinar dhe personal. Programi orientues i përcaktuar për këtë kategori përgatitë përfituesit për kryerjen e punës me sukses menjëherë pas marrjes së detyrës së re.

Gjyqtarët dhe prokurorët e avancuar nga një departament në tjetrin në kuadër të njëjtit nivel

Avancimet e gjyqtarëve dhe prokurorëve nga një departament në tjetrin, shtrojnë nevojën që këto ndryshime të shoqërohen edhe me ndjekjen e disa trajnimeve specifike nga ana e gjyqtarëve dhe prokurorëve, të cilat do t'i përshtaten veçorive të tyre. Në këtë drejtim Akademia ofron programe orientuese të cilat janë të gatshme për zbatim në çdo kohë kur ndodhin këto avancime brenda sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

Programet orientuese për gjyqtarët dhe prokurorët që avancohen nga një departament në tjetrin fokusohen në zhvillimin e shkathtësive dhe praktikave si më poshtë:

- Ballafaqimi me procedurat e reja dhe juridiksionin e ri;
- Roli i gjyqtarit apo prokurorit sipas kompetencës së departamentit përkatës;

Gjyqtarët dhe Prokurorët e avancuar nga niveli themelor në atë të Apelit

Ky program trajnimi përmban module që fokusohen në kompetencën profesionale të gjyqtarëve apo prokurorëve të avancuar, e të cilat janë:

- Kompetenca dhe juridiksioni në nivelin e apelit;
- Kompetenca dhe juridiksioni në departamentin përkatës të nivelit të apelit.

Gjyqtarët e avancuar nga Gjykata e Apelit në Gjykatën Supreme

Programi i trajnimit për gjyqtarët e avancuar nga Gjykata e Apelit në Gjykatën Supreme, përmban module që fokusohen në kompetencën profesionale, që fokusohet në:

- Kompetenca dhe juridiksioni në nivelin e Gjykatës Supreme;
- Kompetenca dhe juridiksioni në fushën përkatëse.

Prokurorët e avancuar nga Prokuroria e Apelit në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit

Programi i trajnimit për prokurorët e avancuar nga Prokuroria e Apelit në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, përmban module që fokusohen në kompetencën profesionale, që fokusohet në:

- Kompetenca dhe juridiksioni në nivelin e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit;
- Kompetenca dhe juridiksioni në fushën përkatëse.

Trajnime për profesionet tjera të lira

94. Përmbartimi në sendet e luajtshme

Gjatë zbatimit të përmbartimit i cili sipas propozimit të kreditorit nga organi përmbartues caktohet në bazë të një dokumenti përmbartimor apo dokumenti të besueshëm, organi përmbartues duhet që përmbartimin e caktuar ndaj palës debitore ta zbatojë në ato mjete dhe objekte të përmbartimit të cilat janë propozuar nga pala kreditore, përveç atyre objekteve që përjashtohen nga përmbartimi me ligj dhe aktet ndërkombëtare të zbatueshme në Kosovë. Veprimet përmbartimore mund të kryhen drejtpërdrejtë kundër debitorëve dhe personave tjerë në pajtim me këtë ligj, gjithnjë duke pas parasysh që vëmendje duhet kushtuar mbrojtjes së dinjitetit të debitorit, dhe përmbartimi të jetë sa më pak i dëmshëm që është e mundshme për debitorët. Në rastet kur objekt përmbartimi janë sendet e luajtshme, organi përmbartues gjatë ndërmarrjes së veprimeve përmbartimore fillon nga inventarizimi, regjistrimi, vlerësimi dhe shitja e tyre përmes ankandit publik, më qëllim të realizimit të kredisë së kreditorit.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Kuptojnë mënyrën e inventarizimit, vlerësimit dhe shitjes së sendeve të luajtshme
- Identifikojnë se cilat sende janë të përjashtuara nga përmbartimi;
- Zbatojnë procedurën e shitjes lidhur me sendet e luajtshme përmes ankandeve.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Kompetenca e organit përmbartues;
- ✓ Sendet që përjashtohen nga përmbartimi;
- ✓ Veprimet përmbartimore dhe objekti i sekuestrimit;
- ✓ Vëllimi, ruajtja dhe ndalimi i disponimit me sendet e inventarizura dhe sekuestrura;
- ✓ Vlerësimi, koha dhe mënyra e shitjes së sendeve të sekuestrura.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij programi do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike të përcjella me shembuj praktik, në mënyre që secili nga pjesëmarrësit të jetë aktiv gjatë gjithë kohës, duke marrë pjesë në diskutime me pjesëmarrësit tjerë dhe me prezantuesin pas çdo prezantimi dhe ushtrimi.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatave Themelore nga divizioni civil, bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët ligjor dhe zyrtarët përmbartimor, si dhe Përmbartuesit Privat. Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

95. Përmbartimi në sendet e paluajtshme

Zbatimi i përmbartimit për sendet e paluajtshme i cili nga organi përmbartues caktohet në bazë të një dokumenti përmbartimor apo dokumenti të besueshëm, zbatohet më shënimin e përmbartimit në librin publik të paluajtshmërive, përcaktimin e vlerës së paluajtshmërisë, shitjen e paluajtshmërisë dhe pagesën e kredisë së kreditorit nga shuma e fituar nga shitja. Organi përmbartues çdoherë duhet që përmbartimin ndaj palës debitorë ta caktoj dhe zbatoj në atë objekt të përmbartimit (send të paluajtshëm) për të cilin kreditori ka prezantuar dëshmi se është pronë e debitorit, gjithnjë duke pas parasysh që në rast se nga kreditori ka propozuar më shumë mjete apo objekte përmbartimi se sa që nevojiten për të realizuar kredinë, organi përmbartues nuk ka pengesa që përmbartimin ta kufizojë në vetëm disa nga mjetet dhe objektet e tilla të propozuara, nëse vlerëson se ato do të mjaftojnë për realizimin e kredisë së kreditorit. Veprimet përmbartimore në sende të paluajtshme mund të kryhen drejtpërdrejt kundër asaj paluajtshmërie si tërësi por edhe ndaj pjesës në bashkëpronësi, duke pas kujdes që debitorëve dhe personave tjerë në pajtim me këtë ligj, duhet kushtuar vëmendje sa i përket mbrojtjes së dinjitetit të tyre dhe përmbartimi të jetë sa më pak i dëmshëm për debitorët.

Objektivat e modulit të trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Kuptojnë mënyrën e regjistrimit të paluajtshmërive përmes aktit të shënimit në librat publik për paluajtshmëri;
- Vlerësojnë se cila paluajtshmëri mund të bëhet objekt përmbartimi;
- Zbatojnë drejtë procedurën e vlerësimit të sendeve të paluajtshme, shitjes së tyre dhe dorëzimin e tyre blerësve.

Përmbajtja e modulit të trajnimit

- ✓ Kompetenca e organit përmbartues;
- ✓ Paluajtshmëritë që mund të jenë objekt përmbartimi;
- ✓ Kufizimi i përmbartimit në rast se janë propozuar disa paluajtshmëri;
- ✓ Ndryshimi i objektit të përmbartimit;
- ✓ Shënimi i përmbartimit, caktimi i vlerës, shitja dhe dorëzimi i paluajtshmërisë blerësit.

Metodologjia e trajnimit

Gjatë këtij programi do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike të përcjella me shembuj praktik, në mënyrë që secili nga pjesëmarrësit të jetë aktiv gjatë gjithë kohës, duke marrë pjesë në diskutime me pjesëmarrësit tjerë dhe me prezantuesin pas çdo prezantimi dhe ushtrimi.

Përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit

Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatave Themelore nga divizioni civil, bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët ligjor dhe zyrtarët përmbartimor dhe Përmbartuesit Privat. Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

Trajnimet për Trajnues

Duke u bazuar në Programin Kornizë 2021-2022, objektivë dhe fokus i Akademisë së Drejtësisë do të jeneë edhe trajnime për trajnues me theks te avancimi i metodologjisë trajnuese bashkëkohore, marrë parasysh rendësinë e tyre në zbatimin dhe realizmin e Programeve Trajnuese.

Në vazhden e kësaj, në kuadër të bashkëpunimit me partner ndërkombëtar, përkatësisht projektin e KE për përf forcimin e lirisë së shprehjes – JUFREX do të organizohet Trajnimi i trajnerëve për lirinë e shprehjes. Pjesëmarrësit në TiT do të jenë gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë. Aktiviteti do të mbështetet nga ekspertët ndërkombëtarë të cilët do të përqendrohen në standardet ndërkombëtare në lidhje me Lirinë e shprehjes dhe metodologjinë e të mësuarit për të rritur, të cilat do të përdoren nga trajnerët e ardhshëm gjatë trajnimeve vijuese. Dita e fundit e trajnimit do të përqendrohet në platformën HELP dhe në dy kurse të ofruara në të (Kursi HELP mbi Lirinë e Shprehjes dhe Kursi HELP mbi Sigurinë e Gazetarëve). Koha që të dyja këto tema të trajtohen në një ditë të TiT do të ndahet në mënyrë të barabartë.

Po ashtu në kuadër bashkëpunimit me projektin e KE, Arikulli 3 i KEDNJ për parandalimin e torturës, Akademia e Drejtësisë do të organizoj trajnimin për trajnues për Nenin 3 të KEDNJ. Trajnime për trajnues do të ketë edhe për fushën e Drejtësisë Komerciale, në bashkëpunim me USAID/CHECCHI and Company Consulting.

Gjithashtu, vlen të theksohet së Akademia në bashkëpunim me OPDAT është në proces të hartimit të Programit të Përhershëm për Trajnues. Për shkak të natyrës së programit dhe infrastrukturës ligjore të Akademisë së Drejtësisë - i cili duhet të rishikohet, ky proces pritet të fillojë gjatë vitit 2021.

Mësimi në distancë

Gjatë vitit 2021, në kuadër të platformës së mësimi në distancë E-learning, do të ofrohen këto kurse trajnuese:

- ✓ Komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun për zyrtarët për informim;
- ✓ Dhuna në Familje;
- ✓ Mbajtja e shënimeve për Interpret Gjyqësor;
- ✓ Menaxhimi Efektiv;
- ✓ Etika Profesionale;
- ✓ Drejtësia për fëmijë – Aspekti Civil;
- ✓ Drejtësia për fëmijë – Aspekti Penal;
- ✓ E drejta e autorit dhe mbrojtja juridike;
- ✓ Faza e aktakuzës dhe deklaramit për fajësinë;
- ✓ Hetimi dhe zbulimi i korrupsionit;
- ✓ Teknologjia Informative;
- ✓ Korrupsioni sipas legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar;
- ✓ Masat e Diversitetit;
- ✓ Menaxhimi i Gjykatës;
- ✓ Menaxhimi i Stresit;
- ✓ Shkathtësitë e komunikimit social;
- ✓ Trajnimi për implementimin e Legjislacionit Tatimor në Kosovë;
- ✓ Udhëheqësia – Lidershipi;

Akademia e Drejtësisë planifikon ti zhvillojë këto kurse trajnuese në platformën e mësimi në distancë E-learning për periudhën dy vjeqare:

- ✓ Kompensimi i viktimeve të krimit;
- ✓ Mbrojtja e pronësisë Intelektuale, markat tregtare, patentat, dizajni industrial;
- ✓ Udhëzues për përdorimin e SMIL;
- ✓ Zhvillimi i shkathtësive gjyqësore;
- ✓ Konfiskimi dhe sekuestrimi;
- ✓ Arsyetimi i vendimeve gjyqësore;
- ✓ Paraburgimi.

Gjithashtu gjatë viti 2021, Akademia e Drejtësisë synon ti inkorporojë edhe disa nga kurset e platformës së Këshillit të Evropës “HELP” në platformën e saj elektronike E-learning.

Trajnimet e mbështetura nga donatorët

Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me projektin e KE-së, Zyra në Prishtinë edhe gjatë vitit 2021 do të bashkëpunojnë në ngritjen e aftësive profesionale të gjykatave dhe prokurorëve në fushën e lirisë së shprehjes/ Neni 10 të KEDNJ.

Trajnim tematik për qasje në dokumente publike dhe të drejtën për të ditur - trajnim dy-ditor për qasjen në dokumente publike për gjyqtarët dhe prokurorët. Trajnimi do të adresojë zhvillimet më të reja në ligjin vendor (një ligj i ri për qasjen në dokumente publike u miratua kohët e fundit nga Kuvendi i Kosovës) si dhe standardet e KE dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së mbi këtë temë.

Trajnim tematik për mbrojtjen e sinjalizuesve - trajnim dy-ditor mbi kornizën ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare mbi sinjalizimin për gjyqtarët, prokurorët dhe oficerët e policisë. Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, i cili është i ri për anëtarët e sistemit gjyqësor dhe përveç kësaj, në nivelin e BE-së është miratuar një direktivë për mbrojtjen e sinjalizuesve. Gjatë trajnimit, legjislacioni i ri kombëtar dhe ndërkombëtar do t'u shpjegohet gjyqtarëve dhe prokurorëve. Për më tepër, çështjet konkrete dhe të ngjashme të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut mbi sinjalizimin do të ndahen me pjesëmarrësit nga ekspertët ndërkombëtarë dhe ata vendas.

Trajnim për mbrojtjen e gazetarëve - do të organizohet një trajnim dy-ditor për mbrojtjen e gazetarëve që targeton gjyqtarët, prokurorët dhe oficerët e policisë. Trajnimi do të përqendrohet në kërcënimet kryesore ndaj gazetarëve dhe detyrimet e shtetit për mbrojtjen e gazetarëve.

Kurset HELP - dy ngjarje të planifikuara për pjesëmarrësit e interesuar përkatës: Kursi HELP mbi Lirinë e Shprehjes dhe Kursi HELP mbi Sigurinë e Gazetarëve. Numri i pjesëmarrësve nuk është përcaktuar, në varësi të interesit të komunitetit gjyqësor dhe burimeve buxhetore.

Projekti i BE “Mbështetje e Kodit Civil faza e II” - Trajnime dhe tryeza të rrumbullakëta për të drejtën civile (2021 – 2022).

Duke ditur situatën me legjislacion dhe konfliktin e ligjeve në fushën e të drejtës civile, është iniciuar nga Qeveria e Kosovës/Ministria e Drejtësisë, nxjerrja e Kodit Civil të Republikës së Kosovës që nga viti 2014 i cili tashmë është në fazën e miratimit të Kuvendit të Kosovës. Ky proces është mbështetur edhe nga projekti i BE-së për Kodin Civil, faza 2014-2016 dhe faza 2, 2017 deri me 1 shkurt 2021. Me Draft Kodin Civil është arritur kodifikimi-harmonizimi i dispozitave ligjore të fushës civile. Kodi është i strukturuar në 5 libra:

1. Pjesa e përgjithshme,
2. Detyrimet,
3. Pronësia dhe të drejtat tjera sendore,
4. Familja dhe
5. Trashëgimia.

Përveç përkrahjes për Ministrinë e Drejtësisë në hartimin e Kodit Civil, Projekti i BE-së për mbështetje për Kodin Civil ka zhvilluar trajnime dhe tryeza me Akademinë e Drejtësisë, Odën e Avokatëve dhe Odën e Noterëve gjatë vitit 2019 - 2020. Gjithashtu, trajnimet virtuale/online kanë vazhduar edhe gjatë kohës së pandemisë Covid 19 nga muaji Maj-Korrik 2020 ku këto trajnime janë treguar shumë të suksesshme, efikase dhe me pjesëmarrje të madhe të avokatëve,

noterëve dhe gjyqtarëve. Këto trajnime janë duke vazhduar me një program të përbashkët me Akademinë e Drejtësisë deri në fund të muajt janar 2021.

Drafti i Kodit Civil është miratuar në Qeveri me 5 Gusht 2020 dhe është dërguar në Kuvend. Me datën 10.08.2020 Drafti i Kodit Civil është shpërndarë deputetëve dhe pritet të miratohet në vijim shtator-tetor 2020. Andaj, duke ditur rëndësinë e Kodit civil dhe reformën ligjore që do ta sjellë në Kosovë në fushën e të drejtës civile, është e nevojshme ngritja e kapaciteteve institucionale sidomos në sektorin e drejtësisë që është drejtpërdrejt i lidhur me zbatimin e dispozitave të Kodit Civil

Duke ditur se me Kodin Civil do ketë risi në shume institute juridike, si ato statusore, kontraktore, pronësore, familjare dhe trashëgimore, është me rëndësi për gjyqtarë që të marrin njohuri të reja lidhur me ligjin e ardhshëm – Kodin Civil dhe te përgatiten me kohë për zbatimin e tij. Për këtë, kërkohet që të vazhdohet me ngritje te kapaciteteve përmes temave të ndryshme të trajnimeve dhe tryezave te rrumbullakëta. Me këto temë të trajnimeve dhe tryezave, synohet që të diskutohet për zbatimin e legjislacionit në fuqi, praktikën e gjykatave si dhe risitë dhe ndryshimet që sjell Kodi.

Objektivat

Pas zhvillimit të trajnimeve dhe tryezave, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zbatojnë dispozitat e Ligjit aktual ne fushën e së drejtës civile;
- Njohin specifikat-risitë që i sjell Kodi Civil;
- Zbatojnë ligjin duke marrë në konsideratë praktikën më të mirë të gjykatave;
- Zhvillojnë shkathtësitë të interpretimit të ligjit dhe hartimit të vendimeve gjyqësore të harmonizuara dhe në pajtim me standardet ndërkombëtare të zbatueshme në Kosovë.

Përmbajtja

Temat e trajnimeve janë përzgjedhë duke pasur parasysh institutet e reja ose modifikimet-ndryshimet e atyre ekzistuese. Gjithashtu, janë marrë në konsideratë edhe kërkesat dhe interesimet e gjyqtarëve gjatë trajnimeve dhe diskutimeve në tryeza të rrumbullakëta. Si propozime janë temat si vijon:

1. Afatet e parashkrimit dhe mënyra e interpretimit;
2. Punët juridike dhe llojet e pavlefshmërisë - Risitë në Kodin Civil;
3. Mos-zbatimi i kontratave dhe pasojat e mos-zbatimit;
4. Shkaktimi i dëmit dhe mënyra e kompensimit;
5. Vështirësitë në vërtetimin e të drejtës se pronësisë/ llojet e titujve juridik - Risitë në Kodin Civil;
6. Servitutet sendore dhe risitë në Kodin Civil;
7. Hipoteka dhe pengu;
8. Regjimi pasuror martesor/ kontrata martesore;
9. Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në procedura gjyqësore;
10. Shkurorëzimi dhe pasojat e shkurorëzimit për të drejtat dhe detyrat e bashkëshortëve;
11. Trashëgimia, trashëgimtarët e domosdoshëm dhe procedura e trashëgimisë;
12. Rendet e trashëgimisë dhe të drejtat e grave në trashëgimi.

Tryezat e rrumbullakëta

Tryezat e diskutimeve duhet të organizohen sipas Librave të Kodit Civil. Tryeza e parë duhet të organizohet si fillim me tematikën “Unifikimi i praktikës dhe vendimeve të gjykatave në fushën e të drejtës civile”.

Pastaj tryezat do të organizohen si vijon:

1. Libri 1 - Pjesa e përgjithshme
2. Libri 2 - Detyrimet
3. Libri 3 - E drejta e pronësisë dhe drejta tjera sendore
4. Familja
5. Trashëgimia

Metodologjia e trajnimeve

Për realizimin e trajnimeve do të përdoren metodat e kombinuara: shpjegimi i shkurtë teorik dhe i dispozitave ligjore në fuqi dhe ato që priten në të ardhmen (Kodi Civil), prezantime në Power Point, diskutimet interaktive përmes rasteve dhe shqyrtim i përbashkët i mënyrës së zbatimit të dispozitave ligjore në praktikë.

Përfituesit dhe kohëzgjatja

Përfitues të këtij trajnimi do jenë gjyqtarë të të gjitha niveleve të gjykatave varësisht nga përzgjedhja e grupit nga Akademia e Drejtësisë. Temat e trajnimeve propozohen për Programin e trajnimeve 2021 dhe 2022.

Mbështetja

Mbështetje nga projekti i BE-së për Kodin Civil. Projekti është duke vazhduar me trajnime dhe tryeza të rrumbullakëta me Akademinë e Drejtësisë me një program deri në kohëzgjatjen e projektit në Janar 2021. Nëse do të ketë kohëzgjatje të projektit do të vazhdohet me mbështetje në këto tema. Megjithatë, temat e propozuara janë si nevojë e ngritjes së kapaciteteve dhe marrjes së njohurive për legjislacionin e ri të fushës civile të cilat është e nevojshme të zhvillohen dhe të jenë në Programin e Trajnimeve të Akademisë së Drejtësisë.

Projekti për Krime Ekonomike (PECK III)

<https://www.coe.int/en/web/corruption/projects/peck3>

Ndjekja dhe gjykimi i veprave penale të PTP dhe FT

Sipas Raportit të BE-së 2019 për Kosovën, lufta kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit nuk është aq efektive sa të prodhojë rezultate bindëse, andaj u bëhet thirrje autoriteteve të Kosovës që të jenë më efektivë në përpjekjet e tyre për të luftuar pastrimin e parave. Në raport më tej theksohet se tek prokurorët dhe gjyqtarët parimi i ndjekjes penale të veprës penale pastrim i parave si vepër e vetme është ende i paqartë, kështu që kërkohet kuptim më i mirë i konceptit të pastrimit të parave përmes specializimit në këtë fushë. Për më tepër, raporti i fundit i EULEX-it zbulon se parimi "ndjekja e parasë", e cila është e një rëndësie të madhe në hetimin e pastrimit të parave dhe krimit financiar, në përgjithësi është lënë pas dore. Për më tepër, Rishikimi Funkcional i Sundimit të Ligjit në Kosovë i realizuar nën udhëheqjen e Ministrisë së Drejtësisë ofron analizë të hollësishme dhe të detajuar të çështjeve të sundimit të ligjit në Kosovë, përfshirë sfidat në lidhje me hetimet komplekse në fushën e krimit ekonomik.

Në funksion të kësaj dhe për ti adresuar mangësitë e identifikuara, ky koncept dokument propozon zhvillimin e një programi gjithëpërfshirës trajnimi LPP / LFT për Akademinë e Drejtësisë që do ti mbulonte temat kryesore.

Objektivat

Qëllimi i trajnimit është të krijojë një Program Trajnimi gjithëpërfshirës për Akademinë e Drejtësisë në funksion të zhvillimeve të vazhdueshme ligjore dhe institucionale. Në marrëveshje me Akademinë e Drejtësisë, një numër trajnerësh (deri në 10) do të identifikohen për secilën nga temat dhe do të trajnohen sipas programit.

Programi i propozuar i Trajnimit me të gjitha detajet e tij do të zhvillohet me mbështetjen e ekspertizës ndërkombëtare të siguruar nga Projekti PECK III dhe në marrëveshje me Akademinë e Drejtësisë.

Përmbajtja e trajnimit

Programi i trajnimit përfshinë një përmbledhje të veprave penale të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, lidhjeve midis dy veprave penale dhe veprave të parapara, fazat e hetimit dhe metodat për mbledhjen e provave, strategjitë prokuroriale dhe aspektet e gjykimit. Trajnimi do të bazohet në legjislacionin e Kosovës aktualisht në fuqi, duke reflektuar në standardet ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira. Programi do të përbëhet nga modulet vijuese që do të zhvillohen më tej në fazat e mëvonshme:

- Elementet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (vepra të pavarura, nga veprat e parapara, me veprat e parapara që kryhen plotësisht ose pjesërisht jashtë vendit, etj.);
- Përpjekjet për hetimin penal (mbledhja e provave, inteligjenca financiare dhe informacione të tjera të inteligjencës, hetimet financiare, sigurimi/ ngrirja e pasurive, etj.);
- Përpjekjet për ndihmë të ndërsjellë juridike formale dhe jo formale (burimet, qasja, formulimi i kërkesave për PPA, baza për kërkimin e ndihmës, etj.);
- Përdorimi i provave rrethore (kuptimi i dokumenteve financiare, nxjerrja e konkluzioneve nga prezantimi i strukturës, etj.);
- Pronësia e dobishme
- Aspektet e gjykimit (standardi i provës, prezantimi i provës, barra e provës, etj.)

Programi i Trajnimit do të përfshijë 2 pjesë. Pjesa 1 (e paracaktuar për TiT), ndërsa pjesa 2 është (paracaktuar për trajnim mes dy personave - kolegë me kolegë) në mes të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe të gjithë zyrtarëve të tjerë të zbatimit të ligjit të cilët pajtohen për të ndjekur trajnimin.

Metodologjia

Trajnimi duhet të bazohet në standardet ndërkombëtare dhe kornizën ligjore vendore të kombinuar me mësimet e nxjerra nga rastet reale, pjesëmarrjen e pjesëmarrësve dhe metodat interaktive të mësimdhënies, për t'ju siguruar pjesëmarrësve teknika parandaluese dhe hetimore për luftimin e korrupsionit. Ky trajnim do të jetë një program ndërveprues i dizajnuar për të çuar praktikuesit e ligjit nga bazat e veprave të PP dhe FT në një nivel shumë më të avancuar, duke kërkuar nga pjesëmarrësit që të kryejnë hetime financiare komplekse.

Përfituesit dhe kohëzgjatja

Përfituesi kryesor i programit të trajnimit është Akademia e Drejtësisë së Kosovës dhe trajnuesit e zgjedhur për të marrë pjesë në TiT. Pasi të ketë përfunduar kjo fazë, trajnimi kolegë për kolegë do të zhvillohet për prokurorët dhe gjyqtarët, ndërsa zyrtarë të tjerë të zbatimit të ligjit gjithashtu mund të marrin pjesë në këtë trajnim. Për më tepër, trajnimi mund të ofrohet edhe për studentët e institucioneve akademike që synojnë të bëhen prokurorë dhe hetues pas përfundimit të studimeve të tyre për gjyqtarë dhe prokurorë dhe zyrtarë të tjerë të zbatimit të ligjit me pëlqimin e tyre.

Kohëzgjatja e programit, kërkon deri në 3 ditë për temë. Afati kohor i saktë për secilën temë të trajnimit do të përcaktohet me marrëveshje ndërmjet Projektit dhe Akademisë.

Projekti – SAEK

KONCEPTI I KURRIKULËS KOMBËTARE TË TRAJNIMIT: TRAJNIM I TRAJNERËVE - HETIMET FINANCIARE DHE RIKUPERIMI I ASETEVE

Korrupsioni dhe pastrimi i parave kufizojnë aftësinë e një vendi për ta luftuar varfërinë, ndikojnë negativisht në zhvillimin ekonomik, dëmtojnë vlerat shoqërore dhe minojnë demokracinë dhe qeverisjen e mirë. Prandaj, ka shumë rëndësi çdo përpjekje për forcimin e kapacitetit të agjencive të zbatimit të ligjit (AZL) dhe prokurorëve për t'i luftuar krimet e tilla.

UNDP në Kosovë po zbaton fazën e tretë të projektit Mbështetje në Përpjekjet Kundër Korrupsionit në Kosovë (SAEK III), i cili pritet të ketë një ndikim pozitiv në uljen e nivelit të korrupsionit në Kosovë duke forcuar mekanizmat e monitorimit dhe mbikëqyrjes së institucioneve, në mënyrë që të veprojnë në mënyrë efektive, transparente, llogaridhënëse dhe të ndjeshme ndaj gjinisë.

Një nga Partnerët Zbatues të projektit SAEK është Instituti i Bazelit për Qeverisje (Instituti). Qendra Ndërkombëtare për Rikuperimin e Aseteve (ICAR), pjesë e Institutit, do të punojë me UNDP në Kosovë/ SAEK III dhe autoritetet e Kosovës për ofrimin e mbështetjes së përshtatur që do të forcojë punën që bëhet për lëndët e tilla, si dhe do të ndihmojë për riatdhesimin e aseteve bazuar në mbledhjen e inteligjencës, strategjitë për ndjekjen penale dhe gjurmimin e aseteve për lëndët komplekse të korrupsionit dhe pastrimit të parave, përfshirë ato që kërkojnë bashkëpunim me juridiksione të tjera.

Synimet

Qëllimi kryesor i kësaj kurrikule trajnimi është të rritet kapaciteti i hetuesve dhe prokurorëve në Kosovë për hetimin dhe ndjekjen e suksesshme penale të lëndëve të korrupsionit dhe pastrimit të parave, dhe për rikuperimin e aseteve. Duke u fokusuar në marrjen e njohurive të plota për elementet e korrupsionit dhe veprat e pastrimit të parave në legjislacionin e Kosovës, dhe duke përmirësuar të kuptuarit e proceseve ligjore dhe praktike dhe procedurave për rikuperimin e aseteve jashtë vendit, hetuesit dhe prokurorët do të zhvillojnë shkathtësitë e nevojshme.

Qëllimet shtesë të trajnimit përfshijnë sa vijon:

- Zhvillimi i pesë individëve si Trajnerë të Certifikuar për programin e trajnimit “Hetimet Financiare dhe Rikuperimi i Aseteve”.
- Trajnimi i 125 prokurorëve, hetuesve, autoriteteve kundër korrupsionit, Njësisë së Inteligjencës Financiare të Kosovës (NjIF) dhe Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar (AAPSK) (Fazat 1 - 5: 1 program trajnimi

me 25 pjesëmarrës dhe katër programe trajnimi shtesë me 25 pjesëmarrës të trajnuar secili përmes komponentës së Trajnimit për Trajnerë (TiT).

- Sigurimi për Kosovën i një sërë materialesh trajnimi (prezantime, ushtrime praktike, koncepti i metodologjisë së trajnimit).
- Trajnimi i pesë (5) trajnerëve përmes komponentit TiT për të ofruar programe të ardhshme trajnimi për hetimin financiar/rikuperimin e aseteve.

Objektivat

Objektivi kyç i kësaj kurrikule kombëtare të trajnimit është të rritet kapaciteti i hetuesve dhe prokurorëve kundër korrupsionit, gjyqësorit, dhe idealisht edhe i institucioneve të tjera kyçe të zbatimit të ligjit dhe agjencive relevante në Kosovë, për analizimin, hetimin dhe ndjekjen penale të lëndëve ndërkombëtare të pastrimit të parave dhe/ose ryshfetit, me objektiv përfundimtar rikuperimin e aseteve. Më e rëndësishmja është se kjo kurrikulë do t'u ndihmojë autoriteteve për rritjen e aftësisë së stafit të tyre për të trajtuar kërkesat ndërkombëtare dhe për të pasur sukses në bashkëpunimin me juridiksionet e huaja për luftimin e pastrimit të parave dhe riatdhësimin e aseteve të vjedhura. Për më tepër, trajnimi synon zhvillimin e Trajnerëve të Certifikuar përmes komponentit TiT, duke pasur parasysh qëndrueshmërinë e natyrshme afatgjatë në një program të tillë. Këta Trajnerë të Certifikuar do të jenë në gjendje të vazhdojnë të trajnojnë hetuesit dhe prokurorët e Kosovës për të analizuar, hetuar dhe ndjekur penalisht pastrimin e parave dhe korrupsionin, dhe për gjurmimin/rikuperimin e aseteve.

Trajnimi përfshin fazat fillestare të hetimit dhe të shqyrtimit gjyqësor gjatë të cilave grumbullohen dhe verifikohen informacioni dhe provat dhe identifikohen dhe lokalizohen asetet, duke përdorur një sërë teknikash hetimore. Ai ofron edhe udhëzime që synojnë të sigurojnë që elementët e veprave të zgjedhura të mbështeten siç duhet nga provat e mbledhura. Trajnimi thekson rëndësinë e përpunimit të provave me elementet specifike të krimit në fjalë dhe përdorimin e teknikave përkatëse për burimin e provave të nevojshme për të arritur tek dënimi dhe, në fund të fundit, për të konfiskuar të ardhurat nga korrupsioni dhe pastrimi i parave. Për më tepër, dituritë e hollësishme për elementet e krimit lehtësojnë efektivitetin e Ndihmës së Ndërsjellë Juridike (NNJ) me juridiksionet e huaja, veçanërisht në lëndët e korrupsionit, pastrimit të parave dhe raste të tjera të krimit të rëndë ekonomik, kur kryesi i veprës penale shumë shpesh i fsheh jashtë vendit të ardhurat nga krimi i tij/saj.

Suksesi i hetimit dhe ndjekjes penale të korrupsionit publik dhe pastrimit të parave varet kryesisht nga aftësia e hetuesit penal dhe prokurorit për të ndjekur gjurmët e pronësisë së parave dhe aseteve të tjera. Për të përfituar nga krimi që gjeneron fitim, kriminelët zakonisht detyrohen t'i pastrojnë të ardhurat për ta fshehur origjinën e tyre. Sidoqoftë, ekziston gjithmonë një lidhje mes aseteve të kriminelëve dhe krimeve të tyre, nëse hetuesi dhe prokurori dinë si dhe ku ta kërkojnë. Prandaj, ky trajnim përqendrohet edhe në zhvillimin e hetuesve dhe prokurorëve me shkathtësi dhe teknika relevante hetimore financiare për të ndjekur gjurmët e parave, si dhe në të kuptuarit e nevojshëm ligjor dhe praktik të procesit të rikuperimit të aseteve.

Programi i Hetimeve Financiare dhe Rikuperimit të Aseteve (në lokacion)

Kohëzgjatja: Pesë ditë

Audienca e synuar: Hetues, prokurorë, gjyqtarë, përfaqësues të NjIF-it

Thelbi i këtij programi është një ushtrim i gjerë praktik “me përvojë direkte” në të cilin pjesëmarrësit kryejnë realisht një hetim të simuluar specifik për Kosovën. Ai përfshin skema komplekse korrupsioni dhe pastrimi parash, dhe ndjekjen e gjurmëve të parave. Duke aplikuar një qasje pjesëmarrëse, materiali trajnues i përdorur në program paraqitet dhe përforcohet

përmes tri stileve të të nxënit plotësues: ligjërata, një hetim i simuluar specifik për Kosovën, dhe përgatitja e gjykimit.

Pjesëmarrësit ndahen në ekipe hetimore me pesë persona, duke punuar si grupe të pavarura task-force përgjatë gjithë kohëzgjatjes së programit. Diskutimet e lehtësuara të grupeve përqendrohen në fushat kyçe tematike, identifikojnë problemet që kanë ndodhur në raste reale, arrijnë në zgjidhje të mundshme, dhe krahasojnë standardet ndërkombëtare me çështjet specifike për Kosovën. Lënda e simuluar përfshinë analizën e vëllimeve të mëdha të të dhënave, mbledhjen dhe bashkimin e provave në një mënyrë të gatshme për prezantim në gjykim, dhe përcaktimin e bazës për konfiskimin e aseteve. Ky ushtrim praktik përfshinë ligjet dhe dispozitat përkatëse penale të Kosovës, të dhënat tregtare dhe bankare, dhe procedurat e përmbarimit.

Pjesëmarrësit mësojnë si t'i përdorin teknikat e hetimit penal për të identifikuar dëshmitarët dhe provat që do të përdoren për të provuar secilin prej elementeve të një veprë të pastrimit të parave dhe korrupsionit dhe për të drejtuar një veprim për rikuperim të aseteve. Kjo punë kryhet në një mjedis të automatizuar, ku secili pjesëmarrës përdor aplikacione kompjuterike për të kryer pjesë të analizës financiare.

Procesi i të nxënit zhvillohet përmes një kombinimi të ushtrimit praktik dhe blloqeve përkatëse të udhëzimit, të ndërthurura në intervale të përshtatshme për t'u siguruar pjesëmarrësve shkathtësitë e nevojshme për ta përfunduar me sukses hetimin e simuluar.

Modulet e ligjëratave, të cilat përmbajnë një larmi punëtorish ndërvepruese, përfshijnë temat e mëposhtme:

- Veprat e lidhura me korrupsionin
- Pastrimi i parave
- Organizimi i provave elektronike
- Pasqyra e instrumenteve ndërkombëtare
- Elementet e krimit
- Ndihma e Ndërsjellë Juridike (NNJ)
- Teknikat e hetimit financiar
- Përdorimi i mjeteve të automatizuara
- Mekanizmat e sekuestrimit dhe rikuperimit të aseteve.

Pas përfundimit të fazës hetimore, pjesëmarrësve u kërkohet të organizojnë dhe mbledhin provat për ndjekje penale. Në mënyrë që të marrin një Certifikatë të Përfundimit dhe të përfitojnë nga puna ndërvepruese në grup, pjesëmarrësve u kërkohet ta vijojnë punëtorinë gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj.

Programi i Trajnimit të Trajnerëve (në lokacion)

Kohëzgjatja: Pesë faza, gjithsej 29 ditë (përfshirë punëtorinë e përshkruar në 1.3.1)

Audienca e synuar: Hetues, prokurorë, gjyqtarë, përfaqësues të Njësisë për Inteligjencë Financiare.

Marrë parasysh qëndrueshmërinë e natyrshme afatgjatë të trajnimit TiT, ICAR dizajnon dhe ofron trajnime specifike për vendet, duke përfshirë një iniciativë shumëfazore të dizajnuar për të prodhuar trajnerë shumë kompetentë. Qëllimi është trajnimi i kandidatëve të zgjedhur si Trajnerë të Certifikuar për programin “Hetimet Financiare dhe Rikuperimi i Aseteve” (përshkruar më lart) gjatë trajnimit të pjesëmarrësve të tjerë në proces. Përmes përdorimit të

një ushtrimi të gjerë praktik me përvojë direkte, pjesëmarrësit kryejnë një hetim të simuluar specifik për Kosovën që përfshinë skema komplekse korrupsioni dhe pastrimi parash.

Programi TiT përfshin një seri prej pesë punëtorive trajnuese të dizajnuara për të zhvilluar pesë pjesëmarrës si Trajnerë të Certifikuar për programin e ICAR “Hetimet Financiare dhe Rikuperimi i Aseteve” Pjesëmarrësit që dëshirojnë të bëhen trajnerë të certifikuar duhet të shprehin interesin e tyre dhe të sigurojnë që agjencitë e tyre të angazhohen për t’i lejuar të marrin pjesë në të pesë punëtoritë. Është esenciale që trajnerët e përzgjedhur të kenë përvojën e duhur si praktikues të së drejtës penale në hetimet/ndjekjen penale të korrupsionit dhe pastrimit të parave dhe/ose rikuperimin e asetëve, për ta rritur kredibilitetin e tyre si trajnerë. Trajnimi i trajnerëve të ardhshëm evoluon gradualisht gjatë pesë punëtorive, të cilat mbulojnë të njëjtin material trajnues në secilën punëtori. Ai fillon me përzgjedhjen e pesë kandidatëve potencialë gjatë punëtorisë së parë (ku ata marrin pjesë si pjesëmarrës), dhe njëkohësisht i trajnon ata dhe grupet e mbetura të pjesëmarrësve gjatë katër punëtorive vijuese.

Në punëtorinë e dytë dhe me një grup të ri pjesëmarrësish, trajnerët e mundshëm marrin pjesë si vëzhgues. Ky proces synon të arrijë lehtësimin e pavarur në të ardhmen të ushtrimit praktik nga ana e tyre, dhe të nxënit e moduleve të ligjëratave. Përveç kësaj, ata ndjekin një program tre ditor të udhëzimit personal për të rritur njohuritë e tyre teknike, për të zhvilluar shkathtësitë e tyre të prezantimit, dhe për ta mësuar metodologjinë unike të trajnimit ICAR.

Në punëtorinë e tretë dhe të katërt me grupe të reja të pjesëmarrësve të tjerë, trajnerët e përzgjedhur tashmë realizojnë nga dy module ligjëratash secili për secilin grup të ri të pjesëmarrësve dhe lehtësojnë ushtrimin praktik. Këtë herë, ata ndjekin një sesion mentorimi një ditor pas çdo punëtorie për ti adresuar të gjitha problemet e hasura, çështjet teknike, menaxhimin e programit dhe sugjerimet për përmirësim. Ata gjithashtu mësojnë module ligjëratash të reja që do të prezantohen në punëtorinë vijuese dhe të fundit të trajnimit.

Qëllimi i punëtorisë së pestë është që trajnerët e ardhshëm vendorë t’i realizojnë të gjitha modulet e ligjëratave, të lehtësojnë ushtrimin praktik dhe të menaxhojnë aktivitetet e klasës. Vetëm kandidatëve që marrin pjesë në të pesë punëtoritë dhe marrin vlerësim të kënaqshëm, u jepet certifikata si Trajner i Certifikuar për programin “Hetimet Financiare dhe Rikuperimi i Aseteve”.

Ky program i fundit do të vëzhgohet nga një ekspert i lartë i ICAR i cili do të sigurojë këshillim dhe ndihmë të përditshme. Eksperti do të vlerësojë edhe performancën e secilit trajner.

Pas këtij programi të fundit pesë ditor, trajnerëve të rinj që kanë ndjekur të gjitha fazat dhe kanë marrë vlerësim të kënaqshëm, do t’u jepet certifikata si Trajner i Certifikuar për programin “Hetimet Financiare dhe Rikuperimi i Aseteve”.

ICAR rezervon të drejtën për të siguruar trajnime shtesë për trajnerët e rinj të mundshëm nëse, sipas gjykimit të ekspertëve të ICAR, nuk janë përvetësuar nivelet e kërkuara të shkathtësive.

Trajnim për Parandalimin dhe Luftimin e Korrupsionit

Sipas Raportit të BE-së për Kosovën për vitin 2019, korrupsioni është i përhapur në Kosovë dhe mbetet çështje shqetësuese. Korrupsioni perceptohet në masë të gjerë si sfidë madhore në kontekstin e Kosovës. Janë ndërmarrë një numër reformash të rëndësishme të sundimit të ligjit në vitet e fundit. Sidoqoftë, reforma të tilla kanë të bëjnë kryesisht me kornizën ligjore të vendosur kryesisht tashmë (p.sh. modifikimi i Kodit Penal, masat e forcuara për mbrojtjen e sinjalizuesve, përmirësimi i masave kundër konfliktit të interesit, dhe kompetencat e zgjeruara për konfiskim). Edhe regjimi për deklarimin e pasurisë është funksional. Megjithatë, sfidat e lidhura me zbatimin mbeten çështje shqetësuese. Për shembull, Ligji i ri për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskim nuk është përdorur deri më sot, ndërsa Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve kërkon trajnim të avancuar në mënyrë që të zbatohet me sukses.

Për më tepër, Rishikimi Funkcional i Sundimit të Ligjit në Kosovë i ndërmarrë nën udhëheqjen e Ministrisë së Drejtësisë, ofron analiza të thelluara dhe të hollësishme të çështjeve të sundimit të ligjit në Kosovë, përfshirë sfidat në zbatimin e reformave anti-korrupsion. Rishikimi Funkcional kërkon organizim të trajnimeve, seminareve, punëtorive dhe formave të tjera trajnimit për zyrtarët që punojnë në parandalimin e korrupsionit, si dhe në organet kompetente për zbulimin dhe ndjekjen penale të korrupsionit. Në funksion të kësaj dhe për të adresuar mangësitë e mësipërme, ky koncept dokument propozon zhvillimin e një programi trajnues gjithëpërfshirës për Akademinë e Drejtësisë që do të mbulonte të gjitha temat kyçe të anti-korrupsionit.

Objektivat

Qëllimi i trajnimit është të krijojë një Program gjithëpërfshirës Trajnimi për Anti-Korrupsionin për Akademinë e Drejtësisë në funksion të zhvillimeve të vazhdueshme ligjore dhe institucionale. Pas marrëveshjes me Akademinë e Drejtësisë, do të identifikohen një numër trajnerësh (deri në 10) për secilën nga temat, dhe ata do të trajnohen sipas programit. Për më tepër, qëllimi përfundimtar i këtij trajnimi është akreditimi i programit që mund të përdoret nga Akademia e Drejtësisë në të ardhmen për grupe të mundshme të synuara që janë të interesuara dhe të cilëve do t'u kërkohet të marrin pjesë në këtë program. Programi i propozuar i Trajnimit do të zhvillohet në marrëveshje me Akademinë e Drejtësisë. Ai do të zhvillohet përmes bashkëpunimit të projekteve të mbështetjes nga donatorët, duke përfshirë: a) Projektin kundër Krimit Ekonomik në Kosovë-PECK III dhe projektin e UNDP-së Mbështetje Përpjekjeve Kundër-korrupsionit (SAEK), dhe donatorë të tjerë që do të bashkohen siq është dakorduar, përfshirë Aksionin për Lirinë e Shprehjes për Kosovën (JUFREX), dhe Ambasadën Amerikane. Veç tyre, pjesë e ekipit për zhvillim të programit gjithëpërfshirës të trajnimit do të ftohen të jenë gjyqtarët dhe prokurorët me përvojë dhe agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit. Pas zhvillimit të kurrikulës gjithëpërfshirëse të Programit të Trajnimit, trajnimi do t'u ofrohet fillimisht gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe organeve të tjera të zbatimit të ligjit dhe agjencive të tjera, të cilët janë të përfshirë drejtpërdrejt në trajtimin e çështjeve në lidhje me temat e mëposhtme. Gjatë zbatimit të Programit të Trajnimit, qëllimi i trajnerëve është edhe të identifikojnë pjesëmarrësit e ardhshëm të Trajnimit të Trajnerëve (TiT).

Përmbajtja e trajnimit dhe metodologjia

Trajnimi duhet të bazohet në standardet ndërkombëtare dhe kornizën ligjore lokale të kombinuar me mësim të nxjerra nga rastet reale, pjesëmarrjen e pjesëmarrësve, dhe metodat interaktive të mësimdhënies, për t'u siguruar pjesëmarrësve teknika parandaluese dhe hetimore për luftimin e korrupsionit. Ky trajnim do të jetë një program ndërveprues i krijuar për t'i drejtuar praktikuesit nga elementet bazë të korrupsionit deri në një nivel shumë të avancuar, duke u kërkuar pjesëmarrësve të kryejnë një hetim kompleks financiar.

Programi i trajnimit përfshinë mjetet parandaluese, si dhe të gjitha etapat e hetimit dhe ndjekjes penale të rasteve të korrupsionit, si dhe metodat që mund të zbatohen nga gjyqtarët dhe prokurorët në Kosovë, bazuar në legjislacionin e Kosovës aktualisht në fuqi, duke reflektuar për standardet ndërkombëtare dhe praktikën më të mira.

Programi do të përbëhet nga modulet e mëposhtme:

Parandalimi i korrupsionit

- ✓ Konceptet bazike të anti-korrupsionit
- ✓ Konflikti i interesit
- ✓ Mbrojtja e sinjalizuesve

- ✓ Deklarimi i pasurisë

Hetimi i korrupsionit

- ✓ Parimet e ndjekjes penale dhe hetimit të lëndëve të korrupsionit
- ✓ Veprat specifike në lidhje me korrupsionin (p.sh. keqpërdorimi i pozitës zyrtare, ryshfeti, prokurimi, mosdeklarimi i pasurisë, etj.)
- ✓ Konfiskimi i asetëve
- ✓ Rikuperimi i Asetëve

Programi i Trajnimit do të përfshijë 2 pjesë. Pjesa 1 (e destinuar për TiT), ndërsa pjesa 2 (e destinuar për trajnim mes kolegëve) për gjyqtarë dhe prokurorë, si dhe për të gjithë zyrtarët e tjerë të zbatimit të ligjit që dakordohen të kalojnë trajnimin.

Përfituesit dhe periudha kohore

Përfituesi kryesor i programit të trajnimit është Akademia e Drejtësisë e Kosovës, gjyqtarët, prokurorët dhe agjenci të tjera të zbatimit të ligjit. Pasi të jetë përfunduar etapa 1, do të zhvillohet trajnimi mes kolegëve për prokurorët dhe gjyqtarët, por edhe zyrtarë të tjerë të zbatimit të ligjit mund të marrin pjesë në këtë trajnim. Për më tepër, trajnimi mund të ofrohet për studentët e institucioneve akademike që synojnë të bëhen prokurorë dhe hetues pas përfundimit të studimeve të tyre, për gjyqtarë dhe prokurorë, dhe zyrtarë të tjerë të zbatimit të ligjit. Kohëzgjatja e programit do të kërkonte deri në 3 ditë për secilën temë. Periudhat e sakta kohore për trajnimin për secilën nga temat do të përcaktohen me marrëveshje mes Projektit dhe Akademisë.

Programi Trajnues i Akademisë së Drejtësisë është i hapur dhe fleksibil, varësisht nga kërkesat e akterëve vendor dhe ndërkombëtar në përputhje me objektivat e Programit Kornizë të Akademisë së Drejtësisë.

Formular për aplikim në trajnime
Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm/PTV
Periudha: Janar - Korrik 2021

Emri & Mbiemri: _____
Gjykata/Prokuroria: _____
Departamenti: _____ Divizioni: _____
Tel: _____ E-mail: _____

Mënyra e aplikimit: Ju lutem plotësoni të dhënat tuaja të plota në formular. Për të aplikuar në trajnimin e caktuar, klikoni te katrori në anën e majtë të hapësirës ku është i vendosur trajnimi dhe automatikisht shfaqet shenja

1.	<input type="checkbox"/>	Veprat penale kundër narkotikëve - më theks të veçantë kur kryhen në formë të organizuar Data: 26/01/2021
2.	<input type="checkbox"/>	Kompetenca Lëndore dhe territoriale sipas Ligjit për Kundërvajtje Data: 27/01/2021
3.	<input type="checkbox"/>	Komentimi i vendimeve të gjykatave/ Harmonizimi në çështjet detyrimore Data: 28/01/2021
4.	<input type="checkbox"/>	Program i Specializuar i Trajnimit Krimi i organizuar dhe korrupsioni - Sesioni I Data: 02-03/02/2021
5.	<input type="checkbox"/>	Përputhshmëria e procesit dhe rregullave të tenderit me ligjin e AKP-së dhe ligjeve tjera Data: 04/02/2021
6.	<input type="checkbox"/>	Praktika gjyqësore komparative në lëmin e falimentimit në vendet e Bashkimit Evropian Data: 09-10/02/2021
7.	<input type="checkbox"/>	Dhuna në familje (penale) Data: 11/02/2021
8.	<input type="checkbox"/>	E drejta në pronë - Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut Data: 16/02/2021
9.	<input type="checkbox"/>	Procedurat gjyqësore në rastet e shpronësimit Data: 18/02/2021
10.	<input type="checkbox"/>	Program i Specializuar i Trajnimit Shpëlarja e parave dhe hetimi financiar - Sesioni I Data: 23-24/02/2021
11.	<input type="checkbox"/>	Arsyetimi i vendimeve gjyqësore Data: 25/02/2021
12.	<input type="checkbox"/>	Procedura penale e kryerësve me çrregullime mendore Data: 02/03/2021
13.	<input type="checkbox"/>	Përmbarimi në sendet e luajtshme Data: 03/03/2021
14.	<input type="checkbox"/>	Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar - në lëminë civile Data: 04/03/2021
15.	<input type="checkbox"/>	Kompensimi i viktimave të krimit në kuadër të sistemit juridik të Republikës së Kosovës Data: 09-10/03/2021
16.	<input type="checkbox"/>	Trajnim hyrës për ligjin dhe politikën e konkurrencës dhe rregullimin e ndihmës shtetërore në Kosovë Data: 11/03/2021
17.	<input type="checkbox"/>	Kompensimi i dëmit dhe bazat e përgjegjësisë Data: 16/03/2021
18.	<input type="checkbox"/>	Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror dhe në rastet e ndryshimit të statusit të tyre Data: 17-18/03/2021
19.	<input type="checkbox"/>	Masat e fshehta të hetimit dhe vëzhgimit Data: 23/03/2021
20.	<input type="checkbox"/>	Praktika aktuale e Gjykatës Kushtetuese sipas kërkesave-ankesave në lëmin civile Data: 25/03/2021
21.	<input type="checkbox"/>	Programi i Specializuar i Trajnimit Mashtrimi dhe Korrupsioni në Prokurim Publik Sesioni I

		Data: 30-31/03/2021
22.	<input type="checkbox"/>	Paraburgimi dhe masat tjera për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë Data: 01/04/2021
23.	<input type="checkbox"/>	Trafikimi i qenieve njerëzore Data: 06-07/04/2021
24.	<input type="checkbox"/>	E drejta për një proces të rregullt Data: 13/04/2021
25.	<input type="checkbox"/>	Veprat penale kundër detyrës zyrtare Data: 15/04/2021
26.	<input type="checkbox"/>	Procedura përgatitore të kryesit e mitur të veprave penale Data: 20/04/2021
27.	<input type="checkbox"/>	Mbrojtja gjyqësore në kontestet nga marrëdhënia e punës sipas Ligjit të Punës Data: 22/04/2021
28.	<input type="checkbox"/>	Program i Specializuar i Trajnimit Ekstremizmi, radikalizmi dhe terrorizmi, Sesioni I Data: 27-28/04/2021
29.	<input type="checkbox"/>	Definimi i statusit juridik të shoqërive aksionar- ndërmarrjeve shoqërore Data: 29-30/04/2021
30.	<input type="checkbox"/>	Program i Specializuar i Trajnimit Krimi Kibernetik, Sesioni I Data: 04-05/05/2021
31.	<input type="checkbox"/>	Procedura gjyqësore në rastet e mbrojtës nga dhuna në familje Data: 06/05/2021
32.	<input type="checkbox"/>	Të drejtat e pronësisë intelektuale, markat tregtare, patentat Data: 11-12/05/2021
33.	<input type="checkbox"/>	Program i Specializuar i Trajnimit Krimi i organizuar dhe korrupsioni, Sesioni II Data: 18-19/05/2021
34.	<input type="checkbox"/>	Aspekti material dhe procedural i ligjit për mbrojtje nga diskriminimi dhe sfidat në zbatimin e tij Data: 20-21/05/2021
35.	<input type="checkbox"/>	Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet penale, mundësitë dhe sfidat Data: 25/05/2021
36.	<input type="checkbox"/>	E Drejta Ekologjike e BE-së - Konventa e Arhusit, Rregulloret, direktivat, dhe aktet tjera juridike të BE -së Data: 27/05/2021
37.	<input type="checkbox"/>	Program i Specializuar i Trajnimit Shpëlarja e parave dhe hetimi financiar, Sesioni II Data: 01-02/06/2021
38.	<input type="checkbox"/>	Kontratat nule dhe të rrëzueshme Data: 03/06/2021
39.	<input type="checkbox"/>	Veprat penale kundër integritetit seksual të fëmijëve Data: 08-09/06/2021
40.	<input type="checkbox"/>	Mjete për sigurimin e ekzekutimit të kontratave Data: 10/06/2021
41.	<input type="checkbox"/>	Provat në procedurë penale dhe ligjshmëria e tyre Data: 15/06/2021
42.	<input type="checkbox"/>	Shqyrtim kryesor, procedura e provave dhe Barra e te Provuarit në Konfliktin administrativ Data: 16/06/2021
43.	<input type="checkbox"/>	Menaxhimi i rastve Data: 17/06/2021
44.	<input type="checkbox"/>	E drejta e mbrojtjes së pronës - neni 1. i Protokollit nr.1. i KEDNJ Data: 22/06/2021
45.	<input type="checkbox"/>	Veprat penale kundër martesës dhe familjes Data: 24/06/2021
46.	<input type="checkbox"/>	Program i Specializuar i Trajnimit Krimi Kibernetik, Sesioni II Data: 29-30/06/2021

47.	<input type="checkbox"/>	Zbatimi gjyqësor i KEDNJ dhe efektet e nenit 53. dhe 22. të Kushtetutës e Republikës së Kosovës në praktikën gjyqësore të Republikës së Kosovës Data: 01/07/2021
48.	<input type="checkbox"/>	Program i Specializuar i Trajnimit Ekstremizmi, radikalizmi dhe terrorizmi, Sesioni II Data: 06-07/07/2021
49.	<input type="checkbox"/>	Procesi i likuidimit vullnetar të ndërmarrjeve shoqërore, shqyrtimi para Autoritetit të Likuidimit dhe trajtimi gjyqësor në Dhomën e Posaçme Data: 08/07/2021
50.	<input type="checkbox"/>	Procedura administrative lidhur me kërkesat nga lëmia e marrëdhënieve te punës veçmas masat disiplinore Data: 18/07/2021

Akademia e Drejtësisë
<https://ad.rks-gov.net>
infoad@rks-gov.net
 Rr. "Muharrem Fejza" - Prishtinë
 Tel: +381 38 200 18 670

Akademia e Drejtësisë
<https://ad.rks-gov.net>
infoad@rks-gov.net
Rr. "Muharrem Fejza"-Prishtinë
Tel:+383 38 200 18 660